



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 12, 13, 23 DHE 26 KORRIK 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 12, 13, 23. I 26. JULA 2018. GODINE**

**KORRIK - JUL
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-009 për ndërmjetësim dhe
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrt zakona br.06/L-087 o proširenom nadležnostima o konfiskovanoj imovini,
4. Prvo razmatranje Nacrt zakona br.06/L-085 o zaštiti uzbunjivača,
5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2004/32 o porodici i zrađena od Komisije za zakonodavstvo,
6. Prvo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-081 o Pristupu javnim dokumentima,
7. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-046 o Inspektoratu Obrazovanja Republike Kosovo,
8. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-042 o krvi i krvnim sastojcima,
9. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 06/L-009 o posredovanju,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona br.06/L-010 o javnom beležništvu,

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,
Po e fillojmë seancën e re. Siç e dini, pikë e parë e rendit të ditës është:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

I dini rregullat. Ata që paraqiten në emër të grupit duhet të deklarohen që janë në emër të grupit të vet. Po fillojmë. Fjalën e ka zoti Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë dua të ngre si shqetësim deklaratën e përfaqësueses së BE-së për Kosovë, zonjës Apostolova, e cila në një adresim të saj publik deklaroi që 34 milionë euro janë ndarë për ngritjen e cilësisë në arsim dhe nuk dihet ku kanë shkuar ato mjete. Në fakt, tha “keni dështuar”.

Unë konsideroj që ato mjete janë ndarë për sektorin e arsimit në Kosovë, por nuk janë menaxhuar nga agjencitë dhe mekanizmat kompetentë të Ministrisë së Arsimit. Janë ndarë po ashtu, edhe milionë për testin PIZA dhe prapëseprapë rezultatet kanë dalë, mos të them, katastrofal. Në këtë aspekt për të gjitha mjetet financiare që i dedikohen Kosovës nga mekanizmat e Bashkimit Evropian duhet të dihet kush po i menaxhon, kush po merret me to, në cilën adresë po dërgohet dhe do të bëja apel publik që të ftojme Gjykatën Evropiane të Auditorëve, që këto milionë që janë ndarë për Kosovën, u janë adresuar sektorëve të caktuar në Kosovë, thjeshtë të shihet rezultati, sepse në raportet e caktuara të mekanizmave të BE-së dhe të Parlamentit Evropian kur bëhet balanca financiare, që u ndahen shteteve pretendente për anëtarësim në BE, thjesht po përmenden milionë e milionë të destinuara për Kosovën dhe rezultatet janë, të mos them shqetësuese, por janë kurrfarë.

Edhe një temë sa i takon çështjes së arsimit. Qendra e kompetencës, një shkollë në komunën e Ferizajt, kam pranuar edhe prindër edhe mësimdhënës, por edhe njëerës të tjerë kompetentë të arsimit në Ferizaj, por që nuk ka të bëjë me departamentin komunal të arsimit, një shkollë që është financuar edhe nga Qeveria e Luksemburgut. Thjesht, nuk po licencohen ata të rinj që kanë mbaruar këtë shkollë. Prandaj, kërkoj nga organet kompetente të Ministrisë së Arsimit, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Odës së Infermierëve të Kosovës që këtyre nxënësve që e kanë mbaruar këtë shkollë të kompetencës, t’u gjegjë zgjidhje konform legjislacionit aktual në fuqi.

Çështja e tretë dhe jo më e parëndësishme është rasti i kafshimit nga gjarpërinjtë i dhjetëra qytetarëve anembanë Kosovës. Disa i kemi të shtrirë edhe në klinikë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqetësimin që sot do të ngre është një shqetësim të cilin keni pasur mundësi që ditët e kaluara ta shihni në medie. Është greva e minatorëve të Trepçës, të cilët kanë hyrë që disa ditë në grevë për përfshirjen e kërkesave të tyre, kërkesa të cilat janë shumë legjitime, janë të drejta, janë në mbrojtje të Trepçës e në veçanti që kanë një synim të qartë zhvillimin e Trepçës.

Prejse edhe në mandatin e kaluar kemi miratuar Ligjin për Trepçën në vazhdimësi kam kërkuar që njëkohësisht Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi të miratojnë strategjinë për zhvillimin e Trepçës. Nuk mundet Trepça të hapërojë përpara drejt zhvillimit pa pasur një strategji të qartë të zhvillimit të saj. Dhe, tani kemi ardhur në një situatë, ku minatorët detyrimisht duhet të hyjnë në grevë për të kërkuar zhvillimin e Trepçës, sepse ata që menaxhuan Trepçën, mund të them menaxhmenti i Trepçës e ka prurë Trepçën buzë falimentimit.

Disa herë me anë të pyetjeve parlamentare edhe ish-kryeministrin Isa Mustafa i kam ngritur shqetësimet për gjendjen në Trepçë, sepse vite më parë Trepça arriti që me një menaxhment tjetër të jetë profitabile dhe të arkëtojë afër 15 milionë euro në konton e sajë rezerva që kanë qenë edhe në koncentrat, por edhe mjete financiare. Ndërsa menaxhmenti pasues atë e ka zhytur në borxhe dhe sot borxhet e Trepçës vetëm që i ka krijuar menaxhmenti i kaluar llogariten mbi 16 milionë euro, pa i llogaritur edhe borxhet e krijuara muajt e fundit.

Prandaj, kërkoj edhe një herë nga ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe nga kryeministri, që hartimin e Statutit të Trepçës ta bëjnë bashkërisht me Strategjinë për zhvillimin e Trepçës dhe këto dy dokumente duhet të jenë në përputhje me njëra tjetrën, me synimet e minatorëve dhe me synimet tona për zhvillimin e Trepçës, i cili është esencial, sepse me një Trepçë të ngritur ekonomikisht atëherë kemi edhe një Mitrovicë të ngritur ekonomikisht, por do të kemi edhe një Kosovë të ngritur ekonomikisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën, në emër të grupit.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Unë sot dua të ngre një shqetësim që ka të bëjë me zhvillimet e fundit në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku si pasojë e kërcënimeve të qarqeve të ndryshme të Serbisë janë larguar 40 pjesëtarë të komunitetit serb nga kjo forcë, pra nga ky institucion i autorizuar shtetëror i sigurisë.

Natyrisht që ky është problem, por problem më shumë se sa largimi i 40 serbëve nga Forca e Sigurisë së Kosovës po del të jetë fuqia që ka marrë Serbia për të ndërhyrë drejtpërsëdrejti në

institucionet e Kosovës, në këtë rast në institucionet më vitale dhe më të ndjeshme, në ato të sigurisë. Pra, problemi kryesor për këtë nuk është thjesht largimi i 40 serbëve, ky është problem, por gjithsesi është roli që i është dhënë në negociata Serbisë për të ndërhyrë drejtpërdrejtë në institucionet e Kosovës.

Ata, siç ju e dini, u larguan si pasojë e një presioni dhe po ashtu, ky presion u quajt edhe kriminel nga institucionet dhe nga udhëheqës shtetëror të Republikës së Kosovës në paraqitjet e tyre mediale. Po, kush janë ata që po zbatojnë urdhra të Vuçiqit në këtë rast? Nuk janë thirrur drejtpërdrejtë ata që u kërcënuan, urdhrat e Vuçiqit kanë pranuar ata që kërcënuan, pra grupet e caktuara kriminele që kërcënuan dhe të cilët pastaj u arrestuan nga Policia e Kosovës. Por, një urdhër tjetër akoma është më shqetësues, ai i Vuçiqit përsëri për t'i liruar ata që u arrestuan e të cilët një ditë më parë u quajtën grupe kriminele nga krerët e shtetit.

Në fakt, largimi i 40 pjesëtarëve të FSK-së nga Forca e Sigurisë së Kosovës e kthen situatën në një pikë, pothuajse në pikë zero, sa i përket aspektit të përpjekjeve të institucioneve tona për ta avancuar rolin e Forcës së Sigurisë së Kosovës drejt Forcave të Armatosura të Kosovës. Dhe, jemi dëshmitarë që tash e sa ditë nuk flitet më, as nga institucionet e as në opinion, për avancimin e Forcës së Sigurisë në forca të armatosura, por flitet për rikthimin e 40 serbëve në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo normalisht, që integrimi i serbëve dhe komuniteteve tjera në Forcën e Sigurisë së Kosovës është bërë në bashkëveprim edhe me institucionet tjera të partnerëve tanë strategjik, pra edhe në bashkëveprim me partnerë strategjikë, por gjithsesi një urdhër i drejtpërdrejtë, një mundësi e drejtpërdrejtë dhe një veprim i drejtpërdrejtë i Vuçiqit e rrënon edhe një punë të përbashkët të Kosovës me aleatët strategjikë.

Në anën tjetër, toleranca tash ndaj Serbisë për këtë fenomen, që nuk po e bën, dorën në zemër, vetëm brenda institucionit të FSK-së, por edhe në institucione tjera, kthehet dhe e legjitimon Serbinë me veprimet e saj brenda Kosovës. Kjo është shumë e rrezikshme. Nëse Serbia arrin ta ketë legjitime tashmë ndërhyrjen në Kosovë, paramendoni çfarë do të bëjë ajo edhe në mundësitë tjera që i ka. Ne e dimë që komuniteti serb ka qenë i integruar deri në njëfarë mase në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por mos të harrojmë që komuniteti serb është integruar dhe është pjesë integrale e Policisë së Kosovës. Paramendoni, nëse këtë do ta bëjë nesër Vuçiqi edhe në Policinë e Kosovës.

Prandaj, kjo duhet të konsiderohet si alarmante. E gjithë kjo situatë ka përgjegjësit e vet. Ne nuk mund të ikim nga përgjegjësia e sidomos përgjegjësit e vet i ka ata që po bisedojnë me kërcënuesin, në këtë rast me Vuçiqin dhe Vuçiqi me kërcënimet e tij vetëm po e avancojnë pozicionin kundrejt Kosovës, kundrejt atyre që i ka në tavolinë. Pra, në këtë rast po e avancojnë pozicionin e saj në rrugën e saj drejt shkatërrimit, siç e ka synim, të Pavarësisë dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Nuk mund të mos e përmend një njeri, i cili në vazhdimësi ka qenë në këto bisedime, ai është Thaçi që i ka dhënë mundësinë më të madhe Vuçiqit që të ndërhyjë në institucionet e sigurisë, në institucionet e Kosovës dhe i cili sot po e manifeston gatishmërinë edhe më të madhe për të shkuar dhe për të biseduar me Serbinë. Ai mund të bisedojë me Serbinë, ai mund të flasë me Serbinë, ndoshta ai edhe mund për ta shpëtuar vetveten t'i liroj serbët e arrestuar si grupe kriminale. Ndoshta ai edhe mund t'i amnistojë serbët, por ne askujt nuk do t'ia falim krimet që ka bërë Serbia në Kosovë, e as atij që ia fal krimet Serbisë.

Prandaj, kjo situatë duhet që të marrë fund ndonjëherë me një angazhim të drejtpërdrejtë të Qeverisë së Kosovës, me mbrojtje të institucioneve të saj, e në këtë rast në mbrojtje të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave për zyrtarët e lartë qeveritarë, e më pas edhe opinionimi i Gjykatës Kushtetuese, që e vlerësoi si kushtetues këtë vendim, tashmë po i prodhon pasojat e veta që ndikojnë, jo vetëm në buxhetin e shtetit, por edhe në rritjen e pakënaqësisë së shumë punëtorëve të sektorit publik.

Kjo rritje e pagave ka shkaktuar pabarazi të mëdha brenda sektorit publik dhe me shumë të drejtë tani një numër i tyre e kanë shfrytëzuar edhe të drejtën e grevës në mbështetje të kërkesave të tyre, e që kryesisht janë për rritje të pagave, siç ishte edhe rasti me punëtorët administrativë të sistemit të drejtësisë.

Ndonëse një marrëveshje me këtë sektor është arritur dje, kjo nuk i jep as zgjidhje të drejtë, e as të qëndrueshme problemit me pagat, por edhe të statusit të punonjësve të shërbimit publik në Kosovë.

Në përpjekje për një zgjidhje të tillë parciale dhe ad hoc, jo vetëm që nuk është e qëndrueshme dhe e drejtë, por ajo nxit edhe punëtorët e sektorëve tjerë publik që të kërkojnë po ashtu zgjidhje të kufizuar vetëm për sektorin e tyre dhe natyrisht sa më shumë në favor të tyre.

Zgjidhjet të tilla të paanalizuara mirë dhe të pambështetura në burime financiare afatgjate mund ta rrezikojnë edhe vetë qëndrueshmërinë e institucioneve.

Besoj që secili prej jush sot në mëngjes rrugës për tek ndërtesa e Kuvend e keni takuar grupin e zjarrfikësve të cilët po protestonin para ndërtesës së Qeverisë, në mesin e kërkesave të të cilëve ishte po ashtu edhe kërkesa për rritje pagash dhe kërkesa për rregullimin e statusit të tyre.

Pasdite gjatë pushimit të drekës, në të njëjtin vend, pra para ndërtesës së Qeverisë, ishin grumbulluar edhe punëtorët e Trepçës me kërkesa të njëjta, pra për rritje pagash dhe natyrisht edhe për zgjidhjen e statusit të tyre.

Paramendoni sikur të gjithë punëtorët e sektorit publik, pra edhe mjekët, edhe punëtorët e arsimit, edhe policët, e kështu me radhë, ta kërkojnë nivelin e njëjtë të rritjes së pagave siç bëri Qeveria për vete. Pra, të gjithë të kërkojnë rritje 100% të pagave.

Për më tepër, nëse kërkesat e tyre ata i mbështetin me veprime sindikaliste, përfshirë këtu edhe grevat edhe protestat dhe natyrisht që kërkesat e tyre janë plotësisht legjitime, sepse Qeveria ua ka dhënë këtë mundësi me vendimin për rritjen e pagave.

Prandaj, për ta dhënë një zgjidhje meritore dhe të qëndrueshme, Qeveria duhet sa më shpejt ta sjellë Ligjin për pagat dhe Ligjin për statusin e shërbyesve publikë, të cilin Ministria e Administratës Publike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë dola pikërisht për çështjet që edhe u përmendën e që janë shumë të ndjeshme, e që janë grevat e protestat e punëtorëve, qoftë të zjarrfikësve, qoftë të minatorëve, qoftë të të pakënaqurve që janë brenda administratës së gjykatës. Po ashtu, konsideroj se kjo duhet të bëhet me Ligjin për pagat, duke e rregulluar edhe statusin, por edhe të drejtën e tyre që të realizohet sa më shpejt.

Sot r kemi një protestë të zjarrfikësve të cilët para Qeverisë i kanë kërkuar të drejtat e tyre dhe ne e dimë që nga paslufta kategoria më e nënçmuar vërtet është kategoria e zjarrfikësve, duke llogaritur punën e tyre, duke llogaritur rrezikshmërinë e tyre dhe duke pasur parasysh edhe pagat shumë të ulëta, madje edhe mosrregullimin e statusit të tyre, duke e konfrontuar nivelin qendror me atë lokal.

Kompetencat të cilat janë të padefinuara saktë në ligjin aktual duhet të rregullohen me një procedurë më të shpejtë, në mënyrë që zjarrfikësit vërtet ta kenë të realizuar të drejtën e tyre ligjore siç e gëzojnë në të gjitha vendet tjera.

Prandaj, duke llogaritur se kemi nevojë për një përmirësim të gjendjes në të gjitha kategoritë, edhe kryeministri Haradinaj e ka bërë nismën tani, por duhet konkretisht të bëhen veprime për krijimit të një grupi të ekspertëve, i cili mundëson realizimin e të drejtave, qoftë të zjarrfikësve, qoftë të minatorëve, qoftë administratës dhe kështu ne i përmbyllim edhe pakënaqësitë, por njëkohësisht edhe e realizojmë një të drejtë qytetare të të gjithë atyre që jetojnë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Unë në këtë pikë të rendit të ditës desha të ngre disa shqetësime që i kemi marrë si grup parlamentar nga organizatat të cilat përfaqësojnë afaristë të ndryshëm, biznese të ndryshme në këtë rast.

E kam pasur një takim me Odën e Afaristëve të Kosovës, të cilët i kanë ngrehur disa shqetësime që kërkojnë të jepen zgjidhje nëpërmjet amendamentimit të disa ligjeve.

Pra, unë bisedova me ministrin në pauzë s dhe nuk po e ngre këtu këtë çështje për t'i dhënë zgjidhje, por vetëm sa për të jua përcjellë mesazhin atyre se shqetësimet e tyre që i kam marrë dje unë po i ngre sot në këtë seancë dhe ministri tregoi gatishmëri që të ulemi e të bisedojmë për të gjitha kërkesat dhe shqetësimet që ata mund t'i kenë për t'ua lehtësuar marrjen me afarizëm në Kosovë, gjë që realisht është bërë shumë vështirë.

Ata kanë kërkuar që nëpërmjet amendamentimit të disa ligjeve, siç neni 51, unë po e përmend vetëm një si model, pastaj të tjerat do t'i bisedoj me ministrin, Ku thuhet se aktualisht sipas neni 51 të ligjit në fjalë të gjithë tatimpaguesit që nuk arrijnë t'i paguajnë tatimet me kohë ngarkohen me ndëshkim prej 1% në baza mujore deri në maksimum 12% në vit.

Dhe, sipas tyre, përveç këtij ndëshkimi, tatimpaguesit ngarkohen plus edhe me interes, i cili duhet të ndryshojë çdo vit. Mirëpo, sipas neni 28 të Ligjit numër 03/L-222, kjo normë duhet të jetë më e lartë se shkalla e interesit të bankave tregtare në Kosovë, po llogaris që nuk duhet të jetë kanë dashur të thonë.

Prandaj, aktualisht kjo normë e interesit është 7,8% vjetore, apo 0,65% mujore.

Dhe, propozimi i tyre është që nëpërmjet amendamentimit të këtij ligji në fjalë dhe disa ligjeve, të cilat nuk do t'i ngre të gjitha këtu, t'u lehtësohet marrja me biznes në një klimë, e cila është jashtëzakonisht shumë e ngarkuar në Kosovë.

Unë atyre nëpërmjet kësaj foltoreje u them që jo vetëm për këto, por për të gjitha çështjet të cilat ata konsiderojnë se ka hapësirë ligjore për të ndërhyrë dhe për t'u përmirësuar në mënyrë që atyre t'u mundësohet dhe të mos penalizohen më shumë sesa që janë duke u penalizuar, të mos dënohen në të shumtën e rasteve pa vend, në bashkëpunim me ministrin dhe sigurisht edhe me Administratën Tatimore të Kosovës, do të shohim se ku mund të përmirësohet infrastruktura ligjore, që kërkesat e tyre të procedohen dhe në seancat e ardhshme të mund të procedojnë me propozimet që ata kanë për ligjet në fjalë.

Ministër, unë po e them edhe publikisht që gatishmërinë tënde, po e theksoj gatishmërinë tënde, që brenda javës së ardhshme të takohemi dhe të bisedojmë, një herë t'i sjell shqetësimet e tyre, pastaj në bashkëpunim edhe me ta, të shohim se çka mund të ju ndihmojmë atyre në përmirësimin e infrastrukturës ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Desha që të shpreh shqetësimet që janë adresuar nga shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, mbi të gjitha më shumë të them nga intelektualë, veprimtarë, shkrimtarë dhe njerëz, qoftë edhe shkencës dhe të dijes në Republikën e Kosovës.

Ka të bëjë me faktin e injorimit që i është bërë figurës së Anton Çettës, pasi është refuzuar kërkesa për vendosjen e shtatores në oborrin e Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Justifikimi që po theksojnë për një vend më të mirë është i paarsyeshëm, nuk qëndron, sepse edhe ashtu dihet haptazi pse kundërshtohet vendosja e plakut të urtë, ta quaj ashtu, njeriut i cili ka bërë shumë në vitet e '90-ta si prijës i pajtimit të gjaqeve në Kosovë dhe nuk do ta elaboroja shumë historikun dhe veprimtarinë e tij, sepse e ka bërë vetë dhe e falënderojnë gjithë shqiptarët anembanë ku jetojnë.

Dhe në këtë aspekt, Lidhja Demokratike e Kosovës do t'i shfrytëzojnë të gjithë mekanizmat institucionalë që këtë çështje ta ngrenë nëpërmjet Ministrisë së Arsimit apo ministrit të Arsimit në fjalë, Komunës së Prishtinës, që njerëz dhe individë të mos injorojnë figura të tilla, sepse nuk e meritojnë një trajtim të tillë, është e papranueshme, është e patolerueshme, qoftë edhe arsyeshëmria, e cila është shumë minore në raport me figurën e Anton Çettës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kam dalë sot për të ngre dy shqetësime që vijnë nga dy qytetarë të Republikës së Kosovës.

E para ka të bëjë me një nënë, e njëkohësisht një ish-mësimdhënëse në Republikën e Kosovës nga komuna e Pejës, që ka 45 vjet punë në arsim, e cila më drejtohet si anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, njëkohësisht edhe si anëtare e Komisionit për Arsim, që “45 vjet në arsim më vlerësohen nga shteti i Republikës së Kosovës me kontributin zero”, ngase ajo e ka burrin të humbur në luftën e fundit pra në Kosovë dhe ai është dëshmor. E ky është një shqetësim, i cili nuk është për herë të parë, ka qenë edhe në Qeverinë Mustafa, dhe njëkohësisht ka ardhur si produkt i asaj keqqeverisjeje, por e lus ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të merret me rastet e tilla dhe njëkohësisht me rastet e personave të verbër, pra 100% të verbër, të cilët e kanë po të njëjtin rast.

Dhe, çështja tjetër është po ashtu e një qytetareje të Republikës së Kosovës, e cila kërkon shërbim jashtë vendit dhe gjatë rregullimit të dokumenteve ajo ballafaqohet me një anomali të llojit të vet.

Kur kërkon ta nxjerrë një vërtetim që nuk është nën hetime, asaj i figuron një denoncim nga një qytetar, i cili ka vetëm emër dhe mbiemër dhe komunën, dhe asnjë të dhënë tjetër. Por, njëkohësisht edhe ajo ka vetëm emrin dhe mbiemrin dhe komunën, por as kjo nuk e ka as edhe një të dhënë tjetër, dhe nuk i lëshohet pra një vërtetim i tillë, dhe ajo për shkak të shëndetit të saj e ka një problem të tillë që, për fat të keq, të dhënat tona pra arrijnë deri këtu. Asnjë e dhënë tash nga denoncuesi, vetëm emër e mbiemër dhe komunën.

Unë i kam emrat e të dyve, edhe të qytetares, por edhe të qytetarit, kushtimisht që është denoncuesi, por në fakt është një problem me të cilin asaj fatkeqësisht po i pamundësohet për të dalë për shërim jashtë vendit, ngase edhe nuk e kërkon as edhe një cent të vetëm nga shteti i Republikës së Kosovës.

Andaj, e ftoj edhe ministrin këtu që në një periudhë kurdo të na njoftojë cilët janë hapat që ka bërë në këtë drejtim. Njëkohësisht, procesi i moszgjidhjes së kompetencave të zjarrfikësve është një problem në vete, i cili është ngritur vazhdimisht nga grupi ynë parlamentar dhe njëkohësisht ajo kategori e cila është në ajër, as në nivelin lokal, as në nivelin qendror, do të duhej të marrë fund nga kjo Qeveri.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues! E para, e mbështes në mënyrë absolute atë që e tha deputeti Zemaj. Ata që e refuzojnë Anton Çetën, e refuzojnë edhe babën e vet!

Tash po kaloj te Nexhmie Pagarusha. Nexhmie Pagarusha ka pësuar një aksident parmbremë dhe nuk dola këtu të flas për të, por dola të flas për gjendjen e rëndë që është në Klinikën Universitare në Emergjencë. Qe ku është shoku im i klasës, Fadil Beka, le të dalë në foltore dhe të tregojë, ju garantoj çdo inspektor sanitar shëndetësor në krejt botën perëndimore do ta kishte mbyllur Emergjencën në çfarë gjendje është ajo. Nexhmie Pagarusha ka qenë pa çarçafë, ka qenë pa mbulesa dhe në vizitë ka qenë edhe ministri ynë i Kulturës, zoti Kujtim Gashi, që unë po ia jap një këshill miqësore. Nuk lejohet kurrkund në botë të bëhet fotografim në Emergjencë, e aq më pak me të sëmurë, me njerëz të sëmurë. I bëj thirrje ministrit tonë të nderuar që të marrë masa urgjente për ta ndihmuar artisten tonë të madhe 85-vjeçare, Nexhmie Pagarushën.

Ajo nuk ka asnjë mbikëqyrje në banesë, po të mos kishin shkuar dy studente ta vizitojnë rastësisht, ajo sot do të ishte e vdekur. I ka rënë dollapi mbi trupin e saj, rreth 1 mijë kilogram dhe kur ne artistët e tillë i lëmë në mëshirën e Zotit, e kur vdesin mbajmë këtu një minutë heshtje, besa edhe kemi fytyrë të shkojmë në varrimin e tyre. Unë personalisht mundohem të kujdesem për Nexhmien, sepse në njëfarë forme më zëvendëson nënën time të zhdukur. Por, disa ministra, e disa njerëz publikë që jepnin para për Granit Xhakën e për Shaqirin, është mirë të dhënë nga pak para për artistë e për njerëzit tonë, edhe për ata njerëz që i përmendi Teuta që kanë nevojë për shërim. Kjo ishte për sot, domethënë nuk kam diçka tjetër.

Sa u përket dokumenteve, e nderuar Teuta, pyeti qytetarët se sa dokumente duhet t'i kompletojnë për t'i regjistruar fëmijët e vet në çerdhe dhe pyeti qytetarët se sa dokumente duhen për një letërnjoftim ose pasaportë, ose për çdo gjë. Kjo është një burokraci që i vret qytetarët çdo ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi edhe zonjën Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Ministra, kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Përderisa jemi në vllugun e grevave të ndryshme si rrjedhojë e vendimeve të gabuara të keqmenaxhimit, neve edhe sot e kësaj dite po na ndodh keqmenaxhimi para syve dhe si Kuvend i Republikës së Kosovës nuk po jemi në gjendje të ndalim ose të parandalojmë të përkeqësohet situata ende më tutje.

Sot, për rikujtim të të gjithëve i kemi në grevë minatorët e Trepçës, i kemi pasur grevë deri dhe punëtorët e administratës gjyqësore, janë në grevë zjarrfikësit, patëm në grevë punëtorët e Postës, i patëm edhe në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, duke treguar që vit pas viti ndërmarrjet publike janë zhvatur, janë keqpërdorur dhe vijmë në situatën kur kërkojmë pastaj ndihmë bashkë me punëtorët. Unë herën e kaluar ngrita këtu rastin e ndërmarrjes publike qendrore KRU "Radoniqi". Prapë vij këtu të ngre të njëjtën, duke treguar se para syve tonë, me

dy pyetje parlamentare të dy ministrave përgjegjës, edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, edhe ministres së Mjedisit Albena Reshitaj, ne sot e kemi me paranë publike të investuar në zonën e ndaluar një objekt hotelier, i cili përdoret privatisht.

Tash në cilën rrethanë ky Parlament i Kosovës miraton planet e biznesit. A kemi miratuar ne si Parlament ose si komision parlamentar plan biznesi, në të cilën janë paraparë që Kompania Rajonale Ujësjetësi të hapë dhe të menaxhojë hotel dhe restorant. Vendimi i Qeverisë, më 24. 4. 2013, e parasheh që në Zonën 2, ku bën pjesë ky objekt, ndalohet kultivimi i produkteve bujqësore, shtazore, ndërtimi i objekteve për turizëm dhe rekreacion dhe objekteve të tjera që mund të shkaktojnë ndotje. Përkundër të gjitha këtyre, kemi ne situatën absurde ku kryeshefi i kësaj ndërmarrjeje del publikisht dhe thotë se do të bëjë kallëzim penal për deputeten. Do të bëjë kallëzim penal për arsye se konsideron se unë paskam bërë vepër penale që e kam kryer punën time si deputete? Se nuk e ka bazën ose diturinë bazike të dijë se këtu jemi me imunitet dhe flasim për çështje që janë me rëndësi për të gjithë, përfshirë këtu edhe keqpërdorimin. Si do të sillemi ne kur e kemi diskutuar, hera e katërt kësaj radhe, situatën e KRU “Radoniqi”, pas një viti do të vijmë prapë punëtorët e KRU “Radoniqi” dhe të na tregojnë se sot nuk faturohet 50% e ujit që përdoret, se sot ndërmarrja ka punësime politike ekstreme, se sot kjo ndërmarrje zhvatet dhe përdoret për qëllime individuale të menaxhmentit dhe të bordit. Sot kallëzime penale është dashur të bëjë Prokuroria për drejtorin, menaxhmentin, deri te ministria relevante dhe të sillemi ne sikurse asgjë nuk po ndodh. Unë sot ju them publikisht se do të nisim komisionin hetimor për investimin që është bërë në KRU “Radoniqi” dhe pastaj rezultatet i vendosin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kohën e pyetjeve e kemi shterur, ata që s’kanë pasur mundësi sot, në seancën e radhës kanë përparësi.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Në këtë seancë janë 43 pyetje që janë mjaftë shumë. Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zoti deputet s’është, Urani s’është.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Time, e ke fjalën!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Unë po e parashtror pyetjen, meqenëse edhe në seancën e kaluar ministri nuk ka qenë këtu, është një çështje e një rëndësie të veçantë.

Shpeshherë nëpër mediat tona është përfolur çështja e stentave. Shumë pacientë, të cilët janë trajtuar nëpër institucione private kanë paguar fatura të larta për stentat që i kanë vendosur dhe, në fakt, kur ka rezultuar që ata e kanë bërë një vizitë jashtë atij institucioni, qoftë jashtë vendit apo në institucion tjetër privat, ka rezultuar se nëse u kanë thënë që i kanë tri stenda ose dy stenda, ka dalë që e kanë një stentë ose dy stenta dhe që kanë paguar më shumë stenta se sa që u janë vendosur. Kjo vërtet është shqetësuese dhe Ministria e Shëndetësisë është dashur të merret me këtë problematikë, sepse i ka mekanizmat monitorues të konstatojë se a është e vërtetë e gjithë kjo apo nuk është e vërtetë, në mënyrë që edhe dinjiteti i institucioneve shëndetësore të kthehet në vend.

Unë nuk e di ministria a ka bërë hapa të duhur dhe a e ka angazhuar Inspektoratin Shëndetësor në këtë drejtim, sepse vërtet nëse është kjo, kjo çështje është komercializuar deri në fund dhe nuk ka kuptim që qytetarët të paguajnë për një shërbim, të cilën nuk e marrin.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Janë disa procedura për pacientët, të cilët kërkojnë ndihmë financiare nga institucionet shëndetësore për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore dhe duhet të rregullohen shumë dokumente për t'i dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministria e Shëndetësisë nëse ata pacientë i plotësojnë kushtet, nga shuma që është dhënë në një profaturë nga institucionet jashtë institucioneve publike, paguajnë 70% të asaj kostoje.

Mirëpo, është një burokraci këtu, sepse institucionet private kur i kryejnë intervenimet dhe e marrin shumën e plotë nga pacientët, më pas thonë që momentin që Ministria e Shëndetësisë i dedikon ato para që iu ka ndarë pacientëve, do t'ua kthejë. Ka pasur shumë pacientë, të cilët kur kanë shkuar në institucionet private për t'ua kthyer ato para që i ka paguar Ministria e Shëndetësisë, nuk ua kanë kthyer ose i kanë zvarritur me muaj e me javë, duke u thënë se nuk i kanë ato para. Ndoshta ekziston, meqenëse ministri s'është këtu, por do ia parashtroj në një seancë tjetër. Do të ishte mirë që ministria për ato para që i ndan, ta ketë një dakordancë me institucionet private, në mënyrë që paratë që ndahen nga Ministria e Shëndetësisë të mos i paguajë pacienti vetë dhe në këtë mënyrë i iket gjithë kësaj zvarritjeje dhe lodhjes që e pësojnë pacientët për t'i kthyer paratë që ua ka ndarë Ministria e Shëndetësisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Asnjëri s'janë në sallë. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Ministri s'është këtu, a dëshironi të bëni pyetjen? Po, urdhëro Teutë! Regjia, ju lutem fjalën deputetes Teuta Haxhiu! Më duket që ka probleme teknike, Teutë, nëse do, mund të vish te foltorja.

TEUTA HAXHIU: Nënkyetar i Kuvendit, ka tri ditë rresht që nuk punon foltorja ku unë jam dhe normalisht kërkoj prapë që kjo të rregullohet.

Ka qenë mirë të ishte ministri, por për fat të keq, ai deri tash ishte këtu, është një pyetje që e kam bërë ka kohë, për shkak të mosfillimit ende, edhe pse ministri më tha se gjasat janë shumë të mëdha që të fillojë rruga, pra asfaltimi i rrugës Smolicë-Nivokaz. Kjo ishte një pyetje, por unë prapë do t'ia bëj ministrit, por megjithatë dola t'i them zonjës Kusari-Lila ta thërret një debat publik, të mos na maltretojë as neve, as qytetarët, le të dalë direkt me drejtorin e kësaj kompanie, le të ballafaqohen, sepse i kam shumë argumente këtu...

KRYESUESI: Regjia, ju lutem ndërpritjani fjalën deputetes! Zonja deputete, jemi në pjesën për pyetjet parlamentare, ju lutem, vetëm pyetje. Në rregull! Faleminderit!

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Dëshironi të bëni pyetjen? Urdhëroni!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit! Po të thashë që e kam fjalën prapë, nënkryetar i Kuvendit!

KRYESUESI: Po, por s'mund të komentoni! Bëni pyetjen!

TEUTA HAXHIU: Pyetja të cilën unë e kam bërë, do ta vazhdoj prapë, i kam bërë ministrit zotit Ismajli, normalisht që ka kohë që këto pyetje i kam bërë. Nuk e di aktualisht rezonanca magnetike, që është e vetmja në Klinikën Universitare në Kosovë, a është në funksion, sepse në kohën kur unë e kam bërë pyetjen nuk ka qenë në funksion dhe lista e pritjes së pacientëve ka qenë rreth 2 500.

Unë e kam bërë këtë pyetje, në mënyrë që ai të mendojë edhe për qendrat e tjera në Gjakovë, në Pejë, e tutje, që të ketë edhe ndonjë qendër tjetër. Prapë, po e ftoj zonjën Kusari-Lila që të dalë në debat publik me drejtorin, të mos ia bëni me sy nënkryetarit, që është shpallur...

KRYESUESI: Ju lutem, ndërpritjani fjalën deputetes Haxhiu! Faleminderit!

Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Bejtush Gashi. Deputeti s'është në sallë. Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, s'është në sallë deputeti.

Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Pal Lekaj, asnjëri s'janë në sallë.

Deputeti Bilall Sherifi, pyetje për ministrin Bejtush Gashi. Urdhëro, Bilall!

BILALL SHERIFI: Kërkoj falje, kryesues, unë e kam lexuar pyetjen qysh në seancën e kaluar, si duket administratës i është përvjedhur, e kanë risjellë edhe një herë dhe kam pritur pastaj që përgjigjen ta marr me shkrim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, asnjëri s'janë në sallë. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Ministri s'është në sallë, dëshironi të bëni pyetjen? Po, urdhëro!

BESA BAFTIU: Ashtu është. Ministri ishte në seancën paraprake, mirëpo tani nuk është i pranishëm. Megjithatë, unë do ta lexoj pyetjen dhe besoj që përgjigjen mund ta marrim edhe me shkrim apo në ndërkohë kur ministri të jetë këtu i pranishëm.

Pyetja ka të bëjë me infrastrukturën rrugore në komunën e Gjilanit, një ndër komunat me infrastrukturë rrugore më të dobët në Kosovë. Natyrisht, që ndërtimi i Autostradës Gjilan – Prishtinë është një lajm i mirë për qytetarët e kësaj ane, sepse krijon një lidhje më të shpejtë dhe më të sigurt me kryeqytetin e Prishtinës. Por, Gjilani ka një lidhje shumë të ngushtë bashkëpunimi ekonomik edhe me komunën e Ferizajt dhe Vitisë. Magjistrallja që lidh Gjilanan dhe Ferizajn është shumë e dëmtuar, nuk mirëmbahet kështu që po vështirëson qarkullimin e automjeteve dhe po rrezikon edhe jetën e qytetarëve.

Pyetja për ministrin është se, çfarë plane ka për të rregulluar apo zgjeruar këtë magjistrale, në mënyrë që t'u mundësohet qarkullim më i lehtë dhe i shpejtë qytetarëve të Gjilanit në drejtim të Ferizajt, Vitisë si dhe fshatrave që shtrihen përreth magjistrales? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Zyba, pyetje për ministrin Mahir Jagxhëllar. Ministri s'është i pranishëm. A dëshironi të bëni pyetje?

SALI ZYBA: Gjithsesi do ta parashtroj pyetjen, por s'mund ta lë pa e theksuar që ministri është i papërgjegjshëm sepse shumë herë, jo vetëm këtë pyetje, kemi pasur edhe shumë të tjera. Po e parashtroj pyetjen me mundësinë për t'u qasur, nëse ka mundësi në fund, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pyetja është: Pagesa e qirasë për hapësirat dhe objektet e lokacionet ku është vendosur Agjencia Kundër Korrupsionit.

A jeni në dijeni për pagesat e qirasë të objekteve dhe hapësirave të ndryshme që gjenden në lokacionin ku është vendosur Agjencia Kundër Korrupsionit?

A mund të na njoftoni për bazën ligjore të pagesës së hapësirës së lirë pranë lokacionit ku është vendosur selia e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e cila përdoret si vendparkim i lirë për automjete private, pas ndërprerjes disavjeçare?

A mund të na njoftoni për mënyrën e caktimit të pagesës për ndërtesën e vendosur brenda lokacionit, ku është e vendosur Agjencia Kundër Korrupsionit, ku nuk shfrytëzohet nga agjencia

por nga tjetërkush dhe a mund të na informoni për arsyet e ndërprerjes së pagesës në emër të qirasë për këtë hapësirë, gjegjësisht ndërtesës, dhe tani disa vite më vonë vendimi për rifillimin e pagesës për të njëjtën? Cili është ndryshimi ligjor? Cilat janë ndryshimet që janë bazuar në ligj për këtë rifillim të pagesës?

Po i drejtohem ministrit, nëse ka mundësi, për një sqarim të vogël. Objekti është ky, ku tash është Qendra Kulturore Serbe në Prishtinë. Nuk kam asgjë kundër Qendrës Kulturore, por meqenëse jeni ministër këtu kam një pyetje konkrete. Ky objekt ka qenë për Institutin për Politika Sociale, konkretisht Departamenti i Politikave Sociale. Ky departament është zhvendosur prej këtu me arsyetimin për mospagesë, ndërsa tash vazhdon dikush, ose e kompenson këtë qira dikush tjetër.

Kjo është pyetja. Nëse ka mundësi, pjesërisht të paktën, të më përgjigjet pse mungon Instituti për Politika Sociale ku ka qenë i vendosur deri në ardhjen në shfrytëzim të këtyre si Qendër Kulturore Serbe në Prishtinë?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Sipas Rregullores pyetjet janë personalizuar dhe mund të përgjigjet vetëm ministri, të cilit ia keni drejtuar pyetjen me shkrim, e para. Dhe e dyta, nuk keni të drejtë të shtroni pyetje drejtpërdrejtë në seancë, kështu që kalojmë te deputeti Sami Kurteshi, pyetje për ministrin Skënder Reçica.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë ka mbi një muaj që kam bërë dy pyetje. Një për ministrin Reçica dhe një për ministrin Lekaj. Deri tani nuk kam marrë përgjigje, as me shkrim, as me gojë. Këtu qenka ministri Reçica. Unë mendoj se do të përgjigjet. Pyetjen e ka, sigurisht me shkrim. Po ashtu, pres që edhe ministri Lekaj të vijë një herë edhe të përgjigjet në atë pyetje, jo me shkrim po meqenëse është një pyetje me interes të përgjithshëm publik, të përgjigjet edhe para deputetëve edhe para qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëroni, zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Kurteshi, faleminderit shumë për pyetjen e juaj!

Pyetja juaj ka të bëjë me marrëveshjen për sigurimet sociale në mes Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës. Tashmë, siç jeni të informuar kjo marrëveshje është nënshkruar më datë 8 qershor të këtij muaji nga unë si përfaqësues i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si i autorizuar për ta nënshkruar këtë marrëveshje dhe nga ambasadori i Konfederatës së Zvicrës në Kosovë, zoti Lebed.

Kjo marrëveshje u jep fund atyre pritjeve të gjata të bashkatdhetarëve tanë, vuajtjeve të tyre, të cilët për një kohë bukur të gjatë që nga ndërprerja e kësaj marrëveshjeje nuk kanë arritur t'i realizojnë të drejtat e tyre, sa u përket sigurimeve sociale.

Kjo marrëveshje tashmë është nënshkruar dhe ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale kemi filluar procedurat e nevojshme të parapara sipas ligjeve në fuqi për të sjellë në Parlament, për t'u ratifikuar. Gjendet në procedurat e marrjes së deklaratës financiare dhe në procedurat që duhet të kalojë edhe nga Ministria e Integritimit Evropian për të ardhur këtu në Parlament. Unë besoj që shumë shpejt, javën e ardhshme besoj, që do ta kemi për shqyrtim këtu në Parlament.

Bashkërisht me ambasadorin e Zvicrës jemi dakorduar që në mënyrë të përsheptuar edhe në shtetin e Zvicrës të ndiqen procedurat e njëjta për kalimin dhe miratimin në Parlament për t'i hapur rrugë, mundësi, që qytetarët tanë të fillojnë të aplikojnë për realizimin e një të drejte, e cila për një kohë të gjatë u është ndaluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Urdhëroni!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, faleminderit për përgjigjen!

Ka bashkatdhetarë tanë që ka një kohë jetojnë tani në Kosovë, në të vërtetë ju e dini si shkon ajo, kanë edhe vendqëndrimin atje e jetojnë këtu, edhe ka prej tyre që kanë marrë edhe pensione, mirëpo të reduktuara.

A do të bëhet në marrëveshjen që e keni bërë ju me Konfederatën Zvicerane rivlerësimi, ose dhënia e asaj pjese që nuk është dhënë e plotë, sido që ta quani, atyre punëtorëve?

Por, ka edhe punëtorë që në të vërtetë, për shkak të rrethanave, janë detyruar me e marrë pensionin, por ato pensione në të vërtetë kanë qenë jashtëzakonisht të reduktuara, është marrë vetëm një përqindje e vogël e shumës që u takon si e drejtë e tyre legjitime. A do të mund ta marrin, a është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Faleminderit, deputet, për pyetjen shtesë!

Ne të gjithë e dimë që kjo marrëveshja për sigurimet sociale në mes ish-Jugosllavisë dhe Konfederatës së Zvicrës është ndërprerë së realizuari për të drejtat e qytetarëve, konkretisht bashkatdhetarëve tanë në Zvicër, që nga janari i vitit 2010.

Në mënyrë të pjesshme disa bashkatdhetarë tanë kanë realizuar një pjesë të të drejtave, sa u përket sigurimeve sociale. Ekipet negociuese me kujdes shumë të lartë i kanë trajtuar të gjitha këto çështje, jo në mënyrë individuale, por vetëm në raste dhe për të gjitha është një adresim. Është shumë e qartë, se në marrëveshje nuk përfshihet mundësia që bashkatdhetarët tanë në mënyrë retroaktive të përfitojnë në sigurimet sociale. Edhe përkundër gjithë angazhimit që ne kemi bërë me përfaqësuesit e Konfederatës dhe me ekipet negociuese, ka qenë qëndrim i prerë i Konfederatës së Zvicrës që pagesat do të fillojnë nga data kur marrëveshja do të hyjë në fuqi, përkatësisht nga data kur të dy parlamentet do ta ratifikojnë këtë marrëveshje. Dhe, nga kjo datë bashkatdhetarët tanë, qytetarët tanë, do të kenë të drejtë në realizimin e të drejtës së tyre, sa u përket sigurimeve sociale në Konfederatën e Zvicrës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sami Kurteshi, pyetje për ministrin Palë Lekaj. Urdhëroni! Ministri s'është në sallë.

SAMI KURTERSHI: Zoti kryesues,

Unë e kam bërë pyetjen. Në të vërtet, as që kam qenë i përgatitur tash, se s'e kam marrë as pyetjen me vete, mirëpo po e ripërsëris pyetjen edhe me shpresë që zoti ministër në njërën nga mbledhjet e ardhshme do të përgjigjet.

Është fjala për vendkalimin kufitar midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë në Stançiq, siç quhet, domethënë në Karadakun midis Gjilanit e Kumanovës. Rruga edhe në pjesën e Republikës së Maqedonisë, edhe në pjesën e Republikës së Kosovës, meqenëse ndoshta jo në atë nivel, është e rregulluar. Nga Republika e Kosovës janë nxjerrë vetëm piramida në atë rrugë dhe rruga është e kalueshme fizikisht, por nuk lejohet, sepse nuk është vendkalim kufitar.

Pyetja ime për zotin ministër ka qenë:

Çka ka ndërmarrë dhe çka është duke ndërmarrë Qeveria e Kosovës, që ai vendkalim kufitar të hapet në afatin sa më të shpejtë, për arsye se në të dy anët e kufirit janë banorë shqiptarë edhe për arsye se në të dy anët e kufirit do të ngjallet edhe jeta ekonomike, po edhe jeta turistike, se qysh tani kanë filluar shumë njerëz që të kthehen në vendbanimet e tyre, për shkak të ndërtimit të rrugës e ndoshta më vonë edhe të infrastrukturës tjetër. Kjo është çështja, afatet dhe çka është duke ndërmarrë Qeveria e Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Valon Ramadani, pyetje për ministrin Palë Lekaj.

VALON RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Është hera e dytë që ministri nuk është prezent kur ka qenë në rend dite pyetja ime. Çështja ka të bëjë me gjendjen e rëndë të rrugës që lidh fshatrat Ternë dhe Bablak në magjistralen Ferizaj - Prishtinë, e cila rrugë është në gjendje katastrofale dhe nëse po, a keni planifikuar të merrni masa dhe kur do ta bëni atë?

Qytetarët nga këto dy fshatra kanë pyetur se, a do të fillojë të ndërtohet këtë vit kjo rrugë, sepse vet ministri Lekaj në fushatën e zgjedhjeve parlamentare ka premtuar se kjo rrugë do të fillojë në momentin që partia e tij të jetë në qeveri. Banorët e këtyre dy fshatrave nëpërmjet kësaj pyetjeje duan t'i drejtohen, që ministri ta mbajë premtimin dhe nëse ministri nuk e mban premtimin, ata do të protestojnë në forma të ndryshme dhe gjithashtu unë si deputet do t'i përkrah ata në protestat që do t'i kenë, nëse nuk fillon rruga në këto dy fshatra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë deputeti Valon Ramadani, pyetje për ministrin Palë Lekaj.

VALON RAMADANI: Çështja tjetër ka të bëjë me, ose pyetje tjetër ka të bëjë me rrugën që lidh në mes fshatrat Komogllavë të Ferizajt dhe Trestenik të Vitisë, e cila është nisur para një viti, gjatë fushatës për zgjedhjet qendrore, dhe punimet janë ndërprerë menjëherë pas zgjedhjeve.

Banorët e fshatit Komogllavë janë të interesuar të dinë, nëse punimet do të fillojnë dhe kur do të fillojnë apo duhet të presin që të ketë zgjedhje të reja dhe t'u premtojnë që të niset, dhe të ndërpritet pas zgjedhjeve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kryeministri s'është në sallë. A dëshironi ta bëni pyetjen?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Pyetja për shkak se është herën e dytë po e parashtroj, edhe pse i ka kaluar aktualiteti. Ka pasur të bëjë me çështjen e një vendimi që ka nxjerrë Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal për pezullimin e shqyrtimit të kërkesave për kthimin e pronave, të cilat menaxhohen nga AKP-ja në pronësi komunale. Dhe, pasi që neve sot na ka ardhur Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe pasi që kryeministri e ka nënshkruar një marrëveshje për 36 hektarë në komunën e Skenderajt për Parkun e Biznesit, dua vetëm ta përsëris dhe t'i uroj edhe kryeministrit edhe kryetarit të komunës, Bekim Jasharin, për Parkun e Biznesit në Skenderaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

URAN ISMAJLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Mendoj që ministrat duhet ta kuptojnë që pyetjet parlamentare ne nuk i bëjmë për dëshirën tonë, por për shkak të problemeve, ose marrjen e sqarimeve të cilat vijnë nga qytetarët, por edhe në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm.

Pyetja është për projektin e modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare, projekt që është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 2/3-at. Një projekt i cili përveçse ne po paguajmë kredi, nuk po arrijmë ta marrim këtë aparaturë. Nja dy

vjet është vonuar në kohën e Imet Rrahmanit implementimi i këtij projekti edhe tani po bëhen edhe dhjetë muaj të neglizhencës në implementimin e këtij projekti.

Ministri në muajin shkurt ka deklaruar që për tre muaj do të funksionalizohet e tërë aparatura, të cilën ne e kemi blerë përmes kredisë, edhe pse ju e dini që fillimisht unë e kam kundërshtuar një projekt të tillë për shkak të rritjes së kostos nga 2,1 - 2,6 milionë euro. Edhe u rrit kostoja, edhe po paguajmë kredi, edhe aparatura nuk po vjen, prandaj pyetja është: Kur do të vijë kjo aparaturë dhe të qytetarëve, pasi paratë publike për të i kemi dhënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Kujtim Gashi, deputeti nuk është në sallë.

Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, nënkryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen e pranimit të zyrtarëve të rinj policorë. Në këtë rast ka pasur një interesim shumë të madh të qytetarëve, të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs, siç është raportuar edhe përmes mediave numri i aplikantëve ishte afërsisht diku 18 mijë.

Policia e Kosovës, si institucion kryesor i zbatimit të ligjit, në vazhdimësi është vlerësuar një nga institucionet më profesionale dhe të besueshme për qytetarët. Prandaj, edhe interesimi i të rinjve dhe të rejave ka qenë shumë i madh për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve.

Pyetja ime për ministrin Bejtush Gashi është: sa do të jetë numri i atyre që do të pranohen si zyrtarë të rinj policorë, pasi që në konkurs nuk është saktësuar një gjë e tillë? Në Policinë e Kosovës a është përmbushur kuota gjinore sipas Ligjit për barazi gjinore, nëse jo, a do të bëni përpjekje që të përmbushin këtë obligim ligjor? Në vazhdimësi ka pasur shqetësime të qytetarëve se punësimet në Kosovë po bëhen vetëm me militantë partiakë dhe familjarë të ngushtë dhe zyrtarëve të lartë politikë. Cilat veprime i keni ndërmarrë ju si ministër dhe Policia që ky proces të zhvillohet normal dhe të arnohen ata aplikantë që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, pra të mos ketë diskriminime? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEJTUSH GASHI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Shala,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
E nderuar deputete Kalludra,

Ju falënderoj për pyetjen!

Siç jeni në dijeni për përzgjedhjen e kadetëve të rinj të Policisë është shpallur konkurs dhe deri tani ka përfunduar shqyrtimi i kërkesave nga Komisioni përzgjedhës i Policisë së Kosovës, si dhe janë përcaktuar hollësisht kriteret e organizimit të bërjes të testimit përkatës.

Në vijim do të bëhen publike edhe listat me numrin e kandidatëve për kadetë të policisë që i plotësojnë kriteret për të hyrë në testim.

Sipas Udhëzimit administrativ 04/2017 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, neni 22, paragrafi 3, Policia e Kosovës do të publikojë listën përfundimtare finale, në të cilën do të listohen në mënyrë meritore të gjithë kandidatët të cilët do të kalojnë 70% e të gjitha fazave të testimit. Kjo listë do të jetë e vlefshme për dy vjetët e ardhshme.

Tutje, varësisht prej nevojave të policisë për kadetë të rinj, kjo listë e vlefshme për dy vjet, do të thirren me radhë kandidatët meritore dhe do të pranohen në Policinë e Kosovës.

Ndërsa vlerësimi i nevojave të Policisë bëhet bazuar në planet dinamike të rekrutimit, të cilat në vazhdimësi i hartojnë dhe i mbikëqyr Departamenti për Burime Njerëzore i Policisë, bazuar në numrin e zyrtarëve policorë që dalin në pension që japin dorëheqje, apo që në një formë apo tjetër shpëtojnë marrëdhënien e punës me Policinë e Kosovës.

Për këtë arsye, numri i saktë i kadetëve policorë që do të pranohen nuk mund të saktësohet, sepse ky numër varet nga nevojat që do të ketë Policia e Kosovës për kadetë të rinj gjatë dy vjetëve të ardhshme.

Sa i përket pyetjes se a është përmbushur kuota gjinore sipas Ligjit për barazi gjinore ose jo, në konkursin e shpallur për kadetë është bashkangjitur njoftimi se do të bëhet zbatimi i plotë i Vendimit të datës 26. 3. 2018, me numër të referencës 01/0188 për zbatimin e masave të veçanta të përkohshme afirmative.

Në këtë rast, nga të gjithë kandidatët që do të plotësojnë kushtet dhe do të kalojnë pragun e kalueshmërisë 70%, përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Pra, përmes aplikimit të këtyre masave synohet që të arrihet numri i përfaqësimit gjinor në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ju njoftojmë po ashtu se bazuar në të dhënat e Departamentit për Burime Njerëzore të Policisë së Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Jo! Atëherë prapë deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Uran Ismajli, a dëshironi të bëni pyetjen, meqë ministri nuk është në sallë?

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, nënkryetar!

Po e parashtroj pyetjen, meqenëse ministri edhe në seancën e kaluar mungoi me një arsytim, kurse sot mungon dhe nuk ka arsytim, pse nuk është t'ju përgjigjet pyetjeve, të cilat u drejtohen edhe janë shqetësime të qytetarëve.

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen apo shqetësimin e qytetarëve me mungesë të shërbimeve që kanë të bëjnë me aparaturat mjekësore, të cilat janë jashtë funksionit, siç është edhe rasti me rezonancën magnetike, e cila shpeshherë po jetë jashtë funksionit dhe në këtë rast, lista e pritjes së pacientëve është shumë e gjatë dhe qytetarët duhet të presin për një periudhë shumë të gjatë deri në kryerjen e një rezonance magnetike për diagnostikimin e sëmundjeve të ndryshme.

Në mungesë të rezonancës magnetike, shumica e qytetarëve po detyrohen të presin shumë gjatë për të marrë këtë shërbim, kurse pjesa e qytetarëve që kanë urgjenca detyrohen të marrin shërbime në institucionet private, e ku kostoja e këtij shërbimi është shumë e shtrenjtë.

Pyetja ime drejtuar ministrit, i cili besoj do të përgjigjet në seancën e radhës është: a keni ndonjë plan për blerje të pajisjeve të reja, pasi që shumica e pajisjeve mjekësore janë shumë të vjetruara dhe përkundër servisimit të tyre, ato shumë shpesh po dalin jashtë funksionit dhe a ka një kërkesë apo a keni ndonjë planifikim konkret për blerje të aparaturës së rezonancës magnetike? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Nenad Rikalo.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Pyetja që ka të bëjë për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i cili çuditërisht nuk po merr pjesë në seancat e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk po e kryen detyrën e tij që e ka obligim, që t'i raportojë Kuvendit dhe deputetëve të zgjedhur për çështje të caktuara, ka të bëjë edhe pse më në fund raportoi në komision me dëmet e shkaktuara nga reshjet e fundit në disa treva të shtetit tonë.

Pyetja ime ka të bëjë se kur do të realizohet ky premtim i atyre dëmeve të shkaktuara nga të reshurat në javët e fundit? Është një shifër prej 1 milion e 200 mijë eurosh, e cila nuk është shifër e madhe, por për agroprodhuesit e Kosovës do të thotë shumë.

Nëse shteti heq dorë nga një ndihmë e tillë dhe nga një fond që të gjitha shtetet normale e ndajnë gjatë hartimit dhe planifikimit të buxhetit, atëherë këta njerëz do të dekurajohen, si pasojë do të

dekurajohet edhe agroprodhuesi vendor dhe atëherë çfarë mesazhi japim ne për krijimin e një klime normale për prodhuesit dhe agroprodhuesit në Republikën e Kosovës.

Pres që ministri me shkrim të më kthejë përgjigje adekuate në pyetjen që ia kam drejtuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Doruntina Maloku-Kastrati, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

DORUNTINA MALOKU-KASTRATI: Faleminderit, nënkryetar!

Atëherë pyetja për ministrin Lekaj është: kur do të udhëtojnë në rrugën e premtuar banorët e Llapit dhe të Gollakut, ndërsa çështja është se në muajin shtator të vitit 2016 ka filluar zgjerimi i rrugës nacionale Podujevë-Prishtinë, respektivisht deri te rreth rrotullimi në Besi. Pesë segmentet e kësaj rruge, e cila ka qarkullim më së shumti në Kosovë, janë paraparë të përfundojnë brenda tri ose katër vjetësh, mirëpo buxheti i ndarë për të është i pamjaftueshëm për t'i përmbyshur afatet e parapara.

Pra, unë do ta ruaj edhe një herë të drejtën që ta shtroj këtë pyetje kur ministri Lekaj të jetë në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Nezir Çopaj, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Edhe unë kam punë me ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, çështja ka të bëjë me infrastrukturën që lidh dy komunat Gjakovë dhe Prizren në rajonin e Hasit, por po e rezervoj edhe unë që kur të jetë prezent, shpresoj shumë që në seancën e ardhshme të jetë prezent dhe do t'ia parashtoj pyetjen, gjegjësisht të marr përgjigje konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Po, e di që nuk është ministri këtu, po pyetja është bërë në mesin e qershorit dhe i kalon aktualiteti. Bëhet fjalë për provimin e maturës. Testi i maturës, për të cilin shumë u tha se këtë herë është shumë i sigurt, megjithatë u bë publik në ditën kur nxënësit, maurantët, ishin në provim.

Pyetja për ministrin është se a janë zbuluar ata që e kanë publikuar testin dhe çka ka ndërmarrë ministria ndaj atyre që e kanë publikuar testin?

Ministri nuk është këtu, po besoj që do t'i vazhdojnë procedurat, t'i gjejnë njerëzit dhe të ndërmarrin masa dhe po ashtu ta njoftojnë opinionin publik me masat që i ka ndërmarrë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi ka edhe një pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ISMAJL KURTESHI: Po, edhe këtë do ta lexoj, fjala është për shkollimin e të miturve në qendrat e paraburgimit. Është një problem tejet i rëndësishëm, në Qendrën Korrektuese në Lipjan, gjenden një numër i konsiderueshëm i të miturve që e vuajnë dënimin bazuar në ligj. MASHT-i është i obliguar t'u sigurojë atyre vijimin e shkollimit brenda Qendrës Korrektuese.

Po ashtu shteti ka obligim të ndikojë edhe në risocializimin dhe aftësimin profesional të të rriturve që gjenden në burgjet e Kosovës dhe pyetja është se a po i kryen Ministria e Arsimit këto obligime, pasi që ka pasur informata se shpesh janë vonuar me organizimin e mësimin, sidomos për të miturit në Qendrën Korrektuese në Lipjan? Shpresoj që edhe për këtë çështje do të marrim përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Korab Sejdiu, pyetje për ministrin Bajram Hasani. Asnjëri nuk janë në sallë.

Deputeti Frashër Krasniqi, pyetje për ministrin Abelard Tahiri. Frashëri nuk është në sallë.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër Gashi,

Duke pasur parasysh se Policia e Kosovës po përballet çdo ditë me sfida të ndryshme dhe herë pas here me situata të rënda dhe të vështira, e dimë se problem për ta ende vazhdon të mbetet mungesa e sigurimit shëndetësor.

I nderuar ministër,

A mund të na thoni se kur do të bëhet sigurimi shëndetësor për Policinë e Kosovës? Pyetje shumë konkrete.

KRYESUESI: Urdhëroni, zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEJTUSH GASHI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar deputete Musliu,

Faleminderit për pyetjen!

Ndërsa lidhur me çështjen që e keni ngritur, ju informoj se sigurimet shëndetësore për të gjithë punonjësit e administratës publike, përfshirë këtu edhe zyrtarët e policisë, pritet të përcaktohen me ligj të veçantë, i cili duhet të votohet në Kuvendin e Kosovës.

Pasi që ky ligj është dhe sponsorizohet nga Ministria e Shëndetësisë, ju inkurajoj që pyetjen t'ia adresoni ministrit të Shëndetësisë.

Si ministër i Brendshëm ju siguroj se jemi në pritje të miratimit të këtij ligji dhe shpresojmë që më në fund ta zgjedhim këtë problem dhe shqetësim me interes për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, Ganimete? Po!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, ministër!

Edhe ju ishit shumë konkret, po ashtu sikur unë që isha shumë konkrete dhe direkte me pyetje, por më intereson të di si ministër i Punëve të Brendshme a keni bërë ndonjëherë kërkesë direkte te ministri i Shëndetësisë që të iniciojë këtë çështje, duke pasur parasysh punën dhe nevojën e Policisë së Kosovës për të qenë në situata të ndryshme, në vende të caktuara ose në kohë të caktuar. Sepse ne si Kuvend i Republikës së Kosovës, besoj jo vetëm unë, po deputetët e pozitës e opozitës jemi shumë të interesuar që Policia e Kosovës ta ketë sigurimin shëndetësor, duke pasur parasysh që ata janë të parët në mbrojtjen e të gjithë neve në rastet emergjente, por edhe sipas nevojës. Iniciojeni bashkë!

KRYESUESI: Urdhëroni, zoti ministër, jepni përgjigje shtesë.

MINISTRI BEJTUSH GASHI: Faleminderit për pyetjen shtesë!

Patjetër se kemi diskutuar rreth këtyre shqetësimeve dhe në të njëjtën kohë unë kam kontaktuar edhe Sindikatat e Shërbimit të Policisë së Kosovës, Shërbimit të Zjarrfikësve dhe zyrtarët tjerë publikë për të gjetur një zgjidhje alternative për sigurimin e jetës për shkak se punojnë me shkallë të rrezikshmërisë së lartë dhe në këtë drejtim jemi në përpjekje për të gjetur alternativa të tjera dhe normalisht për ne zgjidhje më fatlume do të ishte aprovimi i ligjit që do ta rregullonte këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Dëshironi ta bëni pyetjen?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Gjatë kohës së paradites ishte ministri këtu edhe m'u bë qejfi kur e pashë se mendova që do t'ia adresoj këtë pyetje dhe do të marr përgjigje direkte, por meqë pyetja ime mund të përsëritet edhe në seancën e radhës, këtë pyetje do ta shtyjë për seancën e radhës që ta ketë të qartë edhe Administrata. Do të thotë, pyetja për Shyqiri Bytyqin bartet në seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Xhelal Sveçla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse kryeministri nuk ka denjuar të vijë në seancë për t'iu përgjigjur pyetjeve, e shtyj pyetjen për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për ministrin Skënder Reçica.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë edhe para kësaj, në një interpelancë, e pata ngrehur çështjen e të riut 17-vjeçar nga Lugishta e Prizrenit, pra Selldin Alia, dhe kërkoj të di se a është në dijeni për këtë rast ministri, unë e di që është në dijeni, dhe se paraprakisht, pra ky i ri 17-vjeçar ka vdekur në vendin e punës. Po t'i shihte ministri fotografitë, ashtu siç i kam parë unë, sigurisht që do ta kishte shqetësim dhe se nuk do të mjaftohej me ato që ka thënë që Inspektorati ka shkuar në vendin e punës ku ka punuar ky djalosh në vitin 2015, sepse prej vitit 2015 kanë kaluar shumë vite.

Dhe se sot ka deklaruar shifra, të cilat me gjasë nuk janë shumë reale. Ka thënë që tërësisht në krejt territorin e Republikës së Kosovës punojnë 52 fëmijë, pra e kam fjalën për punë të rënda, e prej këtyre 38 fëmijë, pra kërkojnë lëmshë, 38 fëmijë ne i kemi në Prishtinë, 11 fëmijë punojnë në rrugë, 3 fëmijë në eksploatimin e pasurive natyrore, 11 fëmijë në rrugë pra kryesisht dalin duke mbledhur kënaçe, pastrojnë xhama, 3 fëmijë eksploatojnë pra pasuri të ndryshme, mbledhje të kërpudhave, të metaleve e tjera. Dhe, ministër, vetëm në gjashtë muajt e fundit kanë vdekur shtatë punëtorë, qoftë të rinj, apo edhe të vjetër.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Reçica, e ke fjalën.

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Rexhaj,

Shumë faleminderit për pyetjen e juaj!

Në fakt, lajmi për vdekjen e një të riu në vendin e punës, më 30 qershor 2018, në rrethinën e Prizrenit, na ka trishtuar të gjithëve. Unë personalisht shpreh edhe një herë ngushëllimet më të sinqerta për familjen e të ndjerit.

Ju informoj se me ta marrë informacionin për aksidentin, Inspektorati i Punës, në bazë të legjislacionit në fuqi, ka dalë menjëherë në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur aksidenti dhe i ka marrë të dhënat e para për të vazhduar më tutje në procedurat tjera, sipas legjislacionit në fuqi. Në bazë të informatave të Inspektoratit të Punës nga vendi i ngjarjes, ne i posedojmë të gjitha informatat sesi ka ardhur deri te aksidenti, me pasojë vdekjen e punonjësit në punë. I kemi edhe incizimet dhe fotot, të gjitha i posedojmë. Por, duke qenë se është rasti në procedurë të hetimit edhe nga organet tjera dhe që të mos i prekim emocionet e familjarëve, tani për tani do të kursehem, nuk do të jap informata të tjera, sepse rasti është duke u hetuar.

Çka kemi bërë ne si Ministri dhe Inspektorati? Me vendim të Inspektoratit të Punës, punëdhënësi është urdhëruar që ta ndalojë punën me këtë makinë deri në testimin e makinës. Shqetësimi është çka kemi bërë para se të ndodhë ky aksident. Është plotësisht e vërtetë që në vitin 2015 kjo ndërmarrje private është inspektuar nga Inspektorati i Punës dhe unë flas me statistika dhe me të dhëna që unë i posedoj, të raportuara nga Inspektorati i Punës, të cilat secili prej jush dhe secili qytetar i ka në dispozicion kurdo që kërkohet. Dhe, të dhënat flasin që kompania në vitin 2015 nuk ka pasur ndonjë veprimtari që ka qenë në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Inspektorati i Punës, në bazë të legjislacionit në fuqi, e ka një afat të caktuar kohor për ta finalizuar raportin zyrtar përkitazi me këtë aksident. Pasi të realizohet edhe hetimi policor, pasi të dalë edhe raporti zyrtar nga obduksioni, tek mandej Inspektorati i Punës, në bazë të legjislacionit në fuqi, e ka të drejtën ta nxjerrë raportin përfundimtar.

I nderuar deputet,

Të nderuar të gjithë ju deputetë,

Është e vërtetë që është një humbje e madhe për të gjithë ne kur dëgjojmë se po humb një jetë njeriu në vendin e punës, por ajo që dua t'i siguroj të gjithë qytetarët e vendit, por edhe ju, çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë jemi duke e trajtuar në përkushtim shumë të lartë dhe për këtë kemi bërë edhe fushata vetëdijesuese dhe po përpiqemi maksimalisht të punojmë në vetëdijesimin, si të punëdhënësve, po ashtu edhe të punëmarrësve, dhe jorastësisht kemi thënë “siguria dhe shëndeti i punonjësve mbi të gjitha”...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja fjalën ministrit që ta kryejë sqarimin.

MINISTRI SKËNDER REÇICA: E kemi shtuar angazhimin e Inspektoratit me qëllim të vetëdijesimit dhe parandalimit të aksidenteve në vendin e punës, me qëllim respektimin e të drejtave të punonjësve dhe të mosabuzimit me të drejtat e punëtorëve.

Inspektorati është në terren, e po të krahasohet për periudhën e njëjtë kohore ka dyfish më shumë inspektime se vitin e kaluar me numër të njëjtë të inspektorëve. Publikisht mund të flitet se nuk është Inspektorati në terren, nuk është duke e ushtruar detyrën si duhet. Publikisht i ftoj të gjithë punëmarrësit që në të gjitha rastet kur punëdhënësit e tyre nuk i plotësojnë kushtet e parapara sipas legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, të bashkëpunojnë me ne, të na informojnë që të marrim masa, por gjithashtu i ftoj të gjithë punëdhënësit që të mos lejojnë që punëmarrësit të punojnë pa pajisjet e nevojshme për siguri dhe shëndet në punë. Ky bashkëpunim me ne, përkatësisht me Inspektoratin e Punës, do ta rrisë akoma më shumë mundësinë e parandalimit të aksidenteve në punë, por do të ndikojë edhe në vetëdijesimin për rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Ne kemi paralajmëruar gjatë fushatës, po ju paralajmëroj edhe një herë këtu, do të jemi pa kompromis ndaj të gjithë atyre që nuk i respektojnë rregulloret dhe aktet nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në vendin e punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Rexhaj? Po!

ARBËR REXHAJ: Ministër!

Ju po flisni për fushata vetëdijësuese, e këtu po thoni siguria dhe shëndeti i punëtorëve mbi të gjitha, dhe unë po jua them që vetëm në gjashtë muajt e fundit i kemi shtatë punëtorë të vdekur. Për çfarë fushatash po flisni dhe po debatoni këtu? Për ato, të cilat marrin fonde e i harxhojnë kot së koti! Po thoni që punëtorët duhet t'i lajmërojnë organet kompetente, por a e dini që një punëtor i sektorit privat, pra po ta lajmërojë, ai më nuk do të jetë në vendin e punës. Për këtë juve ju nevojitet me njëfarë forme që ta ngrehni nivelin e përgjegjësisë në Inspektoratin e Punës, e kur thoni që në rastin e fundit pra të vdekjes së këtij djaloshi, Inspektorati e ka inspektuar këtë firmë në vitin 2015, ministër, në cilin vit jemi sot?

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit deputet për pyetjen shtesë!

E para, dua t'jua sqaroj juve dhe gjithë opinionit që fushata vetëdijësuese që ne e kemi ndërmarrë si ministri që ka të bëjë me vetëdijesimin e punëdhënësve, por edhe punëmarrësve, për sigurinë dhe shëndetin në punë është pa kosto financiare, është bërë nga vetë resurset e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe këtë dje e kam thënë edhe para komisionit kur isha në raport. Nuk ka asnjë shpenzim, i vetmi shpenzim është që janë printuar fletëpalosje, në të cilat personalisht unë jam duke marrë pjesë së bashku me Inspektoratin në shpërndarjen e tyre te punëdhënësit, por edhe te punëmarrësit.

Vetëdijesimi. Pajtohem me ty që ka plot punëtorë, të cilëve u shkelen të drejtat, por e kam frikën e deklarimit të tyre. Pikërisht kjo ka të bëjë me vetëdijesimin, prandaj publikisht i ftojme. Është e pamundur që ne secilin vendpunishtë ta vizitojmë çdo ditë dhe të drejtat, siguria dhe shëndeti në punë është me rëndësi të zbatohen. Të drejtat e punëtorit dhe siguria dhe shëndeti në punë është me rëndësi të jenë në standardet që ne i dëshirojmë, në standardet më të larta çdo ditë, e jo vetëm një ditë. Prandaj, vetëm vetëdijesimi i punëdhënësve dhe i punëmarrësve për t'i denoncuar rastet kur nuk ka siguri dhe shëndet në punë, për t'i denoncuar rastet kur abuzohet me të drejtat e punonjësve, do të na ndihmojnë neve në radhë të parë si institucione që t'i parandalojmë aksidentet, ta parandalojmë abuzimin e punëtorëve.

Prandaj, është shumë e qëlluar ajo që ne po përpiqemi ta bëjmë me qytetarët, me punëdhënësit, me punëmarrësit me vetëdijesimin. Të mos mbetem borxh, rreth raportit të djeshëm që kam thënë për 52 punëtorë që janë të mitur, që ne i kemi të dhënat sipas qendrave për punë sociale, ne flasim me shifra. Unë pajtohem që ti mund të kesh shifra dhe të gjithë ne mund të kemi shifra, realiteti mund të flasë diçka tjetër, por në realitet unë u referohem të dhënave zyrtare që neve na vijnë si ministri, na raportohet, dhe ato të dhëna që dje i kemi paraqitur para komisionit janë të dhëna që mund të vërtetohen në çdo moment nga secili qytetar dhe nga ju si deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Zyba, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zoti Zyba, ministri s'është këtu, në qoftë se dëshironi mund ta bëni pyetjen.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues!

Që s'është ministri këtu po e shohim të gjithë, se po dëshmohet në shumicën e seancave, por kisha pyetur për të ku është? Mos është në Arbitrazh, sepse pyetjen e kam për "Bechtel&Enkën". Kështu që e shtyj pyetjen për praninë kur të jetë ministri këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri ka pritur deri vonë, por më ka thënë që ka për të shkuar në udhëtim zyrtar, nuk e di ku. Kështu gojarisht më ka thënë, kështu që nuk mund të them që është as me "Bechtel&Enkën", as me dikë tjetër, por në udhëtim zyrtar ka thënë që është.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bedri Hamza. Albulena nuk është këtu. Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. S'është ministri këtu, Arbërie e doni fjalën? Fjalën zonjës Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Tashmë mosprania e ministrave në seanca nuk është përjashtim, por është rregull dhe është e dyta herë që ministri i Arsimit nuk është i pranishëm për pyetje, e për më keq ai tashmë nuk po u përgjigjet as pyetjeve me shkrim, kështu që unë pres dhe shpresoj që të paktën në seancën e radhës të jetë këtu, kështu që pyetjen e shtyj për seancën e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Abelard Tahiri. Deputetja nuk është këtu. Deputetja Fitore Pacolli, pyetje për zëvendëskryeministrin Behgjet Pacolli.

FITORE PACOLLI: Përshëndetje!

Unë e kisha një pyetje lidhur me paralajmërimet e shumta që kanë thënë ministrat e Punëve të Jashtme, pra në radhë duke filluar nga Enver Hoxhaj, Hashim Thaçi, e tani me zotin Behgjet Pacolli, të cilët kanë deklaruar se Zyra e Kosovës në Greqi dhe në Sllovaki do të hapet së shpejti. Pra, kanë kaluar disa vite dhe këto zyra asnjëherë nuk janë hapur. Unë pyetjen do ta ruaj për ministrin kur të jetë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Në fakt, unë bisedova me ministrin dhe megjithatë po e shtroj si pyetje, edhe pse kam marrë përgjigje kështu direkte, ndoshta është mirë edhe për opinionin publik.

Pra, zoti ministër, para disa javësh Komuna e Prizrenit, përkatësisht Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri u është drejtuar juve me një kërkesë për shtim të numrit të punëtorëve të zjarrfikësve, mirëpo kërkesa është refuzuar dhe meqenëse kjo pyetje është bërë shumë më parë, sot rastësisht e patëm edhe një protestë të zjarrfikësve të cilët kërkonin më shumë të drejta, rritje të pagës, gjë që u përmend nga shumë kolegë deputetë këtu, e s'po dua ta përsëris. Mendoj që kërkesat e tyre janë legjitime dhe meqenëse i dini të gjitha specifikat, unë do të mundohem ta shkurtoj paksa. Ju e dini që më KFOR-i Gjerman po largohet dhe nuk është në Prizren, prandaj mbeten në përgjegjësinë e atyre 25 zjarrfikësve të Prizrenit, kur numri është shumë i vogël, përderisa në komunat në regjion, për shembull, Gjakova ka 55, Komuna e Prishtinës ka 155 zjarrfikës dhe se Komuna e Prizrenit dhe e Prishtinës nuk dallojnë shumë në numër.

Prandaj, përveç asaj, në Prizren janë të rregulluar tashmë tre stacione të zjarrfikësve, është fjala për Zhur, Gjonaj dhe Reçan, të cilat janë të ndërhuara mirëpo ka mungesë të burimeve njerëzore. Prandaj, shpresoj në reflektimin tuaj dhe në përgjegjësinë që ta shtoni këtë numër në atë çfarë mund të përfundoj kërkesa.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar deputet Rexhaj,

Po e kam pranuar një kërkesë nga Komuna e Prizrenit. Nuk e kemi refuzuar kërkesën, por i kemi dhënë sqarimet ligjore, qysh ligji e rregullon këtë punë dhe çka ka mundësi të kryhet brenda ligjit.

Ministria e Financave e kupton gjendjen e zjarrfikësve në mbarë Kosovën, sa i përket statusit të tyre dhe kushteve elementare të tyre. Jam i përkushtuar që brenda kompetencave të miya t'u gjej një zgjidhje.

Sa i përket pyetjes suaj për numrin e zjarrfikësve në Komunën e Prizrenit, kam pasur parasysh, por siç u kam sqaruar edhe në përgjigjen Komunës së Prizrenit, kemi kufizime ligjore për arsye se sipas Ligjit të Buxhetit nr. 06/L-020 për vitin 2018 neni 12, pika 1, është cekur në mënyrë shprehimore se, nuk lejohet numri i të punësuarve në nivel në nënprogramin gjatë vitit fiskal 2018, ashtu siç është specifikuar në tabelën 3.1, 3.1/a dhe 4.1.

Çdo tejkallim i numrit të të punësuarve në ndarjet buxhetore të parapara për çdo nënprogram do të konsiderohet se nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të lartcekura. Për më shumë, aktualisht kompetencat e zjarrfikësve me ligj janë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjegjësisht në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, ndërsa buxheti dhe numri i të punësuarve, zjarrfikësve, ka mbetur në nivel komunal, sipas Ligjit të financimit pushteti lokal nuk ka lejuar bartjen e buxhetit nga niveli lokal në atë qendror. Në Ministrinë e Financave jemi duke punuar aktualisht në hartimin e koncept-dokumentit për financat lokale, me të cilën do të hapet rruga për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financa të pushtetit lokal.

Jemi duke paraparë mundësinë, që buxhetin për zjarrfikës ta bartim nga komunat në nivel qendror apo të barten edhe kompetencat nga niveli qendror në komuna, bashkë me buxhetin. Planin e kemi që këtë koncept-dokument ta aprovojmë këtë vit, ndërsa vitin e ardhshëm të bëjmë ndryshimet në ligj. Megjithëkëtë, më lejoni edhe një herë të theksoj se gjatë hartimit të Buxhetit të vitit 2019 do t'i kemi parasysh kërkesat e arsyeshme të zjarrfikësve të Kosovës, duke përfshirë edhe rritjen e numrit të tyre dhe duke përfshirë edhe përmirësimin e kushteve të tyre. Do të thotë, për buxhetin e vitit të ardhshëm nuk është pengesë që ne të reflektojmë, derisa të bëhet plotësim-ndryshimi i legjislacionit aktual në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, Arbër?

ARBËR REXHAJ: Atëherë, pra shpresoj që në hartimin e Buxhetit për vitin e ardhshëm të parashihet kjo rritje. Normalisht, do të ishte edhe në interes të qytetarëve të Prizrenit dhe këto kompetenca do të ishte mirë të barteshin nga niveli qendror, në komuna gjithandej, megjithatë ky mund të jetë edhe mendim imi subjektiv, por që duhet të shtrohet edhe si debat i gjerë, ku ata të cilët janë të fushës të diskutojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Situatë e ngjashme është edhe me disa kategori të tjera, siç janë inspektorët e tregut dhe inspektorët e veterinarisë. Kam pasur takime me zjarrfikësit dhe

konsideroj që është kategoria, e cila ka nevojë për përkrahje urgjente. Ka pasur ndryshime të statusit të tyre, të organizimit të tyre, nëpër vite në situata të ndryshme. Kanë nevojë për më shumë staf, kanë nevojë për më shumë pajisje dhe kanë nevojë për trajtim korrekt në aspektin material.

Unë jam i bindur, që gjatë Buxhetit të vitit 2019 do të reflektojmë në këtë drejtim dhe jam i bindur, duke parë situatën dhe nevojat shumë të arsyeshme, edhe kuvendi do ta përkrahë propozimin dhe besoj se do të reflektojmë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamza. Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Skënder Reçica. Haxhi Avdyli s'është këtu po më duket. Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Nuk është as deputeti, as ministri. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Besa, dëshiron ta marrësh fjalën?

BESA BAFTIU: Po, po e marr fjalën. Faleminderit!

Edhe pse, dje kishim në komision ministrin Ismajli, diku tri orë kemi diskutuar, por aq janë të mëdha problemet në shëndetësi, sa që nuk arritëm edhe të gjitha pyetjet t'ia parashtrojmë edhe dje në komision. Kështu që, ministri Ismajli ka deklaruar me të marrë mandatin si ministër i Shëndetësisë, u ka premtuar specialistëve të papunë, që në fillim të vitit 2018 do të punësohen.

Fatmirësisht, në Buxhetin e vitit 2018 janë siguruar mjete financiare për punësimin e 200 mjekëve specialistë. Një pjesë e tyre është punësuar, por ka një numër të madh të specialistëve që presin për t'u punësuar. Në mesin e këtyre specialistëve janë specialistë të fushave të ndryshme janë specialistë të fushave të ndryshme të mjekësisë, sidomos ka të stomatologjisë dhe psikologjisë dhe të psikologjisë klinike.

Pyetja për ministrin është: Sa mjekë specialistë janë punësuar në vitin 2018 deri më tani, sa specialistë janë të papunë dhe a do të bëjnë zgjidhje për punësimin edhe të këtyre mjekëve specialistë, që janë të papunë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Elmi Reçica, pyetje për ministrin Palë Lekaj. Ministri s'është këtu.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Paraprakisht po them që pyetjen do ta shtyj për seancën e radhës dhe dua të sqaroj që pyetja ka të bëjë me asfalt, sigurisht me një kycje në Autostradën Arbër Xhaferi. Krahasuar me të tjerët, unë i kam mbështetur projektet e Qeverisë në infrastrukturë dhe normalisht që kam të drejtë ta bëj këtë pyetje. Zoti Lekaj ishte paradite dhe ka pritur që ne seancën do ta kryejmë më herët, sepse ka pasur vetëm votime, por meqë e zgjatëm shumë, sigurisht se ai ka pasur edhe obligime të tjera.

Zoti Haliti, s'e di a më dëgjuat apo s'më dëgjuat, sepse ishit duke biseduar me kryetarin.

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj që pyetjet e deputetëve janë ezauruar. Pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje dhe nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Tani po vazhdojmë me rendin e ditës. Kemi një mocion nga zoti Nait Hasani. E kisha lutur që të...

* Mocion nga Nait Hasani...

Ju njoftoj që në bazë të nenit 44, pika 2 të Rregullores së Kuvendit kemi propozim me shkrim nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për plotësimin e rendit të ditës. Për këtë çështje ftoj naitin, që ta japë mendimin.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat edhe kryetarin, që është anash aty.

Komisioni për Administratë Publike ka pranuar një kërkesë nga kryeministri i Kosovës për procedimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, i cili ka kërkuar edhe i drejtohet Kuvendit që me procedurë të përshpejtuar ta trajtojë këtë projektligj.

Komisioni më 11. 7. 2018 në mbledhjen ka aprovuar që t'i drejtohet seancës për miratim në parim Projektligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës. Në bazë të propozimi jonë është që Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit me qëllim të përshpejtimit, shqyrtimit dhe miratimit të Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me propozim të Komisionit të Administratës Publike në seancën plenare të mbajtur sot, më 12 korrik 2018, mori këtë vendim.

Ne kërkojmë që datat e propozuara janë data e sotme, ose nesër më 13 korrik është për amendamente. E presim mundësinë më 18 korrik dhe seanca ta përmbyllë këtë projektligj me procedurë të përshpejtuar më 26 korrik. Po kërkoj nga deputetët, që ta miratojnë si pikë të rendit të ditës hyrjen e propozimit tonë për Projektligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së Komunës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hasani! Tani është deklarimi i grupeve parlamentare. Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk e përkrah shqyrtimin në procedurë të shpejtuar.

Arsyetimi është se çështjet duhet të shqyrtohen me kujdes, të njoftohemi me materien dhe interesin që kanë qytetarët në këtë drejtim. Ligji të vijë në procedurë të rregullt dhe t'i nënshtrohet debatit të mirëfilltë parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Memli Krasniqi nga Partia Demokratike e Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ne e përkrahim kërkesën duke u bazuar në arsyetimin që ka dhënë Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca, Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Nuk po më duket një prej atyre ligjeve që duhet të kalojë me këtë procedurë të përshpejtuar, prandaj ne mendojmë që meqenëse ka nevojë për një shqyrtim më të kujdesshëm të ligjit, të respektohen procedurat e rregullta të tij.

KRYETARI: Shqipe Pantina nga Partia Socialdemokrate, në emër të grupit, a? Po, urdhëroni!

SHQIPE PANTINA: Në fakt, ka një lloj pabarazie tash këtu në mes deputetëve, se anëtarët që janë edhe anëtarë të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e kemi marrë ligjin dhe kemi pasur mundësinë ta shqyrtojmë, por ndoshta të njëjtën mundësi nuk e kanë pasur edhe deputetët tjerë. Megjithatë, ky është një ligj që më shumë u hyn në punë dhe në fakt, i shkurton afatet për dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të komunave, se sa vetë Qeverisë. Prandaj, në mënyrë që t'i dalim në ndihmë komunave të cilave ky ligj u ndihmon që të tërheqim investime, ne e përkrahim kërkesën që ta procedojmë me procedurë të përshpejtuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi nga Aleanca.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Ne e përkrahim në parim, për shkak se prej leximit të parë deri në leximin e dytë mund të bëhen të gjitha përmirësimet përmes amendamentimit, por konsideroj se është një projektligj që është shumë i nevojshëm që të kalohet në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!
Po, edhe Nisma e mbështet propozimin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është grupet parlamentare, 6+-i, Lista Serbe nuk qenka. Sa deputetë janë në sallë? 53 deputetë. Mirë ka qenë... Kemi dy mundësi. T'i thërrasim deputetët më mirë do të ishte sot me i krye disa votime. E lëmë për votim më vonë. S'po e vë fare në votim, për arsye se s'kemi numër.

Po vazhdojmë me pikën:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara...

(Ndërprerje e incizimit)

Për rend dite, Fatmir Xhelili. Urdhëroni!

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, ministrat, të nderuarit deputetë!

Në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcave të Sigurisë, propozoj që edhe Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale të radhitet në këtë seancë plenare. Arsyet janë të shumta. Në komision ka kaluar, ka qenë e radhitur edhe në mbledhjen e kaluar, mirëpo nuk e di arsyen pse tash nuk ka qenë e radhitur për këtë mbledhje. Mirëpo, sidoqoftë i lus deputetët që të votojnë që të aprovohet kërkesa për t'u radhitur si një prej pikave për shqyrtim të parë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë kështu, 53 deputetë janë në sallë. Nesër në ora 11:00 e vazhdojmë seancën edhe pastaj edhe për këto çështjet të cilat janë. Po thonë në 11:00, njëjtë është... jo, jo, jo, si të dëshironi ju, vetëm për shkak tuaj. Prapë, vetëm pak, në 10:00, 11:00... a e bëjmë me votim, se po nxjerr yrnek edhe unë. A në 10:00 a në 11:00? Në 10:00 ora u krye. Në ora 10:00 e vazhdojmë të njëjtën seancë. Faleminderit!

* * *

E premte, më 13 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 12 korrik 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Lus që t'i zini vendet për të vazhduar me seancën, respektivisht me çështjet që na kanë mbetur pa i përfunduar.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që ta paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin.

Zoti Tahiri, e keni fjalën.

A, në rregull, zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Së pari, nuk është miratuar rendi i ditës, zoti kryesues. Kemi mbetur te pika e miratimit të rendit të ditës. Nuk mund të vazhdojmë pa e miratuar rendin e ditës.

Dhe, e dyta, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, nëse nuk arrini t'i keni 61 deputetë prezentë të koalicionit, ne do t' ju presim 30 minuta, bëni kuorumin, do të marrim pjesë në vazhdimin e seancës.

KRYESUESI: Ky është qëndrimi juaj, unë s'mund t'jua ndryshoj qëndrimin. Ne kemi hyrë në seancë dhe po e vazhdojmë seancën.

Zoti Tahiri e keni fjalën. Ne do ta shqyrtojmë ligjin, unë s'kam çka bëj.

(Ndërhyrje nga salla)

Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Kjo që sapo pamë prej Lidhjes Demokratike të Kosovës është denigrimi i radhës që këta ia bëjnë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Janë shtatë deputetë, prej 27-ve, se thirren në ata 27 si të ishin 120, shtatë deputetë i kanë në sallë, të cilët e kanë nënshkruar listën e prezencën për t'i marrë mëditjet, vijnë këtu, rrinë dy minuta, bëjnë hajgare duke shantazhuar me 61 deputetë.

Le ta dinë qytetarët e Kosovës që kjo është më shumë se tallje me Kuvendin, prej 27, kanë qenë 7 në sallë, edhe ata vijnë këtu për shantazhe e kushte a? Është turp që nënshkruhen për t'i marrë mëditjet, rrinë dy minuta, se gjysma e grupit parlamentar me siguri u kanë shkuar në pushim diku në bregdet dhe thonë këtu qysh varet prej neve kuorumi. Ky është veç një inskenim, se nuk e kanë pasur ndërmend të qëndrojnë kështu-ashtu, sepse do të duhej të ishin bile nja 20 prej 27, po ishin 7 deputetë. Është e turpshme të sillen në këtë situatë Kuvendi i Kosovës nga përfaqësuesit e zgjedhur të qytetarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Ulu, kanë kërkuar edhe të tjerë të diskutojnë, t'i kryejmë diskutimet një herë, se kanë vërejtje. Nuk po them është shantazh, po ne e kemi praktikë edhe ku nuk ka kuorum në lexim të parë t'i kapërcejmë, kush është i interesuar për t'i shqyrtuar ligjet, për të dhënë mendim për ligjin mund të jetë në sallë, kush nuk është i interesuar, nuk rri në sallë.

Rendi i ditës është miratuar në Kryesi, nuk ka pasur kuorum për t'u votuar dje mocioni i zotit Hasani, po kjo nuk do të thotë që e ndalon vazhdimin e seancës.

Zoti Ahmet Isufi e ka kërkuar fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet kjo është e turpshme, sepse sot është e premtë, dhe si duket kanë nevojë të shkojnë në vikend më herët, kjo nuk i bën nder këtij Kuvendi, për shkak se të gjithë deputetët, pavarësisht pozicioneve politike, jemi të barabartë këtu dhe nuk ka nevojë për vlerësime të tilla, çfarë ishte fjala e Grupit Parlamentar të LDK-së, po as shtatë deputetë nuk kanë në sallë për të treguar që bile ata janë, kuorum pati, sepse ishin në sallë deputetët, por kjo qëllimisht u bë për ta bllokuar Kuvendin.

KRYESUESI: Jo, nuk bllokohet Kuvendi. Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që në këtë Kuvend më së paku na nevojiten ligjërimet paternaliste, pra që t'ju tregojmë subjekteve politike se prej një pozicioni superior të analizohen sjelljet e tyre çka po bën dëm për Kosovën a çka po bën mirë.

Partitë politike konkurrojnë me programet të caktuara edhe krijojnë një strategji politike edhe në Kuvend, edhe bojkoti i Kuvendit është strategji politike, shumë legjitime bile. Nga ky aspekt, kisha propozuar të mos hyhet në kësi paternalizmi, në kësi diskutimi në kuptimin që një subjekt politik çka po bën në raport me elektoratin e vet.

Në raport me elektoratin tonë mund të përcaktohesh që ky Kuvend është tërësisht në drejtim të gabuar dhe për të mos ia mundësuar më shumë funksionimin, e aplikon një metodë të caktuar që ti, tek e fundit, je përgjegjës përpara atyre që të kanë votuar.

Pra, në këtë kuptim ne veç harxhojmë kohë këtu nëse mbajmë fjalime të tilla se çka po bën LDK-ja, a po bënë mirë a keq. Tek e fundit, u takon atyre.

Unë kisha thënë që për opozitën në përgjithësi do të ishte shumë më e shëndetshme një farë lloj koordinimi, qoftë edhe kur e bojkotojmë seancën që opozita ta ketë një farë lloj strategjie, e cila e ka efektin e vet kur është më shumë e koordinuar.

Sa i përket kuorumit, unë mendoj që në këtë Kuvend të Kosovës po ka shpesh probleme me kuorum dhe, në të vërtetë, kjo nuk është faji kryesor i opozitës, në përgjithësi pjesëmarrja e deputetëve është e ulët.

Shembullin jo të mirë është duke e dhënë edhe kryetari i Kuvendit, sepse ai shpesh po na mban këtu neve ligjërata se si duhet të jemi të pranishëm.

Unë jua dhashë, duke e dëgjuar atë kaq shpesh që flet për këtë punë, ua dhashë disa punëtorëve aty të administratës në zyrën tonë, thashë pse s'po ia bëni një analizë kryetarit të Kuvendit, desha të di prej krejt incizimeve të Kuvendit sa është i pranishëm. Ma kanë bërë analizën dhe ka dalë që 44 për qind veç është i pranishëm.

Nëse edhe kjo është e pranishme në kuptimin edhe prania e deputetëve, atëherë ne nuk kemi çka të ankohe mi te deputetët duke ia nisur prej të parit të Kuvendit është kjo praktikë.

Pra, në përgjithësi janë këto probleme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të cilën më së paku mund ta akuzojmë opozitën. Mirëpo, kur të vijë puna direkt si veprojme këtu, atëherë mendoj që çdo praktikë, e cila është brenda rregullave demokratike, është e lejueshme dhe gjykimin e bën qytetari i Kosovës dhe jo ne këtu.

KRYESUESI: Zoti Enver Hoti e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kjo gjendje që po shihet në funksionimin e Kuvendit mendoj që duhet t'i kemi dy gjëra parasysh dhe duhet të reflektojmë të gjithë.

Fillimisht dua të them se mazhoranca, apo deputetët e pozitës, duhet të ngremë pak më shumë seriozitetin dhe të jemi pak më të rregullt në seancat plenare, edhe në komisione dhe punën tonë ta kryejmë ashtu si duhet.

Nën dy, ajo çka po ndodh me një pjesë të opozitës, duke zhvilluar aktivitetin e vet që është krejtësisht legal e legjitim dhe nuk mund ta kontestojnë aspektin e vendimmarrjes së tyre politike, për një aktivitet që do të thosha opozitar i përqendruar vetëm me refuzimin e votimeve kur nuk ka numra dhe në aktivitet për të tentuar për të bllokuar apo paralizuar punën e Kuvendit, mendoj që është një opozitë që e kemi thënë disa herë, e çakorduar, e cila nuk ka ndonjë përqendrim për të ndihmuar në zhvillimin e vendit.

Ju e dini që në rend të ditës kemi edhe disa projektligje, të cilat janë në interes të agjendës së reformës evropiane dhe kjo është një pengesë.

Mendoj që nuk janë seriozë as karshi temave për të cilat duhet t'i trajtojmë, pavarësisht se fajin mund ta kemi në mënyrë të përqendruar në vonimin e këtyre projektligjeve edhe Qeveria, edhe pozita, por unë mendoj që nuk është momenti që opozita të shfrytëzojë këtë rast dhe të zhvillojë një aktivitet dhe masa të tilla çfarë po i ndërmerr.

Sidomos mendoj që LDK-ja po del jashtë atij rrugëtimi të vet politik, po është detyrë e tyre, është vendim i tyre dhe ne nuk mund të hyjmë atje. Mirëpo, unë edhe një herë bëj thirrje që deputetët e pozitës të jemi më seriozë dhe të jemi më aktivë në detyrat tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Janë edhe dy deputetë të paraqitur, Hajdari dhe Milaimi. Zoti Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrat,

Deputetë,

Qytetarët,

Realisht unë e mora fjalën të flas në emër të Komisionit për Legjislacion, por megjithatë po i them dy fjalë pasi u ndalëm në këtë temë.

Mandati i deputetëve buron nga qytetari, nga populli dhe konsideroj që vullneti i popullit nuk është që ne të bëjmë hajgare me vullnetin e tyre. Duhet t'i ndajmë çështjet, edhe pozita, edhe opozita, e kemi obligim të marrim pjesë në seancë.

Kemi të drejtë bojkotimi, por të bëjmë hajgare me vullnetin e popullit, duhet të dallojmë votimin dhe pjesëmarrjen në seancë. Nuk do të thotë të vish, të nënshkruash e të marrësh mëditjen dhe të shkosh në Shqipëri apo diku tjetër në vikend.

Kurse nuk dua të bëhem zëdhënës i partive të tjera, as t'i arsyetoj, po as të them çka kanë bërë, po edhe zoti Konjufca kur flet për një personalitet, në këtë rast, për kryetarin e Kuvendit, duhet pasur parasysh se kryetari ka edhe nënkryetarë që e përfaqësojnë, është kryetar i Partisë Demokratike, është partia më e madhe në koalicion dhe ka edhe obligime të tjera si kryetar i Kuvendit. Pasi po ia mban agjendën kryetarit, është mirë të bëhet një analizë edhe sa po i kryen detyrat Vetëvendosja si parti parlamentare, apo a po afron ndonjë alternativë në Parlament apo vetëm po bojkoton Parlamentin. Apo të analizohet edhe kryetari yt, a po ka kohë të qëndrojë këtu, a veç po vjen e po nënshkruan sikur sot, e merr mëditjen e shkon në shtëpi, po nuk po ndalem më në këtë çështje, të bëhem më serioz secili.

KRYESUESI: Po, po! Zoti Konjufca, replikë.

GLAUK KONJUFCA: Është një farë mentaliteti interesat këtu edhe prej zyrtarëve të Qeverisë, edhe prej atyre që janë kështu, sikur të thuhet shërbëtorë, si puna e Hajdarit.

Kur është puna te kryetari i Parlamentit, kryetari i Parlamentit është edhe kryetar i PDK-së, ai mund të ketë agjendë partiake, ama seanca e Kuvendit është të enjten, është një ditë në javë, nganjëherë edhe dy po na ndodh, atë kohë është i zgjedhur për ta udhëhequr seancën e Kuvendit dhe për të qenë në Kuvend. Nëse nuk është, të mos u thotë të tjerëve pra. Le të thotë që edhe të tjerët, sikur unë që po e aplikoj këtë shembull, secili edhe prej deputetëve nuk është e nevojshme të qëndrojë, të rrinë 30-40% në seancë dhe ndiqeni shembullin tim. Po jo të jetë i pari i Kuvendit, i cili nuk e aplikon këtë teori dhe pastaj shet mend se si duhet të jetë disiplina e deputetit.

Edhe kryeministri e ka po këtë mentalitet, edhe ata që po e arsyetojnë kryeministrin. Po thonë kryeministri e ka agjendën e ngarkuar, nuk ka kohë të vijë në interpelancë. Në Republikë parlamentare, edhe qysh është e rregulluar me Kushtetutë, puna e parë e kryeministrit, prioriteti i parë i tij është kur t'i shkojë letra në zyrë për interpelancë, t'i anulohet të gjitha aktivitetet e tjera dhe të thotë se më duhet të shkoj në Parlament nja tri orë, nuk është shumë dhe të debatojë me deputetët atë kërkesë që e kanë ngritur.

Domethënë, këtu është një farë mentaliteti për ta bërë të parëndësishëm, për ta relativizuar Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A nëse e shihni me Kushtetutë se çfarë sistemi politik ne jemi duke ndërtuar, Kuvendi duhet të jetë epiqendra e zhvillimeve politike, se ashtu është i ndërtuar sistemi ynë politik.

Po në përgjithësi, edhe prej mazhorancës, edhe prej partive në pushtet, edhe prej Qeverisë është një farë tendence e vazhdueshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hajdari ka kundër-replikë.

HAJDAR BEQA: Kam të drejtë me Rregullore, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Unë, Glauk, po them që keni të drejtë ta bojkotoni, po është mirë të jeni të sinqertë edhe me veten, edhe me qytetarin, bëni bojkotin pa e nënshkruar për të marrë mëditjen, jo të vini të nënshkruani, qysh e bëri kryetari yt tash, Albini, e doli jashtë. Bëjeni para se ta nënshkruani, është e drejtë demokratike juaja.

Unë nuk di çfarë vlerësimi ju bën ti personaliteteve në këtë rast, çfarë komisioni ke, çfarë aftësie ke ti t'u bësh vlerësim të tjerëve, por megjithatë është mirë të bëheni të sinqertë edhe ju të votoni, kurse e drejta e bojkotit është e drejtë demokratike dhe keni të drejtë ta bëni. Nuk është mirë të keqpërdoret, ne e dimë që disa deputetë, edhe të opozitës, edhe të pozitës, janë në udhëtim jashtë vendit.

Sot nuk është e enjte, po është e premte, por megjithatë mendoj që duhet të jemi të përgjegjshëm secili deputet për të marrë pjesë në seancë, sepse për atë edhe paguhemi, po edhe kemi marrë besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Tash e kam pak problem ta mbroj kryeministrin, se Glauku thotë këta shërbëtorët e kryetarit të Kuvendit ose të kryeministrit, e tjerë, e tjerë. Hiç nuk besoj që është e sinqertë dhe përmbajtjesore të akuzohen njerëzit se shërbëtorë të kujt janë. Të mos hapim kapituj dhe debate të tilla.

Zoti nënkryetar i Kuvendit,

Mungesa e deputetëve në sallë shpeshherë është pasojë e mosplanifikimit si duhet, disa deputetë janë në udhëtime zyrtare. Unë po marr vesh se deputetët e Partisë Socialdemokrate të Kosovës janë në një punëtori, janë 12 prej tyre që nuk janë në seancë sot. Gjashtë deputetë pas pak nisen për Mitrovicë, kanë një debat me qytetarët atje.

Prandaj, unë apeloj, për shembull, që të analizohen të gjitha rrethanat kur caktohet vazhdimi i seancës. Nuk po besoj që ka kushte për të vazhduar seanca sot.

Ju kisha sugjeruar që ta ndërpresim dhe të vazhdojmë ditën e hënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milosavljeviq, urdhëro!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Ova situacija se unazad nekoliko sednica non-stop ponavlja da nemamo kvorum, bez obzira što su i prisutni poslanici u sali više od 61.

Ja mislim da svaki poslanik bilo u opoziciji bilo u poziciji treba da postavi sebi jedno prosto pitanje. Da li želi da radi svoj posao ili ne želi da radi svoj posao?

Najlakše je blokirati rad sednice ali to nije suština zbog koje smo mi ovde. I mi nismo ovde sami zbog sebe, mi smo ovde zbog ljudi koji su glasali da budemo u ovoj Skupštini i da rešavamo njihove probleme. Na ovaj način mi stojimo u mesto čak što više i idemo u nazad.

Ne rešavamo ni jedan problem naših građana, a mi smo upravo zbog njih ovde. Trebamo da budemo samo kritični i da kritikujemo sebe, a ne da uvek tražimo krivca u nekoj drugu.

Ovde svih poslanici koji nisu na sednici iz opravdanih razloga nisu zbog toga što su neodgovornih prema samom sebi i neodgovornih su prema poslu koji radimo.

Ta praksa bi trebala da se prekine i velika je šteta što na onoj sednici nije usvojen predlog da poslanici koji nisu u deset sati ovde i ne budu u pet sati na glasanje ovde, ne dobiju dnevnicu za taj dan.

Ja mislim da bi trebalo to pitanje se pokrene ponovo kada budemo imali kvorum, i da postignemo koncensus oko toga i usvojimo taj predlog i da se ova praksa nedolaskom na posao prekini.

KRYESUESI: Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, nënkryetar!

E para, unë mendoj që në Parlament të Kosovës, përpos miratimit të ligjeve, kontrollin që duhet ta ushtrojmë ndaj ekzekutivit, jemi këtu edhe për të komentuar edhe sjelljen qoftë të një partie politike, ose të një deputeti.

Pastaj, varet nga rezoni ynë politik, nga kultura jonë politike, nga kultura familjare se deri në çfarë shkalle ne mund ta gjykojmë njëri-tjetrin.

Personalisht mendoj se sjellja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, jo vetëm sot, por edhe e një pjese të madhe të deputetëve, qoftë të pozitës, qoftë të opozitës, është barazi me sjelljen e shumë

profesorëve universitarë, të cilët e kanë shkatërruar universitetin duke punuar në pesë universitete e duke mos shkuar kurrë përpara studentëve.

Ne nuk e marrim rrogën nga Kuvendi i Kosovës që veç të vijmë e të nënshkruajmë dhe të ikim në punët tona. Ne jemi këtu për të votuar ligjet që janë interes kombëtar, interes i shtetit të Kosovës.

Në qoftë se opozita, së bashku edhe me ne pozitën merremi vesh që të shkojmë në zgjedhje të parakohshme, atëherë mund të ulemi, të bisedojmë e ta caktojmë një datë për zgjedhjet e parakohshme.

Mu ma ha mendja, aq sa mund ta analizoj qëndrimin politik të opozitës, më së paku ata janë të interesuar, sidomos Lidhja Demokratike e Kosovës të shkohet në zgjedhje të parakohshme, sepse ju e shihni që ata përpos që s'kanë qëndrim fare as ndaj ligjeve, as nuk kanë qëndrim karshi Qeverisë, as ndaj debateve këtu, s'kanë qëndrime të unifikuara as për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë.

Prandaj, mbi bazën e kësaj unë e quaj si një gjest jo të hijshëm qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e quaj gjest jo të hijshëm mungesën e deputetëve të pozitës që vazhdimisht mungojnë në seanca, po edhe gjest jo i hijshëm i Partisë Socialdemokrate që sot nuk kanë ardhur, do të duhej të paktën dje të thoshin që nuk do të vinë në seancë.

Unë dy gjëra po i propozoj, zëvendëskryetar i Parlamentit, që sot të paktën ta harxhojmë debatin rreth ligjeve e të hënën ose të martën, kur e kemi seancën, vetëm të futemi në votime.

Dhe, e dyta, i propozoj sekretarisë të Kuvendit që të hapë një program online, ku deputetët e kanë mundësinë të regjistrohen kush do të marrë pjesë nesër në seancën e ardhshme e kush nuk merr pjesë. Mbi bazën e kësaj, atëherë Kryesia merr vendim të vijmë a jo.

Edhe ne kemi angazhime familjare dhe punë të tjera. Besoj që shumica nga ne që sot jemi prezentë kemi mundur të jemi me familje tona, e jo ne të vijmë e sherri i disa të tjerëve të shtyhen seancat pafundësisht, është me të vërtetë marre, marre para qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Realisht ne kemi kuorum, por janë në bufe deputetët.

Kemi 61 deputetë, atëherë meqenëse janë 61 deputetë, unë po e fus edhe një herë në votim mocionin e zotit Nait Hasani që ka kërkuar, po e lexoj edhe një herë: Kryetari i Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zoti Nait Hasani, në seancën e djeshme, më 12 korrik 2018, ka propozuar që shqyrtimi i projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës të bëhet me procedurë të

përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, si dhe shqyrtimi i parë i këtij projektligjit të radhitet në seancën e sotme plenare.

A jeni dakord që të radhitet? A ka dikush kundër? Nuk ka!

Atëherë konsideroj që edhe kjo pikë e rendi të ditës, a po doni me elektronikë?

Po, mirë de! Me elektronikë të votojmë!

S'e di tash për votim, Samiu doli, mbetën 60 deputetë. A po e presim Sami Kurteshin le të vijë, besoj që u kthye.

Edhe një herë e nxjerr në votim mocionin e Nait Hasanit dhe rendin e ditës, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Nait, nuk miratohet!

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. E ftoj zotin Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, që ta arsyetojë projektligjin. Në sallë kemi 61 deputetë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë e përfituar me veprë penale ka qenë prioritet themelor dhe jam shumë i lumtur që kemi arritur ta konsolidojmë një draft që u jep zgjidhje problemeve të deritanishme që janë hasur në praktikë, si dhe avancon politikën tonë shtetërore të konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Ky projektligj është shprehje e përkushtimit tim të plotë së bashku me partnerët tanë zhvillimorë, me theks të veçantë Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë për të mos qëndruar indiferent para realitetit ku individë dhe grupet e krimit të organizuar përfitojnë nga pasuria e përfituar me veprë penale. Projektligji është hartuar me konsultimet e gjera me shoqërinë civile, si i tillë reflekton një konsensus të përgjithshëm mbi atë se çfarë qëndrimi po merr Republika e Kosovës ndaj pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Të nderuar deputetë,

Projektligji i ri ka sjellë disa risi të mëdha, të cilat do t'i përmend shkurtimisht. E para, vepra penale me të cilat vlen konfiskimi i pasurisë të paligjshme, janë shtuar dukshëm. Në këtë projektligj renditja e veprave penale, ku parashihet konfiskimi i pasurisë janë: vepra penale të

krimit të organizuar, vepra penale të korrupsionit dhe veprat penale që ndërlidhen me keqpërdorimin e detyrës zyrtare, veprat penale kundër shëndetit publik, veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore, vepra penale lidhur me konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit, veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, veprat penale që ndërlidhen me substancat narkotike dhe armët, veprat penale kibernetike, ato kundër ekonomisë së vendit, kundër pronës dhe kundër ambientit. Pra, kemi një listë më të gjerë të veprave penale, për të cilat institucionet e sistemit të drejtësisë do të kenë mundësi të ushtrojnë procedurën e konfiskimit.

E dyta, konfiskimi është zgjeruar në kuptimin e konfiskimit të çdo pasurie të përfituar me vepër penale në dhjetë vjetët e fundit, nga momenti i nisjes së hetimit për një vepër penale të listuar më lart. Këtu nuk bëhet fjalë thjesht për koncept retroaktiviteti, po për idenë se institucionet tona të drejtësisë duhet të kenë mundësi për të shkuar së paku dhjetë vjet prapa për të konfiskuar çdo pasuri që eventualisht është përfituar me vepër penale dhe e cila nuk mund të lihet në përdorim të një personi që ka rënë ndesh me ligjin në ndonjërin nga veprat e listuar më lartë.

E treta, konfiskimi është zgjeruar jo vetëm për të pandehurit, por për palët e treta nëse nuk janë blerës “bona fide” i asaj pasurie. Masë kjo për të pamundësuar transformimin e pasurisë së të pandehurit te palët e tjera me qëllim të fshehjes apo të përdorimit për interes të të pandehurit. Pra, askush nuk mund të ketë mundësi që pasurinë e përfituar me vepër penale ta fshehë ose ta transferojë tek një palë e tretë me pretekstin për t’iu shmangur konfiskimit. Procedurat për blerësin “bona fide” janë sqaruar mjaftueshëm, prandaj asnjë palë e tretë që nuk është brenda konfiskimit të blerësit “bona fide” nuk mund të tjetërsojë pasurinë e të pandehurit të dënuar me vepër penale. Po ashtu, projektligj parasheh edhe konfiskimin e pasurisë të çdo veprave penale që ka sjellë përfitime materiale mbi 10 mijë euro. Pra, çdo vepër penale tjetër, përveç këtyre që janë listuar në projektligj dobia materiale, të cilën tejkalon shumë prej 10 mijë eurosh, do të jetë subjekt i konfiskimit.

E katërta, ndër më të rëndësishmet, barra e provës me këtë projektligj kalon nga prokurori tek i dyshuari përmes një sistemi proporcional, ku prokurori duhet të dëshmojë se pasuria e listuar për verifikim është pasuri e të pandehurit, ndërsa i pandehuri duhet të dëshmojë se atë pasuri e ka përfituar me burime të ligjshme, për të cilat duhet të ofrojë prova, në të kundërtën konfiskohet me vendime gjykatë. Pra, në vend se të dëshmojë prokurori se pasura e të pandehurit është fituar me vepër penale, ai vetëm duhet të precizojë se cila është pasuria e të pandehurit, ndërsa i pandehuri duhet të ofrojë dëshmi se atë pasuri e ka përfituar në mënyrë të ligjshme. Kjo shënon gatishmërinë tonë për të dëshmuar se Republika e Kosovës dhe shoqëria jonë nuk mund dhe nuk do të tolerojnë përfitime me vepër penale.

E pesta, janë sqaruar të gjitha procedurat dhe koha për të nisur procedura të tilla të konfiskimit pas një vendimi të gjykatës, me anë të cilit shpallet fajtor personi për një vepër penale të listuar

në këtë projektligj. Rrjedhimisht, pas përfundimit procedura ndaj të pandehurit për veprë penale me anë të cilit ai shpallet fajtor për atë veprë, prokurori ka kohë deri në pesë vjet pas aktvendimit për të verifikuar pasurinë e të pandehurit. Po ashtu, një mundësi e rëndësishme që parasheh projektligji është edhe mundësia për prokurorin që krahas hetimit për veprën penale ndaj të pandehurit, me qëllim të listimit të saktë të pasurisë, ai mund të nisë procedurën e hetimit për konfiskim në çdo fazë të procedurës penale, para ngritjes së aktakuzës, pas ngritjes së aktakuzës, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe deri pesë vjet mbrapa mbas vendimit gjyqësor.

Po ashtu, janë paraparë masa që mundësojnë një bashkëpunim më të ngushtë mes prokurorit dhe personave që mendohet se mund të kenë informata për pasurinë e të pandehurit.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është ndër më të rëndësishmit në angazhimin tonë në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si e tillë Republika e Kosovës klasifikohet si vend, si një prej shteteve me sistemin më të avancuar në rajon dhe brenda vetë Bashkimit Evropian sa u përket procedurave dhe modelit të konfiskimit të pasurisë së fituar me veprë penale, pra pas miratimit të këtij projektligji. Ky projektligj është shprehje e vullnetit tim politik si ministër i Drejtësisë për luftë të pakompromis kundër këtyre dukurive dhe si i tillë tregon përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përcjellë një mesazh të fuqishëm ndaj gjithë atyre që për vite në mënyrë të paligjshme kanë përfituar pasuri nga veprat penale, se një gjë e tillë tash pas miratimit të kësaj politike, do të jetë vërtet e pamundur.

Është shprehje e vullnetit të institucioneve tona për të konfiskuar çdo pasuri të paligjshme dhe për të kthyer prapa institucionet e Republikës së Kosovës, rrjedhimisht një ftesë për reflektim për të gjithë ata që kanë menduar se do të mund të shfrytëzojnë në çfarëdo mënyre atë pasuri që e kanë fituar me veprë penale.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është bërë, siç e ceka edhe më lart, në bashkëpunim edhe me Komisionin Evropian dhe adreson po ashtu, një prej të gjeturave të Raportit për vendin edhe të vjeshtës së vitit 2016, edhe të këtij raporti të fundit që e patëm para disa muajve. Unë mendoj që është një prej projektligjeve më të rëndësishme që kam proceduar deri sot për dhjetë muaj në cilësinë e ministrit të Drejtësisë. Kërkoj nga të gjithë ju, pozitë e opozitë, edhe ata që sot nuk janë në sallë që ta përkrahni këtë politikë dhe që ta bëjmë një hap përpara drejt konfiskimit të çdo pasurie që është fituar në mënyrë të paligjshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të komisionit kush e ka fjalën? Zoti Beqa e ka fjalën në emër të Komisionit Funkcional, meqenëse kryetarja, zonja Haxhiu, s'është këtu.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Ministrat,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, më 10.07.2018 e shqyrtoi në parim Projektligjin 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe konstatoi se projektligji i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim. Për këtë arsye, ne si komision i rekomandojmë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit në pajtim me Rregulloren e Kuvendit. Nëse më lejohet, edhe në emër të Grupit të Partisë Demokratike.

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Është një projektligj i mirë, është avancim i kuadrit ligjor në reformën e drejtësisë. I tha edhe ministri, zoti Tahiri, të gjitha ato çka përfshin ligji, por ne si Grup Parlamentar e kemi analizuar, kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve, ka pasur ndoshta ndonjë rezervë, por mes dy leximeve do ta japim përmes amendamenteve kontributin tonë dhe me kohë do t'ia drejtojmë grupit punues, Komisionit për Legjislacion, në afatin më të shpejtë kohor, do të thotë në mbledhjen e parë do ta bëjë edhe grupin punues dhe do të jemi të hapur për të gjithë të bëhen plotësim-ndryshimet e mundshme në këtë projektligj. Ne në këtë rast e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Kjo me të cilën po merremi sot është tema më e rëndësishme prej vitit 1999, sepse në shoqërinë tonë, siç dihet, për shkak të funksionimit të dobët të gjyqësorit dhe të drejtësisë e kemi parë përgjatë viteve një dukuri, të cilën, le të themi, e ndjen dhe e kupton secili qytetar. Dukurinë e shëmtuar që këta njerëzit e krimit të organizuar të fitojnë milionat shumë shpejt, jo edhe bash në mënyrë të fshehur, të mos i fshehin asetet, bile edhe t'i tregojnë pronat e tyre, të cilat shumëfishohen brenda viteve dhe krejt ky zhvillim të ndodhë përpara syve tonë, përpara syve të drejtësisë dhe të mbetet i pandëshkuar.

Kështu që kjo temë le të themi e ka marrë krejt vëmendjen prej fillimit, mirëpo këtu në Kosovë ai dëshpërimi më i madh i shoqërisë, i qytetarëve, ka qenë që këtu nuk ka pasur kurrfarë strategjie dhe vullnet politik për t'iu kundërvënë kësaj dukurie. Ka dalë një raport shumë interesant i Bashkimit Evropian në vjeshtën e vitit të kaluar, i cili është marrë vetëm me këtë fenomen, me fenomenin e krimit të organizuar që i krijon asetet e tij të paligjshme. Unë e kam lexuar atë raport, i cili ka të bëjë sidomos me konfiskimin e pasurisë të paligjshme dhe

përfundimet janë me të vërtetë shqetësuese. Për shembull, aty thuhet që sukcesi i krimit të organizuar në Kosovë bazohet në përdorimin efektiv të aseteve të përfituara në mënyrë kriminale. Pra, në Kosovë nuk konfiskohet pasuria e krimit të organizuar, statistika është goxha brengosëse, thuhet që vetëm vitin e kaluar janë zbuluar 11 milionë të krimit të organizuar, e është konfiskuar vetëm 1 e 11-ta pjesë e atij fondi, domethënë nga 11 milionë, të cilat dyshohet që janë të përfituara në mënyrë të paligjshme, është konfiskuar 1 milion e diçka.

Pra, efektiviteti i konfiskimit në Kosovë është më pak se 10%, që është e tmerrshme si statistikë. Autoritetet e drejtësisë nuk kanë kurrfarë strategjie për targetimin e profitit që e fiton krimi i organizuar. Më tronditëse është që në Kosovë nuk ka vullnet dhe nuk ka as kapacitete, unë mendoj që me qëllim ka kapacitete, jo pse ne nuk dimë apo pse nuk ka resurse profesionale, por kjo është me qëllim. Pra, nuk kemi kapacitete dhe vullnet për identifikimin e pasurisë dhe aseteve të përfituara në mënyrë të paligjshme. Në Kosovë pothuajse nuk ekziston asnjë institucion i profesionalizuar për hetimin e rrjedhave financiare të krimit të organizuar dhe transaksioneve financiare në rrjetin e krimit të organizuar. Domethënë, ajo fusha ku Kosova më së dobëti qëndron, domethënë sistemi ynë gjyqësor hallkën më të dobët e ka qysh t'i përcjellë rrjedhat, transaksionet financiare të krimit të organizuar, edhe ato ndërkombëtare. Pra, transferimin e fondeve prej një shteti në shtetin tjetër.

Në Kosovë mekanizmat e targetimit dhe të shpëlarjes së parave janë jofunksionalë, s'ka as specializim dhe as trajnim, çka është më e keqja, që të prodhohen kuadro të reja, për shembull, për t'i kuptuar më mirë modulet dhe për t'i aplikuar modulet e hetimit të krimit financiar. Ligji i Kosovës për konfiskimin e pasurisë ka qenë joadekuat, por unë këtu e kam domethënë një polemikë me ministrin, absolutisht ky ligj nuk sjell kurrfarë ndryshimi kualitativ sa i përket qasjes në luftimin e aseteve të krimit të organizuar. Pse? Këtu nuk ka pasur kurrfarë lëvizje, të thuhet, të ndjeshme sa i përket barrës së provës. Kjo është hajgare! Kjo është rishkrim i ligjit të mëparshëm sa i përket kategorisë së barrës së provës. Prapë, derisa të vijmë deri te vendimi i prerë i gjykatës për ta argumentuar veprën penale, barra e provës krejt është mbi prokurorin, ende është mbi prokurorin. Edhe në këtë ligj mund ta lexoni, domethënë procedurat e hetimit nuk janë prekur kurrgjë, prapë është barra te ana e drejtësisë, domethënë te pala e prokurorit.

Nuk është çështja kur të vijë te faza finale e shqiptimit të veprës penale, shqiptimit të dënimit. Ne çka kemi pasur në Kosovë nevojë, për atë i ke krejt kritikën edhe të Raportit të Progresit, edhe çdo vlerësimi ndërkombëtar që vjen prej Bashkimit Evropian që të thonë, ministër, që barrën duhet zhvendosur, duhet zhvendosur te i akuzuari. Ju çka keni bërë? Në fazën finale e keni aplikuar njëfarë lloj proporcionaliteti që ju po thoni, por esenca është te procedurat initiale të hetimit. Një prokuror po heq shumë, se e para, aty po kombinohen disa faktorë, duke filluar prej mungesës së kapaciteteve dhe të ekipeve hetuese, e deri te ndikimet politike, shantazhi, kërcënimi, frika e ndonjë prokurori, e kështu me radhë. Ai po e ka të vështirë të vijë deri te argumentimi i veprës penale, këtu është esenca, qysh të vijë deri te vepra penale? Në këto

procedura fillestare ti duhet t'ia lehtësosh punën prokurorit që i akuzuari t'ia argumentojë atij teknikisht. Nuk kemi ne, o ministër, prokurorë e të dalë ai nëpër firma të ndërtimit e t'i kërkojë faturat vetë sa ka kushtuar banesa, a toka, prona e paluajtshme. Ku të vrapojë tash prokurori e t'i mbledhë faturat vetë. Me ligj tash, këtë ligjin që e ke bërë, këtë ligjin e dobët që e ke sjellë në Kuvend të Kosovës, tash prapë prokurori duhet të vrapojë që t'i grumbullojë faturat, a po e di këtë punë?

Kosova ka nevojë për një ligj që faturat t'i sjellë i akuzuari...

(Ndërhyrje nga salla)

Jo nuk është ashtu. Pra, krejt kjo çka është kërkuar edhe vazhdimisht është konsideruar si pika e dobët, ajo "thembra e Akilit" që thuhet brenda sistemit tonë të drejtësisë është që duke filluar prej rasteve initiale të hetimit, që është komponentë hetuese e Policisë, ti aty e ke fuqinë t'i mbyllësh rastet. Ky është njëri prej defekteve më të mëdha në sistemin tonë të drejtësisë. E keni zhvendosur krejtësisht në Polici, domethënë prokurori është krejtësisht i varur prej Policisë, nuk ka kurrfarë burimi tjetër anësor që gjyqësori të ketë fuqinë e tij ta shtyjë hetimin përpara dhe ta nisë hetimin. Atij i vjen prej policit, policia ia bie dosjen, polici e mbyll dosjen, kjo puna që ke, a e patë kjo puna me këtë drejtorin e Policisë që e rrahu atë shefin e Postës midis qytetit! Meqenëse vetë rasti i tij varët prej policisë dhe ky është shef i policisë, rastin e dërgon në Gjilan te një shok i veti dhe ai ia mbyll rastin.

Ky është problemi në Kosovë. Domethënë, në njërin anë e ke koncentruar krejt fazën e fillimit dhe fuqinë për ta shtyrë përpara hetimin te Policia, e aty i bëni manipulimet qysh po doni, po hapni e po mbyllni raste varësisht qysh po ju konvenojnë ato agjendat tuaja partiake dhe politike, pra Policia mund të keqpërdoret në këtë aspekt, edhe është keqpërdorur, qysh e kemi parë ne, e në anën tjetër, barrën e provës po ia lë prokurorit që ai të heqë të zitë e ullirit derisa të argumentojë qysh një njeri i ka milionët, nuk ka kurrfarë biznesi, rrogën e ka veç 800 euro, a i ka 10 milionë euro...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Me legjislacionin aktual në fuqi, a e di sa e kemi procedurën e hetimit të konfiskimit të pasurisë së paligjshme? 30 ditë! Pasi të shqiptohet dënimi, 30 ditë janë për të hetuar, listuar pasurinë e të pandehurit, a e dini sa e kemi bërë, për këtë të thërras, lexoje projektligjin!

Tash me projektligjin e ri hetimi i pasurisë për të pandehurin fillon prej ditës kur fillon hetimi, pa u ngritur aktakuza. Prej atij momenti fillon hetimi i pasurisë për të pandehurin, e dyta vazhdon pas ngritjes së aktakuzës dhe në momentin gjatë tërë kësaj periudhe ka mundësi që pasuria e atij personi, i cili hetohet, të ngrihet, gjë që s'ka qenë më herët, më përpara, që të mos asgjësohet, të mos kalojë në duar të tjerëve, të ngrihet. I kemi palët e treta, që s'i kemi pasur më herët, tashmë janë të detyruar në momentin që s'janë blerës 'bona fide', tashmë janë të obliguar të bashkëpunojnë me drejtësinë. Përndryshe, edhe pasuria që është në palët e treta, qofshin ata familjarë, biznese, ajo pasuri do të konfiskohet.

Pra, ndryshimet janë drastike, ndryshimet janë shumë të mëdha. Prej atij momenti, ndërsa sa i përket çështjes që e kam lexuar me vëmendje dhe vërtet kam pritur që projektligji që do ta sillni ju që është për verifikimin e pasurisë, do të jetë projektligj që do t'i adresojë këto çështje, pra, pikërisht është e kundërta, në momentin që aprovet kjo politikë, do ta kemi një prokuror shumë më të fuqishëm dhe në anën tjetër barra e provës, siç e thash, është në sistem proporcional, kalon nga prokurori tek i dënuari dhe jo vetëm për veprën penale, për të cilën mund të dënohet, që ajo mund të jetë edhe mosdeklarim i rregullt i pasurisë, jo vetëm për atë vepër penale, mirëpo për të gjithë pasurinë e atij personi do të bëhet verifikimi i pasurisë.

Për dhjetë vjetët e fundit, prej momentit kur ai dënohet, ai do ta dëshmojë mënyrën e përfitimit të pasurisë së tij për dhjetë vjetët e fundit, gjë që tashmë ajo pasuri përgjatë kohës prej kur kanë filluar hetimet, prej kur është ngritur aktakuza e gjatë tërë kësaj periudhe, pra është verifikuar dhe është listuar nga prokurori, madje edhe mund të ngrihet. Kanë qenë pikërisht procedurat që janë në fuqi, që e kanë pamundësuar një konfiskim të tillë çfarë ka qenë vazhdimisht edhe kritikë nga Bashkimi Evropian dhe në Raportin e Progresit.

Në anën tjetër, në këtë projektligj nuk mendoj se kemi resurse të mjaftueshme që do të kishim arritur të ndërtojmë, të përpilojmë, vet një projektligj të tillë efikas. Kam kërkuar ndihmë edhe nga Bashkimi Evropian. Këtu kam pasur dy prokurorë anglez, një prokuror italian, që kanë ardhur enkas për këtë fushë, që janë angazhuar rreth katër muaj nga Bashkimi Evropian në ndihmë të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin, përpilimin, e këtij projektligji. Ndryshimet janë drastike, ndryshimet janë radikale, janë shumë të mëdha në krahasim me politikën aktuale që është në fuqi. Pra, nuk mund të thuhet, që barra e provës prapë i mbetet prokurorit. Prokurori është ai që do ta listojë pasurinë e të pandehurit. I pandehuri do të dëshmojë mënyrën... do t'i gjejë ato faturat që i përmende ti, mënyrën se si e ka përfituar pasurinë, për çfarëdo qoftë, edhe një vepër minimale në listën që janë listuar ato. Në anën tjetër, kjo garanton edhe siguri juridike për qytetarët tanë.

Të thërras, lexoje projektligjin, është një projektligj që plotëson kushtet dhe standardet tona dhe unë besoj se do të jemi jashtëzakonisht efikas në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

KRYETARI: Urdhëro, Glauk! S'pata qejf t'ia nis me replikë, por...

GLAUK KONJUFCA: Tash... se po ndodh diskutimi këtu.

Ministër,

A po e kupton ku ke dështuar?

Qe po ta lexoj nenin 4.1, ku ke dështuar. "Pasi një i pandehur shpallet fajtor për një veprë penale, të përcaktuar në nenin 2, prokurori i shtetit me një kërkesë të veçantë në gjykatën e cila e ka nxjerrë aktgjykimin, mund të kërkojë verifikimin e pasurisë brenda periudhës 5-vjeçare, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë". A po e kupton?

Domethënë, ti kërkon procedurën e ke bazuar pas përfundimit të gjyimit të formës së prerë. Unë po them, nëse këtu do ta luftosh krimin e organizuar në Kosovë, duhet bazuar barrën e provës në fillimin e hetimeve. Po, lëre ti aty, pasi të dënohet njeriu. Qysh do ta argumentojë ai? Unë po them qysh t'ia nisë prokurori. Qysh t'ia nisë prokurori? Qysh të vijë prokurori deri te...? Në njërin anë e ke bllokuar te Policia. Policia Hetuese është ajo e cila prokurorit ia çon dosjen edhe i kallëzon që "këtu është njëfarë piste, e cila mund të çojë deri te një veprë penale, prandaj këtu i ke argumentet, mund të kalosh në procedura tjera të gjykatës". Mirëpo, ti me vetë faktin që kërkon ajo për të cilën ti po argumenton fillon pas gjyimit të formës së prerë, nuk është kurrfarë ndryshimi kualitativ, "revolucionar" siç po thua, i ligjit.

Kur ta lexojë krimi i organizuar sot këtë ligj, do të ketë arsye për të festuar, do të gëzohet, sepse e vëren se nuk ka kurrëgjë, nuk është i rrezikuar më, sepse prokurori prapë do të ndihet i dobët edhe me këtë ligj ti që e ke bërë. A po më kallëzon, ku është fuqia e prokurorit në këtë ligj?

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Fuqia e prokurorit në këtë ligj është, ku tash prej momentit kur fillon hetimi për të pandehurin deri në atë moment kur ai do të dënohet, prokurori e heton pasurinë e të pandehurit, po e heton pasurinë e të pandehurit... Ti, më mirë është ta lexosh vet, se sa t'i marrësh që po t'i servojnë. Ajo është njëra prej pikave. Jo, prokurori fillon hetimin dhe mund të ndodh ngrirjen e pasurisë, prej momentit kur fillon hetimi. Kjo është mundësi dhe ajo mund të ndërtojë pista të reja të hetimit. Policia s'përmendet fare në këtë projektligj. S'ka lidhje me policinë kjo, domethënë nuk është çështje e policisë kjo. Kjo është kompetencë e zgjeruar për prokuror, nuk është kjo për polici, nuk përmendet. Nuk e di çka po të servojnë të lexosh, por po të them, merre, e kemi kohën në leximin e dytë edhe mund ta trajtojmë bashkërisht edhe në komision.

Përparësia në këtë rast është, që prokurori fillon hetimet prej atij momenti kur fillon hetimi që as aktakuzë nuk ka, për personin i cili dyshohet për pasurinë e tij dhe ajo pasuri mund të ngrihet në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, ke për të vazhduar, se vazhdon dalëngadalë, s'ka... Vazhdojmë gradualisht. Shkumbin Demalijaj, në emër të AAK-së. Po, ka kohë për debat.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Nuk është kah kuptohet thelbi i projektligjit, sepse këtu me rastin e akuzës së dikujt për një vepër penale për çështje pasurore, atëherë fillon dyshimi, që është sekondar, që me këtë projektligj dhe kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë prokurori ka të drejtë që të merret edhe me këtë pjesën tjetër sekondare, që të ngrëjë dyshimin dhe të hetojë për vepër penale, që është sekondare në këtë rast, me rastin kur krijohet dyshimi për një përfitim të paligjshëm.

Unë si... ne e kemi shqyrtuar në komision, por kur dëshirojmë t'i japim karakter politik dhe të dalim edhe te praktika gjyqësore, edhe atje s'po na bie tamam, zoti kryetar. Dikush thotë "drejtësia e kapur", "prokuroria e kapur", "policia e kapur"... E, qysh mund të zhvillohet kjo punë? Kur ke elementë dyshimi te krejt mekanizmat e shtetit, pse të mos ketë elementë dyshimi edhe te një qytetar. Në këtë rast, kur nuk po u bie tamam kurrkund, është e drejtë për të bërë politikë, por ligji është aq i mirë, është komplet i bazuar, sikurse e kanë edhe disa vende përreth, për shkak se janë munduar më herët të na sjellin një ligj arbitrar të periudhës akuzatore, kur është ndarë Perandoria Romake në dy pjesë. Por, ky është ai që i plotëson krejt parakushtet për të vazhduar më tutje.

Ne e përkrahim projektligjin në parim, bashkë me komisionin, bashkë me grupin parlamentar, do të japim rezultatet tona në leximin e dytë, ose ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Po, ministri e ka fjalën. Faleminderit! Nga Lista serbe s'u lajmërua askush. Në qoftë se, s'lajmërohet e vazhdoj, vetëm...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Janë dy mënyra të konfiskimit të pasurisë. Është procedurë penale dhe procedurë civile.

Procedurë civile, e ka rregulluar Italia në vitin 1974 dhe janë dy vende në Evropë që tashmë e kanë në procedurë civile, Irlanda e Veriut dhe Italia. Nëse shkojmë në procedurë civile, realisht kriminelët që përfitojnë këtë pasuri në mënyrë të paligjshme, ata i amnistojnë nga burgu. Ti mund të gesh mënyra për të konfiskuar pasurinë e tyre, mirëpo në procedurë civile këta kriminelë në burg s'mund t'i shtiesh, në asnjë rrethanë. Për atë arsye, është e rëndësishme që krahas konfiskimit të pasurisë, këta njerëz që përfitojnë me vepër penale po ashtu ta vuajnë edhe burgun, sepse në fund të fundit, kriminelët japin gjithçka veç në burg të mos shkojnë, krejt atë që e kanë. Pra, kjo është procedurë, siç thash, barra e provës është në një sistem proporcional ku

kalon nga prokurori tek i pandehur, në momentin kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm, në momentin kur qoftë edhe se dënohet për një veprë që është keqpërdorur thjeshtë një vlerë prej, ta zëmë, 500 eurosh. Tani, ky person do të japë llogari për gjithë pasurinë e tij, që është përfituar në dhjetë vjetët e fundit, jo vetëm që ndërlidhet me veprën, mirëpo gjithë atë pasuri. Që thua ti “e ka rrogën 800 euro edhe i ka 10 milionë euro pasuri”, edhe në qoftë se e ka bërë një gabim në deklarimin e pasurisë dhe dënohet nga prokurori, është veprë penale. Ai në atë moment do të fillojë, duhet ta dëshmojë t’i gjejë ato fatura që ti po i kërkon, mënyrën se si e ka fituar pasurinë. Jo vetëm me u lidhë me veprën penale që është dënuar, po krejt pasuria e tij që është fituar në dhjetë vjetët e fundit.

Procedura civile e konfiskimit të pasurisë, vetëm dy vende në Evropë e kanë, nuk është efikase, sepse kriminelët i ke në liri. Nuk është efikase. Për atë arsye nuk është rregulluar. Është mënyrë, që çon te konfiskimi, më e shpejtë, mirëpo kriminelët i ke në liri. Prandaj po them, edhe ju, e kam parë edhe projektligjin që e keni proceduar në Kuvendin e Kosovës, ajo prodhon një situatë stagnuese, realisht. Ai projektligj prodhon një situatë stagnuese. Ne...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, do të keni mundësi debati dhe mirë është për hir të qytetarëve, sa më shumë të eksplorohet. Tash, Lista serbe nuk ka. Nisma, Bilall Sherifi, në emër të grupit parlamentar, besoj. Po, urdhëroni!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë, edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit, se jam edhe anëtar i këtij komisioni.

Për këtë ligj kemi pasur debate pothuajse ka dy muaj në komision dhe nuk është... nuk do të thosha asgjë të re nëse them se këtu jemi të ndarë në dysh. Unë bëj pjesë në kategorinë e atyre që përpiqen të ndërtojnë një instrument, përpiqen të ndërtojnë mekanizma përmes të cilëve pastaj sigurisht sërish përmes njerëzve do të duhet të gjejnë zbatim këto ligje. Për mendimin tim, në anën tjetër, janë ata që kërkojnë shkop magjik. Kërkojnë instrumente përmes të cilave si me shkop magjik do të identifikojnë kriminelët, do të arrestojnë kriminelët, do t’i dënojnë kriminelët dhe në fund, do të pasurojnë shtetin me pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme nga kriminelët.

Unë nuk bëj pjesë në kategorinë e tyre, sepse nuk besoj në mrekulli, nuk besoj në shkopinjtë magjikë, siç kam parë kohëve të fundit, që shumë kolegë edhe besojnë në to. Tash nuk di, nuk di a besojnë apo vetëm meqë janë në atë anë e kanë atë perspektivë dhe kur të dalin pastaj në këtë anë, e shohin që ajo perspektivë nuk është edhe e vetmja dhe absolutja.

Unë bëj pjesë në kategorinë e atyre që besojnë se përmes këtij ligji, edhe pse edhe ky ligj ka të metat e veta, që do të përpiqemi që gjatë periudhës së dy leximeve, në mes dy leximeve, të japim

kontributin tonë në amendamente, në propozime, që ta rregullojmë më shumë se sa që është e rregulluar nga Qeveria, përkatësisht më shumë se sa që është e rregulluar nga ministria, si sponsorizues i këtij ligji.

Është evidente, siç u tha, që në Kosovë krimi i organizuar, korrupsioni, të gjitha dukuritë negative të përfitimeve të jashtëligjshme kanë bërë kërdi, le të themi, kanë sunduar në Kosovë. Por, a ka një mënyrë që si me shkop magjik të gjithë ata të identifikohen dhe menjëherë të dënohen? Unë nuk besoj në atë. Si t'ia bëjmë tash? Unë besoj që ky është një proces, siç ka qenë në të gjitha vendet demokratike. Mos harroni, në Shtetet e Bashkuara gati 100 vjet ka zgjatur lufta kundër krimit të organizuar dhe nuk e di a është fituar plotësisht, ai vazhdimisht ngre kokën në të gjitha vendet demokratike, ku të drejtat e njeriut duhet të gjendet balanca në mes luftës kundër krimit të organizuar dhe të drejtave të njeriut.

Nuk mundemi në emër të luftës kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, kundër të gjitha atyre dukurive kriminele të krijojmë mekanizma, përmes të cilave pajisim ata që këtu në këtë parlament i kemi shpallur të kapur, nëpër konferenca për shtyp i kemi shpallur sistem totalisht të kapur, nëpër debate televizive i kemi shpallur të kapur dhe të gatshëm që në shërbim të pushtetit, siç u dha madje edhe hiç më larg se në këtë seancë, të bëjnë agjenda personale kundër eksponentëve të ndryshëm, qoftë brenda radhëve të veta, qoftë jashtë tyre, qoftë brenda partive të tyre, siç u tha edhe në këtë seancë, qoftë jashtë partive të tyre, t'i pajisim tash me instrumente shtesë përmes të cilave ata do të jenë edhe të efektshëm në funksion, le të themi, të zbatimit të agjendave private.

Unë në emër të Nismës dhe si anëtar i komisionit do të përpiqem që ndërmjet dy leximeve të gjitha këto instrumente shtesë, përmes të cilave konsiderojmë që do të mund të keqpërdoren nga ata që do ta zbatojnë ligjin, se mos besoni që, së paku unë nuk besoj, por ju kisha lutur edhe ju të mos besoni që ligji më vete do të vendosë drejtësi. Sigurisht se jo, sërish njerëzit do të jenë ata që do ta zbatojnë atë ligj dhe ne kemi parë këto vite që drejtësi hyjnore në Kosovë nuk ka, askund nuk ka, por sidomos jo në Kosovë. Dhe, askund si në Kosovë nuk është keqpërdorur drejtësia apo sistemi i drejtësisë për të goditur të tjerët për agjenda politike e partiake e ku ta di unë.

Pra, le të qëndrojmë me këmbë në tokë, le të fillojmë ligjin i cili e ka trajtuar këtë çështje deri më tani ta përmirësojmë. Unë besoj se ky projektligj ka elemente të mira, ka edhe teprime, të cilat do të përpiqem gjatë dy leximeve t'i jap përmes amendamenteve e që unë nuk besoj se duhet ky sistem, këta njerëz që janë në këtë sistem, jo se ata mund të jenë të këqij, jo se ata mund të jenë të paditur, por se ata mund t'u nënshtrohen presioneve e shantazheve të ndryshme për të ndjekur, për të persekutuar njerëz, të cilët mund të jenë pengesë për njerëzit e pushtetshëm, kështu u tha në fund të fundit edhe në këtë seancë. Pra, nuk mund në njërin anë të mos besosh në sistem dhe në anën tjetër të kërkosh që sistemin ta pajisësh me instrumente shtesë, që nesër a pasnesër pastaj

të kesh mundësi sërish të akuzosh edhe më shumë “sistemin e kapur”, se po vazhdon me të njëjtën logjikë.

Le të ndalemi te ky ligj, le të punojmë të gjithë së bashku, le të ecim përpara që ta kalojmë brenda dy leximeve, të punojmë që ta përmirësojmë, të marrim propozimet më të mira që mund të vijnë nga opozita, propozimet më të mira që mund të vijnë edhe nga partitë e mazhorancës, nga deputetët e pavarur, pse jo dhe ta bëjmë një ligj të mirë, sepse në fund të fundit, nëpërmjet këtij ligji nuk do të duhej të bëjmë përpjekje vetëm të rregullojmë në aspektin formalo-juridik këtë lëmi, por të ndërtojmë një ligj përmes të cilit ne së pari këtu që jemi dhe do të votojmë për të, të besojmë se ajo është rruga e duhur, ato janë mjetet e duhura me të cilat krimi i organizuar, korrupsioni dhe dukuritë negative në shoqëri do të mund të luftohen në mënyrë efikase. Dhe mbi të gjitha, le ta bëjmë një ligj përmes të cilit ne së pari do të besojmë, se të gjithë ata apo një numër i konsideruar i tyre, se të gjithë ata sigurisht nuk do të mundemi kurrë, do të vihen para përgjegjësisë, do t’u konfiskohet pasuria e fituar në mënyrë të paligjshme apo me vepra penale dhe të bëjmë shembull që drejtësia vonon, por kurrë nuk ndalet, se mund t’i ikësh drejtësisë për një kohë, por nuk mund t’i ikësh përgjithmonë.

Unë besoj në vullnetin e mirë të të gjithë atyre që janë përfshirë në debat, por le të përqendrohemi dhe le të bëjmë një ligj, i cili do të jetë efikas dhe jo një ligj vetëm sa për ta përmbushur indeksin e miratimit të ligjeve në rrugën tonë drejt integriteteve evropiane. Pra, një ligj që do ta aplikojmë dhe jo vetëm një ligj sa për ta shënuar në indeks. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! 6+-i, Bahrim Shabani. Urdhëroni, zoti Bahrim!

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se, predsedniče!

I parlamentarna grupa 6+ razmatrala je nacrt zakona o proširenim nadležnostima o konfiskaciji imovine i mi ćemo u načelu podržati ovaj zakon. Naravno, da ćemo svoj doprinos dati između dva čitanja, gde sam i ja takođe član komisije i verujem da ćemo sa kolegama poslanicima uraditi jako, daćemo sve od sebe, kako bi ovaj zakon bio što bolji. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Islam Pacolli, pa grup.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Ministër,

Kolegë të nderuar,

Medie,

Sigurisht se sot është një temë e veçantë për Republikën e Kosovës. Unë po i dëgjoj të gjitha debatet, por duhet ditur jo vetëm institucionet, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, po nuk luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar, mos prisni as liberalizim të vizave, as anëtarësim në BE.

Kryekëput varet nga luftimi i korrupsionit. Këtë nuk mund ta bëjë vetëm Ministria e Drejtësisë, as vetëm Ministria e Punëve të Brendshme, por këtu duhet me qenë të gatshëm, duhet me qenë të ndërgjegjshëm. Çdo qytetar i republikës së Kosovës, edhe ministrat, edhe gjykatësit, edhe policët janë qytetarë të Republikës së Kosovës, prandaj ne duhet me qenë realistë, duhet me qenë patriotë për vendin tonë, nëse ne duam të avancojmë, atëherë ne duhet të luftojmë korrupsionin së bashku. Ka qenë temë edhe më herët çështja e demarkacionit, e kam vlerësuar edhe atëherë që kjo është vetëm një prej pikave kryesore për lëvizjen përpara ne si shtet, si Republikë e Kosovës, është luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këtë kush e lufton? Asnjëherë nuk e lufton vetëm policia, vetëm hetuesit, vetëm prokurorët, vetëm gjykatësit, vetëm ministria, ne duhet ta luftojmë të gjithë së bashku. Prandaj, ky është një ligj që ne e kemi shqyrtuar si AKR. Nuk them që këtu nuk ka hapësirë për përmirësime, por sigurisht se është shumë më i mirë se ai deri më sot.

Prandaj, ne e mbështesim fuqishëm. Bëj thirrje si qytetar i Republikës së Kosovës që ne të jemi të hapur, bashkëpunues të gjithë. E dëgjova edhe një nen që e përmendi kolegu im Glauk Konjufca, sigurisht pas përfundimit të një aktgjykimi të prerë mendoj se duhet të jetë edhe ajo përfundimtare, që të mos hetohen ende njerëzit apo të shantazhohen njerëzit pafundësisht. Do të thotë, edhe akuza e pabazë duhet të jetë llogaridhënëse e jo t'i bëhet dikujt një akuzë dhe pastaj të mos ketë bazë. Do të thotë, ne duhet të jemi të përgjegjshëm, aty ku e paraqesim, aty ku e luftojmë dhe aty ku marrim vendime, ne duhet të jemi të bashkuar, unikë, nëse duam të lëvizim vendin tonë përpara. Kjo. Edhe një herë po theksoj, se vetëm ministrinë, vetëm prokuroria nuk mund ta luftojë këtë çështje. Këtë dukuri negative që ka kapluar bukur shumë Republikën e Kosovës ne jemi ata të cilët duhet ta eliminojmë dhe ta çojmë përpara.

Prandaj, ministrin e përgëzoj për ligjin. Le t'i marrë sugjerimet, le t'i pranojë sugjerimet e kritikave që i japin të tjerët. Shpresoj që ne të gjithë t'i japim kritika që janë të bazuara e jo vetëm të japim në bazë të ngjyrave politike, pastaj nuk mund të nxjerrim një ligj më të mirin. Do të thotë, ka ende hapësirë që ne ta përmirësojmë dhe kontributi ynë do të jetë i pa rezervë në këtë drejtim dhe do ta ketë përkrahjen që ky ligj të aprovohet sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Seriozisht? Veç për mirë ta ka përmend. A do replikë për këtë punë? E ndërton një precedent. Ani. Glauk Konjufca ka replikë, se ia ka përmendur emrin për të mirë. Ia ke përmendur emrin kështu është...

GLAUK KONJUFCA: Kam të drejtë ta falënderoj.

Jo, tash faleminderit që ma përmende emrin, se tash është një mundësi, se këto procedurat e Kuvendit po na kufizojnë pak. Një mundësi shumë e mirë që prapë të debatoj me ministrin.

Ministër, ti këtë ligj e ke kufizuar në vepër penale dhe gjithçka që vjen pas veprës penale. Unë e kam kritikën time, që është esenciale dhe nuk ka nevojë me i vu bisht çfarë po them, për t'u

përgjigjur. Në fillimin e procedurave hetuese krejt barrën e keni lënë, prapëseprapë edhe pse e keni rishkruar këtë ligj barrën e keni lënë mbi prokurorin. Ai duhet pasur një logjistikë, një sistem prapa, disa ekipe të përcaktuara, të cilat kanë të drejtë t'i qasen një njeriu edhe pa bazë penale. Kjo është esenca. Shumë shtete e kanë. Nuk ka nevojë me qenë vetëm penale dhe pas vendimit të prerë të gjykatës.

O vëlla, për shembull, e ke një rast kur është një pasuri, e cila po duket problematike në raport me të ardhurat e njeriut. A bën ta hetojë prokurori atë rast, e nëse bën ta hetojë, barrën e provës duhet zhvendosur në atë mbi të cilin bie dyshimi, jo prokurorit, se prokurorët edhe i keni lënë të dobët, edhe pa ekipe, edhe pa resurse, edhe ua keni lënë barrën e provës. Tash ai nëse mund ta vërtetojë, në rregull, nëse nuk mund, krimi e vazhdon vallen e vet në Kosovë sikur tash e 20 vjet.

Edhe e dyta, këtë punën e 10-vjetshit e ke gabim, pse e ke kufizuar në 10 vjet? Tregona pse? Kosova ka institucione prej vitit 2001, këtu ne bëjmë jetë të pavarur prej vitit 1999, pse prej vitit 2008 korrupsioni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Glauk, një gabim e ke bërë, sigurisht lapsus, pse ia keni dërguar UNMIK-ut, the, jetë të pavarur...

Urdhëro!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Glauk, hetim penal është edhe kur një qytetar i Republikës së Kosovës e denoncon një person të caktuar, qoftë ai ministër, qoftë deputet, qoftë në mënyrë anonime i drejton një letër prokurorit dhe nga ai moment e tutje prokurori mund të fillojë hetimin e pasurisë së tij për veprën penale të cilën qytetari e ka denoncuar, ai është rast penal. Për këtë arsye ti njeriun aty, keqbërësin ose... pa penal s' mund ta futesh në burg. Ky është hetimi, po ti fillon me një denoncim ose, me thjesht me një pretekst të prokurorit që ai mendon që pasurinë e ka fituar në mënyrë të paligjshme, ai e fillon hetim. Në çdo procedurë para aktakuzës, para fillimit të aktakuzës, pas ngritjes së aktakuzës, gjatë procesit gjyqësor deri 5 vjet mbrapa prokurori ka fuqi të merret me pasurinë e të pandehurit, edhe atij që më herët ka qenë i dyshuar...

(Ndërprerje nga regjia)

A bën veç edhe pak, për 10 vjet pata nevojë.

KRYETARI: Po më duket nuk është replikë e dobët, unë po bëj lëshime për ta sqaruar opinionin, është në materie. Urdhëro, ministër!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Çështjen e 10-vjeçarit e kemi diskutuar edhe me ekspertë të ndryshëm, edhe prej inteligjencës financiare.

Deri para 8 vjetëve, në fakt, ka qenë që qytetarët në Republikën e Kosovës patundshmërinë që e kanë blerë, e kanë blerë edhe me para kesh, pa nevojë për transaksione bankare dhe e kanë vërtetuar në gjykatë. Ndërsa kjo është bërë diku në vitin 2009, nëse nuk gaboju, ku transaksioni bankar është i domosdoshëm për t'u përkthyer në kadastrë, sepse më herët nuk ka qenë.

E di besoj edhe Liburni, në cilin vit janë obliguar qytetarët e Republikës së Kosovës që patundshmëria mbi 10 mijë euro ta ketë transaksionin, për ndryshe ajo nuk mund të përkthehet në emër të atij që e ka blerë. Për atë arsye është edhe shumë problem, sepse njerëzit nuk i kanë pasur mjetet në xhironlogari, para 10 vjetëve e kanë ble pronën me para kesh dhe e kanë përkthyer në gjykatë. Tash qysh do ta hetosh atë pasuri në atë periudhë, ku nuk ka as transaksion bankar, mënyrën qysh e ka bërë biznesin, nuk ka qenë e nevojshme për transaksione bankare, qysh të hetohet ajo pasuri?

Për atë arsye ne është e mundshme të kemi efikasitet në 10-vjeçarin e fundit, edhe pse në vitin 2008 po ashtu është blerë patundshmëri me para kesh dhe është vërtetuar në gjykatë, megjithatë i kemi lënë 10 vjet mbrapa. Në qoftë se ky ligj hyn në fuqi pas dy muajsh a një muaji, shpresoj sa më shpejt që të jetë e mundshme, unë po them e zgjeron fuqinë e prokurorit në hetimin dhe në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupe Parlamentare më nuk ka. Shkojmë te deputetët. Sami Kurteshi, fjala për ju.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po përpiqem të dëgjoj me kujdes, mendoj se ky megjithatë është një ligj i rëndësishëm dhe mirë është të lejohet debati edhe nganjëherë kur e kapërcejnë kohën, ata që kanë çka të thonë në përmbajtje.

Unë e dëgjova me kujdes ministrin e Drejtësisë, po e përmend, mirë është mandej ta sqarosh, the e kemi një ndër legjislacionet ose legjislacionin më të përparuar kundër korrupsionit në Evropë me këtë.

Ministër, Evropa nuk po na pranon për shkak të korrupsionit, me gjasë e kemi ligjin aq të mirë sa duhet ta dëmtojmë pak, ta përkeqësojmë pak, ta bëjmë si Evropa, e ndoshta na pranojnë, se me këtë ligj nuk na pranojnë, është tepër i mirë.

Unë mendoj se qëllimisht asnjë Qeveri e pasluftës deri tani nuk i ka kushtuar asnjë kujdes korrupsionit, sepse në të shumtën e rasteve kanë qenë vetë të involvuar, natyrisht jo të gjithë, po shumica prej tyre.

Ne kemi megjithatë ministra e politikanë të ndryshëm që kanë qenë në politikë prej një gjendje të varfër ose mesatare, janë shndërruar goxha në njerëz të pasur, nuk i arsyetojnë pasuritë.

Ne kemi edhe nisma të mëparshme të ministrave të drejtësisë që ka rastësisë këto 10-12 vjetët e fundit kanë qenë të Partisë Demokratike: Hajredin Kuçi, Dhurata Hoxha. A besoni që i njëjti fjalor ka qenë: “Me këtë ligj ne tash do ta ndalojmë korrupsionin”. A e kemi më 2013 apo 2015, më 2013 ky Kuvend e ka miratuar Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për kufizimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Ky nuk po thotë me vepër penale, veç me konfiskimin e pasurisë, çka ka ngjarë prej vitit 2013?

E kemi një nismë të ish-ministres Hoxha që në strategjinë legjislative kërkonte procedimin në Kuvend të Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Hoqi dorë nga ajo strategji, s’ka kurrëgjë. Kemi nismën e ish-presidentes së shtetit Jahjaga, e krijoi një farë Agjencie Kundër Korrupsionit, diçka bëri të madhe, e kishim Agjencinë Antikorrupsion, e lanë anash, kishim ligjin, kishim Ligjin për konfiskimin, Kodin Penal që e kemi pasur, i lanë krejt anash. Ku janë ato veprime? Ky është problemi kryesor.

Unë pajtohem që nuk zbatohen ligjet veç pse i kemi në letër. Po unë po them, ky ligj që e keni sjellë ju nuk e ka asnjë ndryshim nga ligjet e mëparshme, ka ndryshime gjuhësore, po nuk ka ndryshime përmbajtjesore.

Unë e kuptoj se flasin këtu, ne po themi vetëm i akuzuari ose i pandehuri. Ligji që e ka sjellë Vetëvendosja, veç një pjesë po e tregoj, e bart barrën e provës te i dyshuari. Pa e sjell një ligj që bën ndryshim paradigmatic, duke siguruar, garantuar mbrojtje kushtetuese dhe ligjore, nuk ka asgjë.

Cili prokuror sot, tregoni ju mua, me këtë ligj do të guxojë ose do të mund ta kapë, nuk po flas për krimin e organizuar jashtinstitucional, po brenda institucioneve, do të guxojë ta kapë një politikan të lartë, nuk ka ngjarë deri tash, s’do të guxojnë as tash e tutje, s’do të munden. Sepse në policinë për hetime ekonomike, në të vërtetë e kemi një pjesë të krimit. Ne e dimë, njerëz në polici për krime ekonomike çka kanë bërë, veç këqyrini pasurinë e atyre njerëzve, në krime ekonomike që punojnë, edhe këqyrni çka ka ngjarë, kush punon edhe me çfarë vepre është i ngarkuar. Ky është një problem shumë i madh.

Ju po thoni se i keni pasur ekspertët ndërkombëtarë. Unë edhe një herë po jua tërhiq vërejtjen, kam dëshirë të takohem me ata ekspertë. Ne e kemi në memorandumimin shpjegues edhe kërkesën ose shpjegimin tuaj se jeni thirrur në direktivat e Unionit Evropian. Atëherë s'po i lexojnë me kujdes.

Ne nuk e kemi askund kategorinë e ngrirjes. Ngrirja domethënë ngritje e çdo pasurie të dyshuar pa vepër penale, sepse mandej konstatohet vepra penale, nëse ka dyshime për një pasuri që s'mund të justifikohet në asnjë mënyrë, këtë e ka kërkuar Lëvizja Vetëvendosje, jo diçka tjetër.

Në çdo rast, në çfarëdo akuze, megjithatë i dyshuari është i obliguar të ofrojë dëshmi prej nga i ka ardhur pasuria.

Sot mua dikush po më kërkoj, unë duhet të tregoj se veturën e kam blerë me këto, këtë me këto, këtu e kam këtë pasuri, e kam të domosdoshme.

Kufizimet pesë vjet, dhjetë vjet janë të panevojshme. Merrni direktivat evropiane, natyrisht që me direktivat evropiane kjo nuk rregullohet, as me legjislacionet e vendeve evropiane, sepse ato e kanë një sistem ligjor më të vjetër. Unë e kuptoj këtë breng të Qeverisë, pra edhe tonën. Mirëpo nuk duhet të ketë kufizime të tilla arbitrare, po pse jo gjashtë vjet, po pse jo tetë vjet, jo 10 vjet, 12 vjet. Ju e dhatë arsyen pse, po ato janë megjithatë numra, shifra arbitrare që nuk kanë të bëjnë me çështjen.

Unë i kam këtu edhe direktivat e Unionin Evropian, nuk po i lexoj të gjitha, edhe ju jeni thirrur në një direktivë që është e drejtë, domethënë në ligj. Në direktivën 2012/38, nuk e di apo 14, nuk është me rëndësi, mirëpo nuk i keni marrë krejt normat e direktivës, ky është problemi. I keni marrë ato norma të direktivës që vërtet arsyetojnë qëllimin tuaj. Edhe nëse kanë punuar ekspertët evropianë për Ministrinë e Drejtësisë, që unë e besoj, megjithatë kanë punuar me preferenca tuaja, me urdhrat tuaj, çka të futet pre normave dhe çka të mos futet prej normave në këtë legjislacion. Ka mundësi që s'e kemi lexuar legjislacionin sikur ju, mirëpo unë e them që në këtë legjislacion ka edhe koncepte dhe askush nuk e di.

Unë, për shembull, ka bërë përpjekje të kuptoj, ju e dini, ministër, ose ekspertët tuaj, është një koncept kufizim, a besoni që i kam lexuar krejt nenet me shumë kujdes dhe s'kam arritur të kuptoj çka do me thanë koncepti 'kufizim' në projektligjin që e keni ofruar ju, kurse është ndër konceptet që merr disa nene dhe ka shumë veprime.

Çka domethënë kjo, pse nuk flisni për ngrirjen që e parasheh legjislacioni evropian.

Unë po e them në fund, se megjithatë duhet treguar. Ne kemi afuar një projektligj si Lëvizje Vetëvendosje që bën ndryshimin paradigmatic, jo sipas fjalimeve demagogjike, që i dëgjoj këtu

dhe i dëgjova këtu prej kolegëve të mi, se do të ketë gjuajtje, sikur “natë e shtrigave”, nuk ka asgjë në atë drejtim.

Lëvizja Vetëvendosje thotë: çdo njeri që ka pasuri të pajustificueshme jo mbi 10 mijë euro, po ne duhet ta zbresim në pesë mijë euro, duhet të arsyetojë atë para shtetit. Nëse nuk e bën këtë, ne duhet të tregojmë pse 10 mijë euro dhe pse jo pesë mijë euro. Ne duhet të mbështetemi në të ardhurat mesatare të banorit të Kosovës.

Shuma pesë mijë euro do të thotë mbi shumën e pagës vjetore të një punëtori me një rrogë mbi mesatare. Nëse ai nuk i arsyeton ato, e kemi një problem, pse 10 mijë euro? Pse ky arbitraritet, edhe pse pesë mijë euro do të ishte arbitrare, nëse ne nuk e sqarojmë bazuar në mundësitë ekonomike, të ardhurat ekonomike të banorëve të Republikës së Kosovës.

Unë mendoj dhe po e them përfundimisht që edhe ne e kemi dëgjuar, edhe ky presidenti që është tash më së pakti dhjetë herë e ka atë shprehjen e njohur “zero korrupsion”! Jo ‘zero korrupsion’, korrupsioni na ka mbytur aq shumë, sa tash Evropa po na thotë jo, s’ka Evropë pa e luftuar korrupsionin. E tash dikush këtu është duke rrejtur, domethënë ‘zero korrupsion’, ku e kemi atë?

Prandaj, duhet të bëhet ndryshimi paradigmatic që çdo pasuri e pajustificueshme duhet të hetohet. Vepra penale del, sepse është aty, po jo njëherë të dënohet dikush për diçka, e mandej të nxirret pasuria. Veprat penale që ju i treguat, këtë e kemi në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po ministër, urdhëro!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti deputet,
E ke nenin 7, ku flet për procedurat e kufizimit, procedurat e ngrirjes. Projektligjin që ju e keni proceduar në Kuvendin e Kosovës nuk e trajton fare çështjen e ngrirjes së pasurisë gjatë hetimit, pas ngritjes së aktakuzës e deri në përfundim. Pra, nuk e keni trajtuar fare, ne mund të debatojmë.

Unë besoj shumë që gjatë javës së ardhshme do të kesh mundësi t’i takosh ekspertët e Bashkimit Evropian, absolutisht nuk kanë punuar me direktivat e mia si ministër i Drejtësisë.

Po të siguroj, këtë kam kërkuar nga ata praktikant më të mira të mundshme që mund të praktikohen në Republikën e Kosovës, thashë kanë qenë dy anglezë dhe një italian, të gjithë prokurorë dhe s’kanë pasur kurrfarë direktive. Kam kërkuar që të ndryshojë në mënyrë drastike gjendja prej projektligjit aktual. Edhe thjesht, ne nuk mund ta fuqizojmë angazhimin tonë ose luftën kundër korrupsionit vetëm me këtë ligj, është Kodi Penal, është Kodi i Procedurës Penale,

Projektligji për informatorë, pra të gjitha këto që po i procedojmë mendoj që e arrijnë të krijojnë atë legjislacionin që do të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe do të jetë larg më i avancuar se sa atë që e kemi në rajon, qoftë në Maqedoni, qoftë në Shqipëri, në Serbi apo në Mal të Zi.

Pra, flet edhe për ngrirje, të lutem lexoje drejt, e ke nenin 7 për kufizim, flet edhe për ngrirje të pasurisë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, kundër-replikë, diskutim, urdhëro!

SAMI KURTESHI: Vetëm për sqarim. Unë e kërkoja prej ministrit të më tregojë çka domethënë koncepti 'kufizim' në këtë ligj, sepse është shumë i rëndësishëm. Po thotë e ke nenin 7, unë e kam nenin 7 këtu përpara, flet për procedurat, nuk ka definicion.

“Procedurat për kufizim janë domethënë 1.1, procedura për urdhrin kufizues, 1.2 procedurat për urdhrin kufizues përfundimtar edhe të përkohshëm”, këto janë.

Paragrafi 2, Gjykata në procedura për kufizim, kërkesat i shqyrton dhe vendos me shkrim pa pasur nevojë për një seancë dëgjimore, përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe. A është ky definicioni kufizimi. Nëse ky qenka, unë nuk po e kuptoj atëherë drejt.

Nëse ky koncept po e përfshika ngrirjen, atëherë unë nuk po e kuptoj gjuhën mirë. Kjo është çështja, domethënë.

Unë mendoj se ne duhet të ulemi, ta shohim një ligj që çdo person në Republikën e Kosovës që ka pasuri të pajustificueshme të sillet në gjendje ta dëshmojë atë pasuri.

Nëse nuk nxjerrim një ligj të tillë, ne do të luftojmë me zero korrupsion, me agjenci të ndryshme kundër korrupsionit, do ta pasurojmë kodin, do ta nxjerrim këtë ligj edhe pas pesë vjetësh, s'e di a do të jeni ju ministër a do të jem unë deputet, do të diskutohet në këtë Kuvend për luftën kundër korrupsionit që s'e kemi kryer ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaimi ose Zafiri, nga një prej grupit parlamentar të jenë. Milaim Zeka, po e shoh reagimin.

Edhe unë e marr fjalën kah fundi si deputet.

MILAIM ZEKA: Kryetar, faleminderit!

Ne po flasim për dy gjëra, po flasim për njeriun dhe për ligjin.

Çdo ligj që e kemi aprovuar deri sot, 90% është mrekulli, asnjë ligj nuk e kemi bërë vetë, as nuk i bëjmë vetë. Ata të zyrave të ndryshme të Bashkimit Evropian, të OSBE-së që shumica në vendet e tyre janë raste sociale, po na i kanë dërguar këtu si ekspertë, si juristë.

Ne kemi pasur në kohën e UNMIK-ut njerëz prej vendeve të ndryshme që kurrë patentë shofer në jetë të vetë s'ka pasur deri ka ardhur në Kosovë dhe kur kanë bërë aksidente dy xhipa të policisë, kanë hipur dy vetë të UNMIK-ut përpara dhe e kanë ngrehur xhipin mbrapa pa shofer.

Pastaj ka nxjerrë UNMIK-u një direktivë që edhe xhipi i aksidentuar mbrapa duhet ta ketë shoferin, a e besoni ju këta, a është me shkrim, aq 'lopë të gjalla' na i kanë prua këtu si 'ekspertë', po e fyej lopën, se lopa është mrekulli e Zotit, na jep qumështin, këta nuk ja japin asgjë, krejt 'sallamadi' shtetin e Kosovës e kanë bërë ndërkombëtarët bashkë me neve, ne veç duke thënë "Yes, of cors..." Kaq, ne s'kemi ditur më shumë çka të bëjmë.

KRYETARI: Deputet, të lutem për hir të konsideratës!

MILAIM ZEKA: Kryetar, mos ke dert ti, unë e marr barrën mbi vete për ndërkombëtarët, jam nënshtetas evropian dhe e di çka po flas.

Jam shtetas dhe nënshtetas, të dyja, duplikat jam, Sami!

Problemi është shumë i thjeshtë, në qoftë se bëhet ligji, po shyqyr që nuk bëhet, as s' do të bëhet kurrë që i dyshuari të sjellë fakte te prokuroria, i dyshuari, unë të garantoj, Glauk, që i pari ti do të biesh në burg, pse ai hetuesi kriminel, që kryetari e ka thënë shumë mirë, e ka orën 50-60 mijë euro në dorë, që ai hetuesi kriminel, për të cilin kryetari i Kuvendit ka aluduar e ka edhe revolen në dhjetor të vitit '97, Serbia më '97 ia ka vazhduar revolen me leje...

KRYETARI: Deputet, të lutem, të kisha lutur, po bën gabim, koncentrohu në temë.

MILAIM ZEKA: Unë nuk po flas me emra, kryetar, po këta i ke në sistemin e drejtësisë. Kryetar, këta i ke në sistemin e drejtësisë që na kanë dënuar neve. Ata i ke gjykatës e prokurorë, a e di kush i ka fuqizuar kryetar? I kanë fuqizuar krejt strukturat e luftës, se keni bërë pakt me ta. Ju u keni thënë që unë e di që ti e ke dënuar motrën e kryetarit të Ferizajt, sot është kryetari i Ferizajt, atë njeri që ia ka dënuar motrën, e ke në Prokurori Speciale, e keni bërë kryeprokuror Zhitinë, ai qysh e ka pasur emrin, Hilmi Zhitia, e keni bërë prokuror para lufte që i ka dënuar Ali Lajçin, Destan Bujupin e Ramadan Shalën e Pejës, e Sali Kabashin e ka dënuar Flamur Kelmendi, atë prokuror e keni bërë ju pas luftës.

Nuk ka njeri këtu që ka mundur të bëhet prokuror e gjykatës pa kaluar nëpër shoshat e njerëzve të caktuar të politikës së Kosovës. Prandaj, nuk kemi ne këtu problem me ligjin, unë ligjin e

votoj me sy mbyllur, kemi problem me prokurorë dhe gjykatës, të cilët pa hakmerren në mënyrë më barbare kundër njerëzve të drejtë, kundër njerëzve të pakriminalizuar, kundër njerëzve që s'mund t'ua vejnë asnjë grep.

Ti në këtë shoqëri mund të ecësh përpara vetëm në qoftë se të shantazhojnë dhe pa asnjë argument, edhe me letra anonime, Policia e Kosovës sot mund të hapë hetime ndaj çdo personi që nuk u shkon atyre përshtati.

Çdo prokuror i Kosovës, i cili ka dënuar njerëzit tanë nga 15 vjet burgim politik, ne sot i takojmë ata. Kur hyjmë në zyrat e tyre, unë e Liburni, ata që ia kanë dënuar babën Liburnit e që e kanë dënuar Enver Dugollin, ne i takojmë ata dhe na thonë “hajde, o mirë se erdhe, a je mirë?”

Pa u bërë vetingu në Kosovë, pa u bërë Ligji i lustracionit, pa na i sjellë dosjet Kadri Veseli, që i di krejt, edhe unë i di, po jo sa ky, po pa dalë ky në foltore e të thotë në Kuvend ti, ti, ti, ti e ti ke qenë djepi i Serbisë, ti, ti, ti edhe ëndrra serbisht sheh, edhe kur të fle, sheh ëndrra në Beograd, kurrë ky vend s' do të kthehet për së mbari.

Një udbash i Pejës të thotë që unë i di se janë në Qeveri e janë në Parlament 300 bashkëpunëtorë të UDB-së, e ai të paraqitet si patriot, këta veç na ia kemi lejuar.

Ata që u frikohet udbashëve që enden nëpër Prishtinë, që janë në institucione, që na kanë torturuar, na kanë burgosur, ju lutem prej toke deri në qiell, jepni dorëheqje prej politikës, boll keni para, bëjmë fondacione, ju ndihmojmë në qoftë se jeni raste sociale, lëshoni more politikën! Lëshoni more politikën se ka ardhur puna që ata janë duke e drejtuar shtetin e Kosovës. Djepi i Serbisë është duke e udhëhequr Kosovën.

Më problem ka qenë, kryetari i Parlamentit e di, më rrezik ka qenë gjatë luftës, edhe Xhavit Haliti e di, më rrezik ka qenë gjatë luftës të rrish në Tiranë prej udbashëve të Serbisë se në Drenicë. Se Drenica ka qenë shpallur zonë e lirë dhe kund vend Adem Jashari spiunëve nuk u ka lënë, hiç, edhe ‘shumarit’ i thoshte ngadalë se s’je ti bash ‘shumar’, po i ke dy role, edhe ‘shumar’, edhe spiun.

E tash, prej Tiranës ata spiunë, me ndihmën e shokëve të mi, i ke në media, i ke në prokurori, i ke në Polici, në gjykata. Unë e kisha bërë në ligj kriter, një njeri që ka lindur para vitit 1990 të mos pranohet të punojë as në gjykatë, as polic hetues, as prokuror, se këta të ‘90-së për t’u bërë spiunë, se edhe s’kanë ditur serbisht, edhe diqysh është njëfarë brezi krejt më ndryshe. Nuk jam për hakmarrje, nuk e kisha burgosur asnjë njeri në jetën time, por jam vetëm për filtrim qysh e ka bërë Gjermania. Gjermania e ka sjellë ligjin, ai i cili ka punuar spiun i Ruisisë, mjeku nuk mund të punojë as në spital publik, e lëre më në prokurori, e lëre më në gjykatë, e lëre më kur e shohin Glaukun e babën ata ia kanë dënuar Glaukut, se babën e tij e kam jaran, e këta hiç, e tash merre

me mend Glauku shkon atje e i thotë “të lutem, a ma ndreq një punë”. Ai Glauk nëse bëhet për të dëshmuar, s’ka në botën perëndimore kurrkund, i akuzuari ose i dyshuari të dëshmojë diçka. Pasha Zotin, bëhu gati të kërkosh azil në Suedi, se s’do të mund të jetosh këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Unë ju kisha lutur të tërhiqeni prej emrave dhe kualifikimeve. Fitore Pacolli-Dalipi!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë!

Të nderur qytetarë të Republikës,

Siç e dëgjuat ministrin, e filloi fjalimin e tij për të kërkuar përkrahje nga ne për këtë projektligj me kërkesën që ky projektligj është diskutuar me Bashkimin Evropian dhe se është kërkesë e Bashkimit Evropian, mirëpo unë nuk e di, por ministri ose po manipulon me qytetarët e këtij shteti, ose nuk e ka lexuar saktë raportin dhe kërkesat e Bashkimit Evropian. Unë po filloj me dy citime shumë të rëndësishme nga dy raporte që janë më të rëndësishmet për vendin tonë: raporti për vendin, i cili u publikua në prill të këtij viti në faqe 21 në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën angleze e gjeni në faqe 20, thotë: “Kosova duhet të ndërmarrë masa që mundësojnë hetimin efektiv të pasurisë së paarsyeshme, duhet të bëhet ndryshimi i legjislacionit që kërkohet për të mundësuar zhvendosjen e barrës së dëshmisë për konfiskimin e aseteve, duke e ndarë veprën e shpëlarjes së parave nga vepra predikate, si dhe duke ndaluar bartjen e aseteve kriminale te palët e treta”.

Dhe, raporti i ekspertëve, pra ekspertëve të pavarur evropianë që u angazhuan nga Komisioni i Bashkimit Evropian për ta vlerësuar kapacitetin e institucioneve, për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, në faqen 4 të tekstit origjinal është i njëjtë edhe në tekstin në gjuhën shqipe, thotë “ Ligji për konfiskimin është joadekuat dhe ka nevojë për ndryshimet domethënëse, sepse ky ligj pamundëson zbatimin e kompetencave të shtuara të konfiskimit dhe të konfiskimit që nuk bazohet në dënim”. Pra, fare nuk e rregullon konfiskimin e bazuar në vlerë. E, konfiskimi që nuk bazohet në dënim po mungon te projektligji juaj, ministër.

Pra, kjo është kërkesa e Bashkimit Evropian dhe këto dy raporte, ju e dini shumë mirë se shtetet e Bashkimit Evropian kur të marrin vendime për Kosovën bazohen në këto dy raporte dhe ju qëllimisht nuk e keni adresuar kërkesën, ku thuhet se kërkohet që të bëhet amendamenti i ligjit, duke përfshirë konfiskimin e pasurisë që nuk bazohet në dënim.

Pra, kjo po i bie që nëse kjo qeveri e ka për qëllim që t’i bëjë ashtu siç duhet reformat evropiane, sepse çdoherë na flet për reformat, nuk do ta sillte në Kuvend një projektligj të tillë, sepse nuk e adreson kushtin themelor, pra konfiskimin e pasurisë të personave e zyrtarëve, të cilët e kanë fituar në mënyrë të paligjshme gjatë gjithë këtyre viteve, edhe pse nuk dyshohen për veprën penale. Pra, ju po e pamundësoni këtë hetim nëpërmjet këtij ligji.

Në Projektligjin për kompetencat e zgjeruara që i keni sjellë ju këtu në Kuvend mundësoni në njëfarë mënyre konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme vetëm kur ka vepër penale. Pra, ju manipuluat me publikun kur thatë se prokurori mund të fillojë hetimin dhe verifikimin e pasurisë pa pasur, pra aktgjykim të formës së prerë. Kjo nuk shkruan askund në ligj ministër dhe duhet të na tregoni nenin se ku shkruan.

Në faqen 4 të memorandumit shpjegues shkruan se hartimi i projektligjit ndërlidhet me agjendën evropiane. A nuk qenka kjo pjesë e agjendës evropiane Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme pa vepër penale, sepse ju e dini se kjo është kërkesë thelbësore e Bashkimit Evropian për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Pra, të dy raportet të cilat i përmenda thonë se Kosova ka bërë shumë pak sa i përket hetimit të krimit financiar, pra kapjen e personave, zyrtarëve të lartë, të cilët kanë keqpërdorur buxhetin e këtij shteti, pra korrupsionin dhe krimin e nivelit të lartë dhe ju mund të dilni të na tregoni se sa vepra dhe sa me numër i keni kryer, mirëpo shënimet nga Bashkimi Evropian na vijnë se nuk janë të kënaqshme. Shuma dhe numri i veprave që ju keni hetuar dhe konfiskuar nuk janë të kënaqshme. Ata, të cilët janë në krye ose kanë qenë në krye të shtetit nuk janë hetuar asnjëherë. Në faqe 17 dhe 18 të raportit të ekspertëve, thuhet: “Kudri ligjor aktual nuk paraqet ndonjë pengesë për kryerjen e hetimeve financiare që mund të zbatohen paralelisht me hetime penale,” por ju asnjëherë nuk e keni zbatuar këtë. Asnjëherë, në Kosovë nuk ka ndodhur që të fillojnë edhe hetimet për vepër penale, por edhe verifikimi i pasurisë.

Jo, nuk e lejon, ministër, nuk e lejon. Ky është manipulimi që po e bëni. Nuk e lejon ministër dhe në këtë mënyrë, pra edhe sipas ekspertëve evropianë, se ju thatë që keni konsultuar shumë ekspertë evropianë, kudri ligjor aktual e lejon mundësinë e hetimit dhe e verifikimit të pasurisë njëkohësisht. Mirëpo, çfarë është dashur të plotësohet është që të bëhet e qartë dhe të sqarohet fjalori, i cili është përdorur në kudrin ligjor aktual. Por, ju, për t’u hedhur hi në sytë e qytetarëve, e keni sjellë një projektligj në të cilin thoni se ju keni mundësuar që të fillojë hetimi për vepër penale dhe në mënyrë paralele të kërkohet verifikimi i pasurisë. Nuk e keni në ligj këtë.

Pra, atëherë kjo i bie që ky projektligj nuk do të sjellë asgjë të re, sepse nuk e adreson kërkesën kryesore të Bashkimit Evropian për ta amendamentuar legjislacionin që mundëson konfiskimin e pasurisë së paluajtshme, të pajustificueshme, pa vepër penale, por përveç kësaj ky projektligj, e përmendën edhe disa folës të tjerë, nuk e bën bartjen e barrës së provës mbi palën që akuzohet, por mbetet te prokurori dhe për më tepër, ky projektligj, në vend se të ndihmojë konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, e legjitimon atë, duke ndihmuar në fshehjen e pasurisë së përfituar përmes veprës penale. Pra, duke i dhënë hapësirë, ose duke e kufizuar periudhën në dhjetë vjet, atëherë ky jep mundësi që ata, të cilët janë pasuruar në periudhën ku

nuk i kap dënimi të lihen të lirë, pra të mos japin asnjëherë përgjegjësi për atë që kanë bërë, për keqpërdorimin e buxhetit, për korrupsionin dhe krimin e organizuar që i kanë bërë këtij vendi.

Prandaj, kjo tregon se Qeveria është e orientuar më shumë në mbrojtjen e pasurisë së fituar në mënyrë të jashtëligjshme, e jo në konfiskimin e saj. Pra, ishte shumë lehtë për këtë Qeveri që në emër të liberalizimit të vizave ta falë territorin, por po del që është shumë e vështirë për këtë Qeveri që të bëjë ligje të mira, që ndjekin partnerët e tyre, ndoshta edhe ata vetë për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ne kemi mesazh të qartë nga Bashkimi Evropian se pa e luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, pa pasur fakte konkrete, siç tha edhe drejtoresha për Ballkanin Perëndimor, e cila ishte në vizitë pak ditë më parë, pra nuk do të ketë asnjë hap para drejt integritetit evropian dhe është në dilemë edhe liberalizimi i vizave, sepse nuk ka fakte të mjaftueshme që tregojnë se kjo qeveri është e interesuar ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, po flasim për nivelin e lartë. Ju mund ta hetoni një zyrtar të nivelit të ulët, apo një mjek, apo një profesor, mirëpo duhet t'i hetoni zyrtarë e lartë, ministrat, ish-kryeministrat, të cilët e kanë zhvatur këtë shtet.

Dhe, ne mendojmë se nëse ky projektligj votohet, atëherë kritika nga Bashkimi Evropian do të përsëritet në raportin e radhës, i cili do të vijë vitin e ardhshëm.

Pra, unë mendoj se nuk duhet të humbim kohë në ndryshimin ose në amendamentimin e këtij projektligji që të merremi më tutje me të për shkak se nuk e adreson problemin themelor dhe ne duhet të fokusohemi te kjo, pra të kërkojmë një ligj, ta bëjmë një ligj i cili mundëson konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të jashtëligjshme, edhe kur nuk ka vepër penale.

Prandaj, ky projektligj nuk duhet të votohet dhe nuk duhet të shkohet tutje. Pasuria e pajustificueshme duhet të shqyrtohet, të vërtetohet dhe të konfiskohet pa pasur nevojë për t'u ndërlikuar me vepër penale. Prandaj, ky ligj nuk është ligji që na duhet. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Ose nuk je duke e kuptuar mirë, ose po do ta devijosh qëllimin e projektligjit. Neni 17 e qartëson qartë, e ndanë hetimin për konfiskim të pasurisë nga vepra penale, pra edhe faza kur mund të ndodhë një proces i tillë, neni 17 e qartëson shumë qartë këtë. Urdhëro, lexoje! Nuk lexohet projektligji nene-nene, pjesë-pjesë, por lexoje komplet dhe debatojmë.

Pikërisht, pra ky projektligj ka dalë si rezultat i raportit, i adresimit të çështjeve në Raportin e Progresit për mosefikasitet në konfiskimin e pasurisë dhe në momentin kur ne, po pikërisht edhe

ne e kemi, dëgjo - hetimin e pasurisë e ke në dy mënyra, konfiskimin e pasurisë, civile dhe penale. Kjo është me vepër penale, kjo është jo në mënyrë civile, ta tregova qartë, janë dy vende në Evropë që konfiskimin e pasurisë e kanë në mënyrë civile. Është Italia, që e ka bërë në vitin 1974, dhe Irlanda e Veriut, janë në mënyrë civile, mirëpo në këtë formë kriminelët i lë jashtë, nuk i fut në burg, sepse pa vepër penale ata në burg nuk mund t'i futësh. Kjo është çështja. Ky projektligj e çon atë individin e korruptuar në burg, në njërin anë, dhe ia konfiskon pasurinë, për dallim prej politikës aktuale që ka qenë plotësisht me të drejtë t'jetë e kritikueshme, i kemi pasur vetëm 30 ditë që pas dënimit të hetohet pasuria e tij, por çka mund të bëjë një prokuror për 30 ditë. Është e pamundshme.

Pra, pikërisht prej momentit kur fillon hetimi është procedurë e ndarë hetimi i pasurisë së personit, që më nuk ndërlidhet me vepër penale, mirëpo hetohet pasuria e tij që e ka fituar në 10 vjet dhe mundëson ngrirjen. Kufizimi është term i ri që përdoret nga Bashkimi Evropian. Këtë mund të mos ta dini, mirëpo përdoret nga Bashkimi Evropian kufizimi në vend të ngrirjes, kështu përkthehet edhe në Republikën e Kosovës. Kjo çështje është inkorporuar në legjislacionin tonë të ri, pra ky projektligj i adreson pikërisht të gjeturat e dy raporteve për vendin, edhe të vjeshtës së vitit 2016, edhe të kësaj pranvere që e patëm para 3-4 muajve. Në anën tjetër, mos manipuloni me qytetarët me opinionin publik, pra kjo është pikërisht në linjë me Bashkimin Evropian. Në momentin që ne do ta aprovojmë, të jeni të sigurt që Parlamenti i Kosovës do të përshëndetet edhe nga Komisioni Evropian për aprovimin e kësaj politike. Të jeni të sigurt për këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Pacolli.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Ministër, i kam dy pyetje: a mund ta dëshmosh dot pasurinë tënde sesi e keni fituar me këtë projektligj? Dhe, a mund ta dëshmosh pasurinë e Presidentit me këtë projektligj? Nuk mundesh! Dhe, ju po manipuloni me nenin 17, kur po thoni se prokurori i Shtetit mund të fillojë hetimin për verifikimin e pasurisë. Këtu thuhet sipas nenit 4, dhe prapë na dërgon te neni 4, ministër, dhe ju nuk i plotësoni kërkesat e Bashkimit Evropian, sepse Bashkimi Evropian kërkon që të kemi projektligjin, të kemi ligj që e konfiskon pasurinë e fituar pa vepër penale.

Prandaj, nëse ju keni fituar pasuri pa vepër penale, ky ligj nuk mund ta hetojë pasurinë tuaj. Dhe, në këtë po duam, po duam ta hetojmë pasurinë e personave, zyrtarëve, të cilët kanë përfituar nga ky shtet në mënyrë të paligjshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe Samiu ka replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, ju po thoni se ngrirjen e keni përkthyer si kufizim, unë po jua lexoj memorandumin që e keni shkruar ju, jo që e kam bërë unë, e unë këtu e kam Direktivën 2014-42 të Unionit Evropian, që thotë “ngrirje”. Por, ju shkruani kështu, thotë: “Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën 2014-42 të BE-së e të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 3 prill 2014 mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve”. E keni shkruar, po ata mendojnë “instrumentalitis” është diçka tjetër e sendeve dhe të ardhurave të krimit në Bashkimin Evropian.

Unë ju pyeta, çka domethënë koncepti “kufizim” në ligj, unë e di çka domethënë, por s’ka të bëjë me ngrirjen. Ky është sqarimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Faleminderit!

Ju përshëndes!

Në rend të parë është shumë mirë që bëhet ky debat para qytetarëve në mënyrë publike për vetë faktin se është një projektligj me rëndësi, por nuk është vetëm ky projektligj, është një ndërmarrje, e cila është e gjerë, pikërisht për këtë arsye desha të bisedoj edhe në këtë fjalim timin.

Nuk është mirë çdo gjë të shihet me nihilizëm, nuk është mirë çdo gjë të shihet vetëm në terma negativë dhe nuk është mirë të orientohemi vetëm nga individi për arsye se në momente të tilla kur specifikisht shkohet ndaj individit, ne e nxjerrim një projektligj veç për Abelardin, edhe për Presidentin, edhe për mua, edhe një për Albinin, një për të gjithë, po shteti funksionon në bazë të ligjeve, të cilat janë dhe e krijon një barabarësi, edhe të drejta, por edhe në të njëjtën kohë edhe të penaltetit, ajo çka është kryesore. Unë do të kisha theksuar se janë dy elemente, të cilat po përmenden, e këtu shpeshherë vetëm Bashkimi Evropian. Është e mirë kjo për arsye se rrugëtimi ynë është në këtë drejtim - Bashkimi Evropian, dhe po presim e mund të flasë me shumë bindje të madhe se rekomandimi për liberalizimin e vizave të Bashkimit Evropian do të jetë pozitiv. Po presim ta kemi javën tjetër edhe një vizitë, ende nuk është konfirmuar, ndoshta edhe një adresim pikërisht këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ta ndajmë këtë sukses, i cili është i përbashkët i pozitës dhe i opozitës së bashku me qytetarët tanë, edhe pse na pret edhe një rrugë, e cila nuk është tërësisht e kryer, por duhet të punojmë bashkërisht.

Do të flas te projektligji, por do të flas te kjo ndërmarrja përgjithësi e këtyre reformave në sistemin juridik. E përgëzoj ministrin e Drejtësisë, së pari për guximin, dhe në njëjtën kohë për vendosmërinë e tij për të kaluar nëpërmjet disa barrierave, që janë, e shpeshherë në realitetin tonë politik bëhen shumë manipulime. Ka pak vend, e them edhe prej përvojës, që njerëzit, të cilët e kanë, në gjuhën popullore të them, janë të involvuar, flas në mënyrë më të drejtpërdrejtë, flasin më së shumti për të njëjtën çështje, në të cilën vetë janë të involvuar dhe përpiqen të

paraqiten më moralistë. Shkojmë në aspektin e këtyre ndërmarrjeve, reformave të sistemit gjyqësor. Do të ketë ndryshime, të cilat është duke i bërë ministri. Janë folur shumë, i kemi dëgjuar edhe ne si parti politike, ka 11 vjet që jemi në pushtet, i kemi dëgjuar të gjitha. Ka qenë edhe deklarimi im publik, çdokush të jetë i barabartë para ligjit, kushdo që është, nuk ka petk e keqja. Mund të thotë vetëm fisi është më i mirë, fisi im është më i keq, nuk është petk. Kush është i inkrimuar, le te paguajë çmimin. S'ka nevojë kurrkush ta paguajë, as Vetëvendosja për një individ, as PDK-ja për një individ, as LDK-ja për një individ, asnjë parti.

Sistemi i drejtësisë është duke pësuar reforma. Aktualisht i kemi ndërmarrje ndryshimet, amendamentimet e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale. Në të njëjtën kohë, kurrkush nuk na ka e imponuar, ne e kemi filluar këtë, Ligjin për konfiskimin e pasurisë. Për të dërguar mesazh që kushdo që ka ngritur pasuri, po le të jetë edhe 20 vjet, le të jetë edhe 50 vjet, kushdo që ka ngritur pasuri që e ka të paarsyeshme, ligji do të mbetet aty,... Le ta gëzojë 10 vjet, 20 vjet, në fund do t'i trokasë dikush në derë dhe do t'ia marrë atë pasuri që e ka bërë në mënyrë të pandershme, edhe 20 bëjeni, edhe 30 Liburn, edhe 50, kjo është gradualisht, sa të doni. Në të njëjtën kohë, jemi duke shkuar në amendamentim edhe të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale. Në qoftë se shihni ndonjë gjë që mbrohet, imunizohet, për shembull ajo kolegja deputete tha "e ka bërë në mënyrë të paligjshme, e nuk është vepër penale". Jo, si të bësh pasuri në mënyrë të paligjshme është vepër penale, se është hajni.

Si të bësh pasuri në mënyrë të paligjshme, ke kryer vepër penale, është hajni. Në mesin e kësaj do të ketë iniciativa tjera, për atë arsye edhe dola të flasë. Do të shkojmë, do ta bëjmë këtë, kemi pasur raste, e ka njerëz që qëndrojnë edhe në social, siç i themi ne, çështje sociale. Për një vit i njëjti person, veç kur të bëhet milioner. Jo more, thotë "s'kam kërkuar unë, unë jam milioner". Hajde ta bëjmë deklarin e pasurisë të çdo qytetari të Republikës së Kosovës, siç bëhet nëpër vendet perëndimore. Është social, nuk ka lidhje, vetëm e shkruan formularin është në social, por le te dimë deklarin e pasurisë. Pastaj, daja, halla, vëllai prej Perëndimi nuk mund të japë dikush që jeton në Perëndim, nuk guxon vëlla, motër ta kesh, nuk ka për të guxuar se për arsye se në vendin ku jeton penalizohet edhe ai s'bart vepër inkrimuese për shkak teje. Edhe kjo do të ndodhë. Janë hapa të cilat do të vijnë gradualisht. Ta kryejmë këtë bashkërisht. Është leximi i parë me të dytin, të mos e ndalim një iniciativë që është e mirë, jepni idetë, futini të gjitha gjërat që janë shqetësim, që mendoni se po u ik dikush. Tash ne jemi në pozitë, ka një legjitimitet për të thënë se veç kush është në pozitë mund të ketë, edhe ashtu mundësia për korrupsion është, ju e dini edhe në Prishtinë kur keni qenë si parti në pushtet, kjo është kur ke pushtet edhe unë që njerëzit që janë të korruptuar shkojnë korruptohen, por hajde t'i çojmë para gjyqit, hajde t'ua marrim dhe t'i futim në burg.

Ai që u inkrimua në mënyrë vullnetare kurrë nuk ka për të kërkuar për të dëshmuar. E bëjmë edhe një kombinim në qoftë se nuk ju kënaq kjo vepër kur ka një vepër penale, e bëjmë një kombinim të mesit, që e kënaqim edhe atë kërkesën që e ka Lëvizja Vetëvendosje, e futim edhe

atë pjesë. Edhe konsultohemi, krejt këto çka u bën, po bëhen së bashku me partnerët tanë amerikanët dhe Bashkimin Evropian, për ç'gjë i falënderoj publikisht. Në të njëjtën kohë, pas kësaj të vazhdojmë, pa folur me emra, në të njëjtën kohë hajde të shkojmë edhe te vetingu, të shkojmë gradualisht. Hapi i ardhshëm nga vjeshta, shkojmë edhe te vetingu, në njëfarë forme e ndërtojmë një situatë, e cila nuk është vetëm një status teknik në Bashkimin Evropian, por ka të bëjë me cilësinë e jetës tonë dhe të fëmijëve tanë, atë çka ua lëmë trashëgimi.

T'i ndalim manipulimet, t'i ndalim keqpërdorimet, t'i sanksionojmë besa kush ka faj, s'kemi nevojë t'ia bësh me gisht, ta shani, ta fyeni njëri-tjetrin për ta humbur edhe moralin tonë nganjëherë nga nervozizmi. Shkojmë gradualisht, ligji është mbi të gjithë. I nxjerrim ligjet në Kuvend dhe jepeni kontributin, do të jetë ligji më i mirë në të cilin ju mendoni. Nuk do të ketë vërejtje të cilat ka për t'i pasur Lëvizja Vetëvendosje në ligj, me ët cilin janë të pajtuar edhe partnerët tanë amerikanë dhe evropianë, se s'kemi për t'i futur. Ama ta kryejmë këtë, të shkojmë te deklarimi i pasurisë, pastaj të gjithë bashkërisht e nxjerrim edhe një ligj dhe të shkojmë te ajo pjesa finale, apo të shkojmë edhe te vetingu, në mënyrë që gradualisht të shndërrohemi në një shoqëri perëndimore, në një shoqëri që edhe e pretendojmë, besoni kemi për t'i hapur perspektivë vetvetes, familjeve tona, shtetit tonë.

Në të njëjtën kohë kemi për ta rritur edhe pasurinë e çdo qytetari dhe kemi për ta rritur krenarinë e këtij shteti dhe të qytetarëve tanë. Kjo ishte që desha ta them. Edhe një herë ministër, të falënderoj për guximin dhe mos u ndal, e ke përkrahjen e plotë për të vazhduar edhe më tutje, edhe më thellë, vetëm në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare për të mos krijuar ndonjë keqkuptim në këtë proces, që të jetë vetëm një vendim i anës sonë, në këtë rast nga opozita. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ta ka përmendur emrin? Zonja Pacolli, më duket s'ta ka përmendur emrin. Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Atëherë, po e theksoj edhe një herë, ky projektligj është platformë për t'i legjitimuar të gjithë ata zyrtarë në postet publike, të cilët janë pasuruar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme. Nuk mund të krijojmë një shoqëri evropiane, të drejtë e të barabartë, nëse nuk hetohet pasuria e fituar në mënyrë të paligjshme te zyrtarët e lartë, të cilët ende e udhëheqin shtetin. Pra, nuk ka kombinim këtu. Nuk mund të bëjmë kombinim, sepse nëse bëjmë kombinim, atëherë ne i legjitimojmë ata që e kanë zhvatur shtetin.

Sa i përket liberalizimit të vizave, ashtu keni folur edhe para demarkacionit. Thatë, se nëse kalon demarkacioni, menjëherë do t'i marrim vizat. Ku janë vizat sot? Demarkacioni ka kaluar, u bënë katër muaj e nuk ka asnjë hap për të vlerësuar marrëveshjen që është bërë me Malin e Zi, siç keni deklaruar dhe nuk kemi as raport nga Komisioni i Bashkimit Evropian, i cili thotë se i kemi plotësuar kriteret për liberalizim të vizave. Prandaj, çdo fjalë që ju thoni është për të manipuluar

publikun dhe për të siguruar, për të bërë përpjekjet e njëpasnjëshme për të siguruar pastrimin e atyre zyrtarëve, të cilët janë pasuruar me të padrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Për herë të parë Republika e Kosovës e diskuton një ligj, i cili do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, qofshin ata zyrtarë publikë, qofshin ata ministra, qofshin deputetë, qofshin kryetarë komunash, kushdo. Për herë të parë kemi përpara një projektligj, i cili mundëson konfiskimin e keqpërdorimit të të gjithë zyrtarëve publikë dhe jo vetëm atyre, por edhe atyre që kanë përfituar në trafikim droge, edhe me qenie njerëzore, që s'kanë qenë të pakta viteve të fundit në Republikën e Kosovës, pra të gjitha ato që janë të listuara si vepra penale në Republikën e Kosovës.

Pra, për herë të parë kemi një projektligj, i cili do të pamundësojë legalizimin e asaj pasurie edhe në qoftë se është fituar dhe është në emër të tjetërkujt, sepse për herë të parë trajtohen edhe palët e treta, që nuk i kemi pasur më herët, qofshin ato biznese, qofshin familjarë, kushdo qofshin. Pra, për herë të parë ne po bëjmë një shkëputje nga e kaluara jonë, për herë të parë po shkojmë drejt një drejtimi, ku vërtet do të jemi efikas në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe me vepër penale. Kur t'i referoheni ligjit, lexojeni ligjin, kemi mbetur, që tre muaj, që katër muaj flet për një raport të tre ekspertëve, të cilët nuk e paraqesin qëndrimin e Komisionit Evropian. Ta kam treguar qartë, është e qartë, ai është raport i tre ekspertëve që kanë ndenjur 3 ditë në Republikën e Kosovës dhe për 3 ditë e kanë bërë vlerësimin e tyre. Ky projektligj del si rekomandim i Raportit të progresit, Raportit për vendin edhe të vjeshtës së vitit 2016, edhe të kësaj pranvere. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, s'ka më replikë. Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues.

Unë nuk e vë në dilemë qëllimin e mirë të ligjit, por ajo pse e mora fjalën për të shprehur dilemat e mia, kush e zbaton ligjin? Kosova, përkundër defekteve të shumta, jo që s'ka ligje, por gjithmonë ka pasur telashe me ata të cilët kanë gjukuar në emër të ligjit, është dashur ta zbatojnë ligjin dhe këtu më shumë po dal te shpjegimi i ministrit që bëri dhe për të qenë i kapshëm edhe për ne, edhe për opinionin, iu referua ekspertëve.

Kosova vuan nga një plagë që nga paslufta, plagë e ndërtimit të institucioneve dhe, për fatin e keq, metodologjia e formimit të institucioneve është bartur si frymë e politikave që kanë ndodhur në vitet 70-ta, 80-ta në Itali, që janë transportuar pastaj në Shqipërinë postkomuniste dhe pas luftës janë bartur edhe në Kosovë. Dhe, kur folën për ekspertët italianë që kanë dhënë kontribut, unë me thënë të drejtën pata dilemat në këtë drejtim, ekspertët italianë është dashur të bien edhe një prokuror, si Xhovani Falkone, sepse prokurorët aktualë që janë në Kosovë, janë njerëz të

shantazhuar, pjesa dërrmuese, kërkoj falje prej një pjese tjetër që e ndiejnë veten shumë profesionistë dhe të papërlyer, por një pjesë e madhe e prokurorëve janë ata të cilët, shoku Milo, foli me një gjuhë pak më të ashpër.

Unë si dhe ju, edhe shumë qytetarë kam përcjellë një rrëfim të Pashkë Marashit, ai në fund të fundit ka folur edhe me emra.

Zoti ministër, megjithatë për sojin e prokurorëve të cilët e mbajnë një qytetar të pafajshëm në mesin e qindra qytetarëve të tjerë të pafajshëm, që në emër të drejtësisë u bëhet padrejtësi dhe vuajnë nëpër burgje.

Ministër, ju keni folur me gjasë për njerëzit që i ikin drejtësisë, që nuk e respektojnë drejtësinë, por ju asnjëherë s'keni folur për njerëzit të cilët keqpërdorin drejtësinë për t'u bërë padrejtësi qytetarëve të Kosovës, siç ka qenë rasti tepër mizor ndaj djemve nga Drenica, Kiçina-Ramadani. Dhe, janë prokurorë të sojit të njëjtë, të cilët do të merren ta zbatojnë këtë ligj. Këtu është krejt dilema. Unë edhe në një nga seancat kam folur për ligjin e lustracionit dhe besoj se brenda dhjetë ditësh do ta përpunoj dhe do ta inicioj, sigurisht se edhe me ndihmën e kolegëve. Më vjen mirë që edhe në këtë seancë u përmend vetingu edhe nga vetë kryetari i Kuvendit.

Nuk mund të shkojmë si shoqëri përpara dhe të zbatojmë ligje, edhe të mira, si ky që po flasim sot, me njerëzit që janë, edhe një herë po e përsëris, të shantazhuar dhe ligjin e përdorin për llogari të nëntokës. Ne mendoj se disa çështje, meqë jemi në vonesë, duhet t'i shtyjmë paralel. Paralel në kuptimin e asaj që ligji dhe zbatuesit e ligjit të jenë në përputhje me ambicien dhe kërkesën që e ka Kosova dhe qytetarët e Kosovës.

Kështu që, unë gjithsesi mendoj që në lexim të parë duhet të kalojë ky ligj, për t'i hapur rrugë debatit nëpër komisione dhe për të mundur të përpunohet deri në atë shkallë sa që, besoj deri në lexim të dytë do ta inicioj edhe ligjin për lustracionin dhe thjesht soji i prokurorëve, të cilët e kanë torturuar qytetarin për 20 vjet, nuk do ta kenë fatin të jenë zbatues të këtij ligji dhe përmes këtij ligji t'u hakmerren njerëzve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Tash po flas në emër të grupit parlamentar, nëse më lejohet.

Dëgjo, ne folëm në parim, nënkryetari i komisionit, nëse më lejohet, ne sot po flasim në këtë seancë plenare për dy koncepte të ndryshme, për dy ideologji të ndryshme dhe për dy ligje të ndryshme.

Para vetes e kemi në rend të ditës shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetenca të zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Kolegët nga Vetëvendosja po i referohen një ligji, të

cilin e kanë sjellë në Parlament, që ka të bëjë me shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, për këto çështje kemi biseduar edhe në komision, ku përfaqësuesja e Vetëvendosjes, respektivisht kryetarja e komisionit, zonja Albulena Haxhiu, na kushtëzon në komision: “Ne nuk e përkrahim këtë ligj para se të na e përkrahni ju këtë ligj”, kjo ka qenë citimi i saj, që janë edhe në procesverbale. Andaj, mendoj që jemi duke humbur kohë në debat shumë, sepse edhe në komision të gjitha subjektet politike kemi kërkuar që të harmonizohemi gjatë grupit punues dhe t’ia japim sot përkrahjen në parim, por pasi këta bënë krahasime, unë i kisha bërë një tri-katër pika të krahasimeve çka rregullon ligji që sot po e shqyrtojmë, që e ka sjellë Ministria e Drejtësisë, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ligji i cili është i Vetëvendosjes (në thonjëza), se s’dinë as këta i kujt është, sepse nuk po dinë ta mbrojnë, se nuk po i referohen as ligjit të vet mirë.

Dua t’i citoj, projektligji i Lëvizjes Vetëvendosje ka për qëllim konfiskimin e pasurisë përmes procedurës civile, duke pretenduar të konfiskohet pasuria e pajustificueshme dhe pa një bazë vepër penale, ndërsa amnistion në tërësi të pandehurit nga dënimi në procedurë penale për vepër penale. Është i patejkalueshëm zbatimi i minimumit të standardit të sigurisë juridike si dhe parimi themelor kushtetues për qytetarët, konfiskimi i pasurisë mund të bëhet vetëm në rast kur sigurohen prova minimale dhe dyshimi i arsyeshëm i Prokurorit të Shtetit për një person, i cili potencialisht krijon ose ka krijuar pasuri të pajustificueshme përmes veprave penale, një gamë e gjerë e të cilave i kemi propozuar shprehimisht që janë të propozuar me ligjin të cilin sot ne po e shqyrtojmë.

Qëllimi i projektligjit të Ministrisë së Drejtësisë është që krahas konfiskimit të pasurisë, i pandehuri të marrë dënimin e merituar për veprën penale në pajtim me Kodin Penal. Qëllimi i projektligjit, po i bëj krahasimet, të Lëvizjes Vetëvendosje është që të amnistohen personat që kanë pasuri të pajustificueshme nga dënimi i paraparë, duke përjashtuar në tërësi procedurën penale dhe vetë ndëshkimin përmes kësaj procedure dhe duke u kufizuar vetëm në konfiskimin e pasurisë, me të cilën, sipas këtij projektligji, fillon dhe mbaron procesi në tërësi.

Projektligji i Ministrisë së Drejtësisë mundëson ngrirjen, që tha zoti Kurteshi, e pasurisë gjatë kohës sa zhvillohen procedurat hetimore penale dhe hetimi për konfiskim. Qëllimi i projektligjit që e kemi tash në shqyrtim është që gjatë kohës sa zhvillohet procedura hetimore penale dhe hetimi për konfiskim, Prokurori i Shtetit të vendosë masat e sigurimit të pasurisë përmes urdhit kufizues të përkohshëm dhe përfundimtar, me qëllim që t’i pamundësohet të pandehurit asgjësimi, tjetërsimi apo transformimi i pasurisë.

Projektligji i Lëvizjes Vetëvendosje fare nuk e rregullon këtë çështje kaq të rëndësishme dhe vendimtare për zhvillimin dhe përfundimin e procedurës së konfiskimit. Projektligji i Vetëvendosjes pretendon të aplikojë konfiskimin nëpërmjet procedurës civile, duke zbatuar

hetim penal, nëpërmjet propozimeve të projektligjit të Vetëvendosjes, prokurori i Shtetit fillon inicimin e veprimeve hetimore për personin që dyshohet se ka pasur të pajustificueshëm, përkundër që koncepti që pretendon ky propozim është procedurë civile dhe jo penale.

Projektligji, të cilin ne sot po e shqyrtojmë respekton dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për sa i përket hetimit penal dhe mundëson zhvillimin e hetimeve të veçanta dhe të ndara nga procedura penale, hetimin për konfiskim, si procedurë e rregullt në aspektin përmbajtjesor dhe procedural nga zhvillimi i saj deri në përfundim. Projektligji i ministrisë apo projektligji që ne sot po e shqyrtojmë mundëson kohë të mjaftueshme për prokurorë që të zhvillojnë hetime për konfiskim, ndërsa projektligji të cilit po i referohen kolegët nga Vetëvendosja është kundërthënës në aspektin e zbatimit të procedurave, nga njëra anë, vendos konfiskim në procedurë civile, nga ana tjetër, për arritjen e saj zbaton hetime penale. Për shembull, Ligji në fuqi për kompetenca të zgjeruara të konfiskimit të pasurisë mundëson vetëm 30 ditë pasi aktgjykimi për dënimin e të pandehurit të bëhet i formës së prerë, afat ky i pamjaftueshëm që të sigurohen prova dhe brenda kësaj kohe të arrihet të parashtrojë kërkesat për verifikim të pasurisë, ndërsa projektligji i ri mundëson afat të gjatë për zhvillimin e hetimeve dhe sigurimin e provave. Sipas propozimeve, Prokurorit të Shtetit i mundësohet të zhvillojë hetim për konfiskim në të gjitha fazat e hetimeve penale, nga fillimi i hetimeve, gjatë dhe pas konfirmimit të aktakuzës, gjatë dhe pas shqyrtimit kryesor dhe po ashtu, pesë vjet nga dita e bërjes së aktgjykimit të formës së prerë, me të cilin dënohet i pandehuri për vepër penale.

Projektligji që ne e shqyrtojmë sot qartëson edhe rregullon përgjegjësinë për barrën e provës, ku mund të themi që kjo është dallimi esencial në mes të propozimit që bën Vetëvendosja dhe propozimit që ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Drejtësisë, këtë çështje e adreson në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, ndërsa projektligji Vetëvendosje këtë çështje e vendos si ndryshimin e vetëm kryesor. Ndërsa, si i tillë bie ndesh me rregullat mbi legjitimitetin e palëve dhe përgjegjësitë e tyre në procedurë penale, ndërkohë që qëllimi është konfiskimi përmes procedurës civile. Nuk mund të ndiqet konfiskimi përmes procedurës civile duke zbatuar rregullat e procedurës penale, sepse me këto çka ju i keni shkruar në ligj, ne duhet ta ndryshojmë komplet sistemin e drejtësisë në këtë vend, edhe Kushtetutën, edhe krejt atë që është punuar. Dikush thotë kemi ligje të mira, dikush thotë nuk zbatohen ato ligje, deri te Kodi i Justinianit atje, ku është baza për sistemin e drejtësisë, duhet bërë ndryshime me këtë ligj. Edhe në memorandum, ku ju referoheni, tjetër gjë thoni, tjetër gjë shkruani aty, tjetër gjë shteti që ju i referoheni, e rregullon krejt ndryshe këtë çështje. Tashmë, me projektligjin e Ministrisë së Drejtësisë përfundimisht qartësohet dhe rregullohet roli i palëve në procedurën e konfiskimit, meqenëse është përcaktuar në procedurë për konfiskim të jetë procedurë e veçantë, hetimet për të janë të veçanta dhe, rrjedhimisht, krahas prokurorit dhe pala i pandehuri merr pjesën e përgjegjësisë në procesin e të provuarit në procedurë.

Projektligji i Ministrisë së Drejtësisë qartëson procedurën e zbulimit të informacionit dhe vënies para përgjegjësisë të personave të tretë të lidhur me të pandehurin. Projektligji që ne sot po e shqyrtojmë rregullon procedurën e konfiskimit të pasurisë të personave që kanë vdekur, të personave që janë në arrati dhe të personave që kanë çrregullime mendore, ndërsa gjemani një vend që propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje është vetëm në personat e vdekur, por jo edhe me ata që janë në arrati, apo personat që kanë pësuar sëmundje mendore apo çrregullime psikike. As për personat që kanë çrregullime psikike, as për personat që janë në arrati, ju kurrkund, me asnjë nen me asnjë pikë në ligjin që po ia propozoni Kuvendit, i cili s'është në diskutim sot dhe ju na detyruat ta bisedojmë këtë çështje, nuk e rregullon. Nëse e gjeni, atëherë ne po bisedojmë. Të mos bëjmë krahasime të mëtutjeshme, se kemi shumë krahasime, unë e them këtë, e kemi thënë edhe në Komisionin për Legjislacion, ta përkrahim ligjin, në grup punues, udhëhiqni ju Vetëvendosja grupin punues, ne do të marrim pjesë si anëtarë të komisionit, do ta japim kontributin tonë dhe ta bëjmë një ligj, i cili me të vërtetë është në harmonizim edhe me legjislacionin në fuqi, se na nuk mund të kemi ligj, i cili nuk ka bazë në Kodin e Procedurës Penale. Ne kemi pasur në Komisionin për Legjislacion mysafirë, do të thotë komisioni i Republikës së Kosovës dhe ndër të tjera, kryetarja e komisioneve i ka pyetur për ligjin dhe kur e kanë kuptuar ata se çka po mendon Vetëvendosja, kanë qeshur, thanë është shaka se nuk mund të ketë barrë të provës pa pasur bazën në procedurë penale, në Kodin e Procedurës penale dhe në Kodin Penal.

Andaj, të mos bëjmë politikë, nëse kemi ideologji të ndryshme, atëherë t'i ndërrojmë, të themi nuk e duam këtë ideologji, por jemi shumë optimistë që o nuk e kanë kuptuar as ligjin e vet, se për Ligjin e ministrisë u pa që shumica as nuk e kanë lexuar, gjatë seancës ju vinin shkrime që ju referoheshin atyre, andaj të mos bëjmë politikë me këtë ligj, ta shqyrtojmë, të shkojmë mes dy leximeve, ta japim kontributin se është ligj shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Të mos flasim për luftim të korrupsionit e të mos marrim veprime kurrgjë. Fjalët tona t'i mbulojmë edhe me veprime konkrete, jo vetëm me fjalë apo me fjalor folklorik këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Liburn Aliu e ka fjalë. A ke replikë ti? Liburn, Samiu ka replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e dëgjova me shumë kujdes zotin Beqa. Ky mori tash një shkresë, që s'e ka pasur përpara dhe mënyra e analizës dhe e krahasimit, pa cituar kurrgjë, është një degradim i asaj që quhet analizë, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kjo nuk është analizë. A di çka është kjo? Kjo është një përpjekje vërtet të gënjehen krejt anëtarët e Parlamentit. Ne jemi në të njëjtin komision, ligji i Vetëvendosjes është rrëzuar me vota. Krejt këto që i foli janë degradim i asaj që quhet analizë ligjore.

Unë nuk kam parë, unë e di që shpeshherë ka bërë përpjekje ta prishë mbledhjen, megjithatë të shkojë kaq larg, sa të flasë për dy ligje që vetë nuk i ka analizuar, sepse s'di asnjë normë ta citojë

si duhet, mua po më vjen shumë keq. Ne punojmë në të njëjtin komision dhe kjo çka e tha zoti Beqa, kjo është jashtë çdo norme, jo “padi civile”, jo “padi penale”. Pikërisht zoti Beqa, frika pra që e kanë njerëzit e pushtetit është se ligji i Vetëvendosjes kërkon marrjen, konfiskimin e pasurisë dhe mbylljen e hajnave në burg dhe kësaj po i frikohen, edhe ju, edhe të gjithë. Ky është problemi, nuk ka thelb tjetër këtu. Edhe ne po themi, nuk ka Union Evropian pa u treguar atyre që hajnat janë në burg dhe që hajnat nuk mund ta gëzojnë atë pasuri që ia kanë vjedhur popullit dhe e kanë sjellë në gjendje të mjerueshme. Ky është thelbi.

KRYESUESI: Hajdar, a deshe ti të flasësh? Kundër-replikë Hajdari.

HAJDAR BEQA: Flas si replikë. I njëjti, Sami Kurteshi, i njëjti demagog është edhe në komision. Kur flasim këtu, duhet t’ju vijë marre, ju e keni sjellë vetë ligjin tuve këtu, e keni lëshuar seancën, pse e tërhoqët? Pse s’po e bini prapë të diskutojmë për ligjin tuaj? Fol për profesionalizëm, fol për pushtet, fol për hajni, ky vetë ka qenë në pushtet, vetë ka qenë Avokat i Popullit dhe kur ka qenë Avokat i Popullit ka pasur aktakuza, vepër penale, për keqpërdorim të detyrës zyrtare. E di ky që ka pasur, a ka dalë fajtor a jo, është krejt çështje tjetër. Dy vepra penale i ka pasur. Ja them edhe cilat, ia lexoj edhe arsyetimet. Atëherë është mirë të bëheni i sinqertë, zoti Kurteshi, t’i lini këto demagogji. Unë them, e ke hetimin për konfiskim, neni 17, e lexon, unë nuk desha t’ja u lexoj ligjet, se ju po thoni i kemi lexuar, nuk desha t’jua citoj nenet, se po thoni i dimë, lexo nenin 17, ta thotë hetimin parlamentar. Kisha kërkuar prej zotit Kurteshi të bëhet i sinqertë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Liburn Aliu e ka fjalën. Po, e ka përmendur emrin, po në kundër-replikë e ka përmendur. Po, mirë de tash... Kujt i hyjnë në punë ato? Zoti Liburn Aliu, nëse doni.

(Debat në sallë)

Mirë është, po një ditë tjetër. Qysh thoshte Hyda, një herë tjetër i shohim edhe këto. Lëreni Liburnin ta kryejë, qetësohuni pak. Ta jap edhe ty fjalën për replikë pak më vonë, veç qetësohuni pak. Liburn Aliu e ka fjalën. Mos ia ndalni Liburnit fjalën!

LIBURN ALIU: Unë pata rast këtu të dëgjoj dhe duke u bazuar në ligj, unë desha t’i përmend disa manipulime radhazi që ishin këtu jashtëzakonisht konkrete.

U tha te çështja e dhjetëvjetëshit, para se të hyj në temë po flas, veç për manipulime. Dhjetë vjet, kemi të bëjmë me nenin e tretë, nenin 3, ku thuhet: “I pandehuri ka filluar brenda dhjetë vjetëve para ditës kur është iniciuar faza hetimore për një vepër penale të përcaktuar me nenin 2 të këtij ligji”. Ministri tha kështu: “A e di Liburni...”, ky është manipulimi “...e di Liburni...”, po nuk

mund të thotë me ligj të regjistrohet një pronë, e cila nuk i ka transaksionet bankare. Është e vërtetë që me transaksione bankare ka filluar prej vitit 2008/2009, por kjo s'do të thotë që ju tash edhe njerëzit që e kanë bërë pasurinë në mënyrë të paligjshme para kësaj kohe t'i lëmë ne ata, të mos merremi me ta. Dhe thatë, “nuk ke qysh t'i hetosh”. Pse po e paragjykon, pse s'ke s'i t'i hetosh?

Nëse e ka bërë pasurinë e paligjshme edhe para vitit 2008, ai duhet të hetohet dhe atij duhet t'i konfiskohet pasuria. Pse duhet të amnistohet ai, nëse pasuria e tij e paligjshme qenka bërë para vitit 2008? E dyta, ju thatë “vitin 2008”, po ligji po thotë ndryshe. Ligji po thotë “dhjetë vjet para...”, po, po, tash kthehem, ju iu referuat atij vendimi, i cili lidhet me transaksione bankare, a po? Këtu po thotë “10 vjet”. Në vitin 2022, cili vit do të jetë referencë? 2008 apo 2012? 2012 pra. Po, transaksionet bankare janë bërë prej 2008-tës. Çka nëse dikush e ka bërë në 2009-tën apo në 2010-ën atë pasurinë në mënyrë të paligjshme? Ju e amnistoni atë?

Prandaj, ju kisha lutur të mos manipuloni. Shikojeni, lexojeni ligjin që e keni shkruar vetë, se manipulimi i dytë juaji ishte “Ju s'po e lexoni ligjin, veç po flisni kështu..., lexojeni një herë ligjin e pastaj flisni”. Edhe unë po ju them juve: lexojeni një herë ligjin që e keni shkruar, që e keni sjellë ju dhe pastaj na flisni neve, se ne e lexojmë në hollësi ligjin që ju e sillni.

Tjetra, ju këtu thatë procedura është e përshpejtuar dhe i kemi 30 ditë, ka qenë diku me 30 ditë afat, e kështu me radhë.

Sipas këtij ligji është shumë e qartë që tek pasi që të shpallet fajtori fillon mund të fillojë verifikimi i pasurisë së tij. Neni 3, neni 4, neni 5 dhe neni 6 prej momentit kur bëhet kërkesa për verifikim të pasurisë deri te konfiskimi i pasurisë përshkruhet shumë qartë dhe krejt kjo ndodh pas dënimit, pra pasi që të shpallet fajtor personi të cilit i konfiskohet pasuria. Dhe, ne kemi këtu një koncept themelor që e kundërshtojmë, kundërshtojmë qasjen e juaj.

Ju po thoni kështu, po i amnistoni ata të cilët... pra ne po duam edhe me e konfiskua pasurinë edhe me e qua njeriun në burg, edhe ne jemi për atë, ne jemi plotësisht për atë, por ju po thoni “fillimisht le të bëhet vepra penale e mandej të bëhet konfiskimi i pasurisë”, kurse ne po themi “jo, le të iniciohet edhe prej konfiskimit të pasurisë”, nëse shohim që dikush ka bërë pasuri në mënyrë të jashtëligjshme dhe s'mund ta arsyetojë, ne ia konfiskojmë pasurinë dhe pastaj fillojmë edhe hetimin për atë punë, qysh e ka bërë atë punë? Kurse, ju doni që të dalë një vepër penale diku dhe eventualisht nëse s'del, s'kemi ç'bëjmë, s'ka dalë vepra penale. Ne sot i kemi zyrtarët të cilët i kanë milionët dhe nuk i kanë pasur rrogat dhe ju tash pritni që ta gjejmë diku një vepër penale, që të mund ne t'ia verifikojmë atij pasurinë? Jo. Le të jetë qasja e kundërt, të fillojmë nga verifikimi i pasurisë, të fillojmë nga konfiskimi i pasurisë dhe pastaj të kalojmë edhe te vepra penale.

S'do të thotë që përmes padisë civile nuk përfundon te vepra penale, sepse nëse ka ndodhur vepra penale kurrkush s'e amnistion askënd, as dhjetë vjet, as pesëmbëdhjetë, as njëzet. Pra, e para, ai dhjetëvjetëshi është jashtëzakonisht kriminal edhe për mua, komplet kjo e krijon mundësinë e amnistimit të pasurisë. Kur thoni atë "dhjetëvjetëshin", kjo ma kujton një shprehje që e sheh nëpër filma apo kudo që lidhet me kriminelë, që thonë: "Për milionin e parë mos më pyet, ndërsa për ata të tjerët pastaj, urdhëro, që ku i ke letrat!". Dhe, kur e kufizoni kohën, që thoni "Në momentin kur fillon verifikimi i pasurisë verifikohen vetëm dhjetë vjetët e para...", i bie që atë milionin e parë nuk kemi pse ia kërkojmë askujt, po ia kërkojmë këto që i ka me letra. Unë jam që të kërkohet edhe milioni i parë edhe të gjitha dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është për këtë.

Pra, duhet të ndryshohet komplet qasja drejt konfiskimit të pasurisë dhe drejt ndjekjes së krimit dhe ajo duhet të jetë qasja përmes edhe konfiskimit të pasurisë, jo domosdoshmërisht nëpërmjet veprës penale.

U tha këtu që duhet të bëhet deklarimi i pasurisë për çdo qytetar. Unë dua të ju kujtoj diçka, unë kam punuar në Drejtorinë e Urbanizmit dhe në gjeo-portalin që e ka Agjencia Kadastrale jepen vetëm pronat në kuptimin grafik. Nuk mundet qytetari, vetëm zyrtari i autorizuar veçantë prej Agjencisë Kadastrale, ta marrë vesh e kujt është filan prona. Kur kemi pyetur pse nuk po mundemi ne të kemi qasje, as si zyrtarë, kanë thënë: "Kjo është sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale!" Kur kam hyrë në analizë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, as me ligjin e vjetër e as me këtë të riun tash që jemi duke e trajtuar, nuk përmendet kjo çështje fare, nuk hyn në çështje të të dhënave personale të ndjeshme. Dhe pse nuk ka ndodhur ky publikim i të gjitha pasurive të qytetarëve që i kanë pasuritë e patundshme, patundshmëritë? Unë mendoj që ka pikërisht të bëjë me fshehjen e pasurive.

E para, para se të bëhet çdo gjë, hiç s'ka nevojë të pritet kurrfarë ligji, merrni vendim Qeveria që menjëherë gjeo-portali le të fillojë, le t'i publikojë të gjitha pasuritë e secilit qytetar që ka pasuri të patundshme, jo veç me u ditë aty grafika edhe numri, por le të dihet edhe kush është pronari. Mund të hyjsh në gjeo-portal, e di filan arën, ose filan tokën a truallin, e filan vendin, kur klikon në të letë dalë edhe emri kush është pronar. Kjo, madje-madje lehtëson shumë, e lehtëson shumë punën e drejtorive brenda komunës, e lehtëson shumë punën e shumë bizneseve të cilët duan të hyjnë në marrëdhënie me pronarët e nuk i dinë kush janë ata. Duhet të shkojnë në Agjencinë Kadastrale ta marrin vesh diqysh nëpërmes kanaleve kush qenka pronari i filan tokës, sepse s'po mund ta marrin një leje ndërtimi, ta zëmë.

Pra, prej kësaj do të duhej të fillonte ky... Eh tash, po flisni për reformën në sistemin e Drejtësisë. Kryetari i Kuvendit tha, "Vendi po pëson reformë", mbase po pëson! Nuk e di, edhe unë po mendoj që po pëson, se me këtë ligj këtu veç po pësohet, nuk po shoh që kemi edhe një përparim.

Po përmendet “nihilizmi”, “mohimi” dhe “mosbesimi”. Duhet ta kemi të qartë, gjendjen që ne sot jemi, me ndërmarrjet publike që janë përtokë, me postë, me Trepçë, me gjithçka, me sistem të shëndetësisë, me sistem të arsimit, çdo gjë është përtokë, ju po prisni ne të ju besojmë!? A po pritni të ju besojmë?! Po, ju e keni pru këtë gjendje! S’e kemi pru ne! ne kemi qenë opozitë dhe tash ju përnjëherë na vini e na thoni neve, “Tash ju duhet të na besoni, sepse e kemi pru një projektligj.” dhe ne kur e lexojmë këtë projektligj, prapë del që po vazhdon avazi i njëjtë. Pra, ju nuk e keni ndërmend të konfiskoni pasuri, ju në fakt e keni ndërmend të amnistoni njerëz të cilët para dhjetë viteve e kanë siguruar pasurinë në mënyrë të paligjshme. Dhe e dyta, nëse eventualisht gjen ndonjë vepër penale te ndonjëri, eh atëherë mund t’ia konfiskojmë pasurinë, përndryshe s’ka rrugë tjetër për konfiskimin e pasurisë.

Nëse mendojmë të shkojmë në Bashkimin Evropian e që njëri prej rekomandimeve të tyre është pikërisht kjo çështje, unë mendoj që ky ligj duhet rrënjësisht të ndryshojë. Atëherë, vijnë edhe liberalizimi i vizave e krejt. Ne po përtojmë të punojmë për liberalizim të vizave, kur bëhet fjalë për korrupsionin e hiç s’po përtojmë të japim territor në emër të liberalizimit të vizave, e kuptoni? Hajde, të mos përtojmë në këtë pikë dhe ta fitojmë liberalizimin në këtë aspekt. Kaq kam njëherë!

KRYESUESI: Zoti Tahiri, urdhëroni!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Çështja e dhjetëvjeçarit është problemi më i vogël i këtij ligji.

Propozimi im personal, që të paktën s’e ka gëzuar as përkrahjen e ekspertëve që kam punuar, as madje të këtyre tre ekspertëve ndërkombëtarë, ka qenë që të shkohet në dhjetë vjet dhe të jemi sa më efikas. Propozimi im, është edhe sot, të amandamentojmë dhe ta bëjmë nga viti ‘99, kjo kurrfarë problemi nuk është. Nga viti ‘99 e tutje, jo qe, qe, nga viti ‘99 e tutje çdo pasuri e..., esenca e asaj që trajton ky projektligj është pikërisht hetimi i kësaj pasurie, që është përdorur duke keqpërdorur detyrën zyrtare. Mundësia që prokurorët ta kenë me këtë projektligj, që të hetohet ajo pasuri.

Pra, vetë fakti që dyshohet se personi në fjalë, qoftë deputet, qoftë ministër, qoftë drejtor i ndërmarrjes publike, ka fituar atë shtëpi, ose banesë, ose atë veturë, me vepër penale, prokurori nisë hetim për atë çështje, pra nisë hetim. Në anën tjetër, e kemi ndarë procedurën e hetimit të pasurisë nga çështja e veprës penale. Nuk flasim më vetëm për pasurinë që ka përfituar personi me atë vepër penale që e ka bërë, por po flasim për të gjithë pasurinë e të pandehurit, për gjithë atë pasuri që tash ne propozimin e kemi bërë për dhjetë vjetët e fundit, mirëpo shkojmë nga viti ‘99, për 20 vjetët e fundit, pa kurrfarë problemi. Ajo nuk është çështje. Le të definohet qartë, nga viti ‘99 e tutje çdo pasuri që është fituar në mënyrë të paligjshme, ose të pajustificueshme, të konfiskohet. Pra, kuptojeni një gjë të qartë, janë dy praktika të konfiskimit të pasurisë. Është çështja, është ana civile dhe është ana penale. Çështjen, anën civile ua thash, e kanë dy vende në

Bashkimin Evropian, si rezultat i ballafaqimeve të mëdha me krim të organizuar, me problemet që kanë, i theksova edhe më herët. Edhe Italia prej vitit 1974 dhe Irlanda tash së voni që e ka aprovuar një politikë të tillë.

Pra, nëse shkojmë në procedurë civile, gjithmonë do t'i amnistosh ata që kanë përfituar atë pasuri, sepse nuk mund t'i çosh në burg, sepse është procedurë civile. Nëse shkon në anën penale, e konfiskon pasurinë edhe personat i çon në burg. Kjo është esenca e kësaj pra. Unë po ta them shumë singërisht, edhe Bashkimi Evropian, edhe zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian që s'dua t'i përmend me emra, jo në Kosovë po në Bruksel, janë shumë skeptikë që do të miratohet ky projektligj, sepse masat janë mjaftë të ashpra. Dhe ata, presin normalisht, presin nga përfundimi i këtij debati a do të miratohet apo jo, sepse vërtet ende nuk janë të sigurt që ne e kemi përnjëmend ta aprovojmë një politikë të tillë, që do ta rrisë efikasitetin në konfiskimin e pasurisë.

Pra, nëse ju e përkrahni nga tani e tutje do të kemi prokurorë shumë më të fuqishëm në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme apo sido që ta quani. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Adem Mikullovc, replikë. Liburni, replikë!

LIBURN ALIU: Pse, civilja e përjashton penalën? Pse duhet paragjykuar që civilja po e përjashtuaka penalën? Nëse sipas civiles ti konfiskon pasuri, pse amnistion krim? Kjo nuk amnistion krim. Pra, ti inicioje përmes civiles, nëse duhet të gjendet krimi, nëse gjendet krimi edhe vepra penale, është ana penale, është gjykata që merret me të. Pse domosdoshmërisht duhet ta paragjykojmë ne, unë këtë s'po e kuptoj! Pse duhet të kemi... Unë dakord jam, që kur ta gjejmë një vepër penale t'ia konfiskojmë pasurinë, atje le të jetë qasja e rregullt. Por, ta kemi edhe qasjen tjetër, përmes civiles e konfiskojmë pasurinë dhe në ndërkohë, nëse del krimi, del krimi. Por, gjithmonë kur të konfiskosh pasuri ka me dalë shtegu për ta hapur mundësinë edhe për ndjekjen e krimit, për veprën penale.

Tjetra, pse duhet patjetër të... edhe dje pata rast, më kujtohet te ligji i ndërtimit, mosvotimin apo kundërshtimin, u tha këtu, nëse doni civile duhet me e ndryshua edhe Kushtetutën, "nëse nuk e bëni legalizimin, priteni këtë farë pune, ka me u bë në Bruksel". Nuk është ashtu kjo punë. Duhet të ndryshojmë ne Kushtetutën, nëse ju tash qysh po thoni ju, na duhet në njëfarë problemi aq të madh sa që me Kushtetutë e me sistem e me krejt, po e bëni atë farë pune... Pse ky siklet? Pse ky siklet? Nuk duhet pasur siklet, a më kuptoni, te asnjë deputet. Hajde, urdhëro! Urdhëro, edhe ne i kemi qëndrimet tona, e fusim edhe këtë anën tjetër.

Kurrkush s'po thotë me e heq këtë ndjekjen e konfiskimin e pasurisë përmes veprës penale, po ajo le të vazhdojë, le të rrijë, por ta ofrojmë edhe mundësinë tjetër dhe kjo na ofron më shumë kah Bashkimi Evropian sepse në fund të fundit, atë e kemi të gjithë edhe pajtohemi në këtë pikë.

KRYESUESI: Unë mendoj që ne duhet të gjithë të kemi kujdes kur diskutojmë dhe kur kërkojmë të miratohet një ligj i tillë, edhe ai që po kërkon Vetëvendosja, ajo forma që po më ngjanë nganjëherë me ato ligjet, jo po vendimet, e ish-regjimit pas '45-tës, që kanë mbledhur "vishakun". Duhet me pas parasysh më së pari me u bazua tek të drejtat e njeriut edhe tek një standard kryesor që është në Bashkimin Evropian, çështja e pronës.

Çështja e pronës, trashëgimia, të gjitha këto duhet me i pas parasysh edhe jo konfiskim, jo konfiskim, por ngrirje. Ngrirje të pasurisë deri në vendimin e plotë të gjyqit, unë kështu mendoj që do të duhej të jetë dhe kështu funksionon gjithkund në vendet demokratike. Tani ky është mendimi im. Sidoqoftë, ministri e ka kërkuar edhe një herë fjalën për të replikuar me...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar deputet,

Nuk ka kurrfarë nxitimi, prej të hënës jemi duke pritur me e diskutua propozimin që e keni propozuar ju. Prej të hënës çdo ditë vij në seancë e kam pasur shumë qejf ai projektligj të diskutohet para tij dhe të ballafaqohen argumentet në projektligjin që ju keni propozuar për verifikim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme apo si quhet ai projektligji juaj.

Pra, në çdo moment kur ka ardhur momenti për ta diskutua atë projektligj ju s'keni qenë, nuk e di me çfarë arsytimi është hequr edhe nga rendi i ditës, pra kam dashur pikërisht që ai projektligj të diskutohet para këtij, t'i ballafaqojmë argumentet me projektligjin e juaj dhe me projektligjin që kemi proceduar ne si Qeveri e Republikës së Kosovës. Kurrfarë nxitimi s'kemi, qe tetë muaj jam duke punuar në këtë drejtim. Domethënë, tetë muaj po bëhen, dy muaj pas kohës që kam marrë detyrën, prej dhjetorit, jam duke punuar në këtë drejtim, pra në hartimin e këtij projektligji, që sot po e diskutojmë para jush. S'ka kurrfarë... kjo pra është një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm, një transformim realisht i sistemit tonë penal në konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Nuk mund me procedurë civile njerëzit t'i çosh në burg, sepse prapë po bie ndesh me fjalët tua, që po thua prokurori nuk mund të dëshmojë që ai e ka bërë. Në anën tjetër, ky projektligj e ka qëllimin që edhe atë keqbërës ta çojë në burg, ta marrë dënimin e merituar dhe me i konfiskua pasuritë. Sepse kriminelët japin krejt çka kanë, veç në burg mos me i çua. Pra, kjo është e rëndësishme, kjo është e rëndësishme. Edhe çështjen tjetër, që nuk e trajtuat fare është bashkëpunimi ndërkombëtar, pasuria e fituar me vepër penale, që është jashtë kufijve të territorit të Republikës së Kosovës, hiq më larg se në Shëngjin, ose në Durrës, unë besoj që ka pasuri të përfitur me vepër penale, që nuk është trajtuar më herët, që pikërisht ky projektligj e trajton. Ky projektligj trajton çështjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, merre dhe shikoje projektligjin që keni propozuar ju, s'e trajton fare, nuk e diskuton fare këtë çështje. Unë mendoj që atje ka më shumë pasuri të përfitur me vepër penale, qoftë të krimit të organizuar, qoftë të korrupsionit, qoftë trafikut me drogë, qoftë trafikut me qenie njerëzore, se sa në Republikën e Kosovës e që pronarët mund të sillen kënde.

Pra, pikërisht ky projektligj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Adem Mikullovcit ia kam dhënë fjalën. Veç Ademit një herë, pastaj ti Sami.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë edhe se nuk jam ndonjë ekspert i shkencave juridike, këtë projektligj e kam parë që në fillim që nuk është një projektligj që e lufton krimin e organizuar. Por, ajo që më la shumë përshtypje sot, është se ky zoti ministri u thirr disa herë në ekspertin që paska bashkëpunuar me të nga Italia.

Unë e pyes zotërinë, pak me groteskë, ku është krimi më i organizuar se sa në Itali, zoti Ministër? Po, ku ma gjete atë bashkëpunëtor, të lutem, pash Zotin? Unë këtë desha të ju them, hiç më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sami Kurteshi, urdhëro!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa për sqarim, megjithatë ajo që e tha zoti Beqaj ishte një mendësi jakobiane, nëse nuk do në temë të fokusohesh, fokusohesh në njeriun dhe në aspektin e tij moral. Po, edhe për këtë po i tregoj.

Unë e kam pasur një aktakuzë nga një prokuror që tani është kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka, të cilin e kam quajtur kriminel edhe është kriminel, që para tri ditësh erdhi dhe të përqafoi në zyrë të komisionit ty, me gjasë ti e ke shok. Kjo është çështja. Ai kryeprokuror e ka ngritur një aktakuzë që gjashtë vjet, që nuk e dimë çka është bërë. As a shkon, as a vazhdon... veç një po ua tregoj, ligjërisht prokurori disiplinor e ka dënuar edhe ia ka tërhequr vërejtjen gjyqësore kryeprokurorit Imer Beka për sjelljet joligjore kundër ish Avokatit të Popullit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Hajdari ka kundër-replikë.

HAJDAR BEQA: Unë jam kryesues i grupit punues për Kodin Penal. I kam ftuar krejt kryeprokurorët, i kam ftuar të gjithë aktorët që donë të japin kontribut, në mesin e tyre ka qenë edhe zoti Beka. Unë të gjithë i kam përshëndetur, por zoti Kurteshi shumë po flet për pushtet e kur ka dashur të bëhet Avokat i Popullit i ka thyer këmbët për ta votuar Partia Demokratike edhe ai presidenti që është sot. E di Samiu Vet. Jo, jo e di ti, e di ti, se e di edhe unë. S'është mirë atëherë me u bë i pasinqertë, a po kupton? Të flasim këta që janë për herë të parë, deputetët që

s'kanë qenë kurrë në pushtet. Kështu, unë kam qenë shumë konkret edhe kisha kërkuar edhe ti të jesh konkret. Nuk thash që je fajtor, por thash edhe në kohën tënde ke pasur padi për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ti ke pasur. Ke pasur kur ke qenë në pushtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Smajl Kurteshi e ka fjalën.

SMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Sot aktualisht në rend dite kemi shqyrtimin e parë të Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Realisht, nëse shihet sa kemi folur për këtë projektligj, del se s'është folur as një 30% e sidomos, më vjen keq që kështu duhet bërë një farë dallimi, deputetët e pozitës përveç disa vlerësimeve të përgjithësuar për një ligj të mirë nuk kanë diskutuar për asnjë nen të veçantë. Dhe, shumica e deputetëve më tepër i kanë komentuar fjalimet e njëri-tjetrit, këtu më tepër është folur për një ligj, i cili sot hiç nuk është në rend dite, e më së paku është folur për ligjin i cili është në rend dite e për të cilin sot do të duhej që të kontribuohet që të sugjerohej që të bëhen vërejtje, sepse unë jam shumë i sigurt që edhe ministri që e ka prurë, edhe deputetët prezentë, të gjithë ne, nuk mund të pretendojmë se ky ligj është i perfeksionuar dhe nuk e ka asnjë, nuk bën t'i bëhet asnjë vërejtje, se çfarëdo vërejtje që i bëjmë, mund ta prishim.

Prandaj, së pari mendoj që do të ishte mirë ne si deputetë të rrimë brenda rendit të ditës, të diskutojmë për çështjet që i kemi para vetes, nëse duam të kontribuojmë për t'i zgjidhur këto probleme. Po teprohet me komentim për të tjerët, fjalimet e të tjerëve, secili ka të drejtën këtu të thotë çfarë të dojë dhe përgjigjet për fjalën e tij. Po teprohet po ashtu, edhe sidomos kur po kalojmë prej teme në temë, siç sot u fol më tepër për ligjin që sponsor është Vetëvendosja, se sa për ligjin që është në rend dite.

Unë e mora fjalën që t'i drejtohem ministrit me një pyetje konkrete. Pyetja ime konkrete është neni 3, pika 1.5, pasuria e të pandehurit dhe pastaj kalohet në pikën 1.5.1, ku thuhet "i pandehuri..." domethënë ata që e kanë fituar pasuri brenda dhjetë vjetëve hetohen, kurse zoti ministër, unë e di, unë kam qenë deputet në mandatin e parë me disa prej jush, që disa njerëz para njëzet viteve s'kanë pasur biçikleta, i kanë grahur këmbë kanë ecur, deri në 2008-ën kanë pas bërë edhe veç helikopterë që s'kanë pas blerë edhe krejt ajo pasuri, nëse mendon që duhet të justifikohet, të tjetrën bile disa s'kanë pasur nevojë me vjedh pas 2008-ës, se paraja paranë e bie.

Kjo është vërtet mëkat edhe është vërtet e pajustificueshme dhe nuk ka mundësi kurrkush të ta përkrah këtë ligj. Hajnia është hajni, nëse ka ndodhur jo në '99-ën, po edhe në '89-ën edhe kurdo qoftë. Nuk plakët hajnia dhe këtë farë pike, që në pikën 1.5.1 duhet ta hiqni, sepse njerëzit pastaj mundohen të ruhen vetëm dhjetë vjet, si të kalojnë dhjetë vjet ia nisin edhe me u mburrë e me thënë "Unë kam pas vjedhur, valla, në 2007-tën po kaluan dhjetë vjet edhe tash unë mund t'i grah me atë pasuri, se është legjitime." Kështu që, kërkoj që kjo le të hiqet edhe ju kisha lutur bëhuni realistë kur t'i komentoni ligjet! Këso farë fjalë vërtet kemi dëgjuar, unë personalisht kam

dëgjuar në këtë Kuvend, edhe prej ish-ministrave të Drejtësisë, kur i kanë prurë ligjet për këtë fushë, edhe prej pushtetarëve të tjerë, për 0-korrupsion e krejt kështu. E tash, po del që krejt ato nuk kanë qenë të vërteta, sepse mu për shkak të korrupsionit ne nuk po mund t'i marrim vizat, për të cilat i falëm 8 200 hektarë e i mashtruar qytetarët dhe nuk do t'i marrim vizat dhe nuk do të ketë investime në Kosovë, derisa këtu nuk fillojmë fjalët me i kthye në vepra e kjo ndodh, së pari me vullnet të madh politik, sepse vetëm ligjet janë letra që nuk kanë me pas ndonjë efekt, nëse s'ka vullnet politik, po ashtu do të duhej të kemi edhe ligje të mira, në mënyrë që ata që kanë vullnetin politik ta kenë edhe një bazë të mirë ligjore, për ta luftuar këtë dukuri që do ta shkatërrojë këtë vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, replikë!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti deputet, Çështja që ngritët ju dhjetëvjeçare është problemi më i vogël i këtij ligji, më mirë me thënë s'është çështje hiç. Ky projektligj e trajton, i jep fuqinë prokurorit, për ta hetuar dhe për ta konfiskuar pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme, me vepër penale a sido që e quajmë.

Nuk është problem ajo, mund ta lëmë nga viti '99, mos ta kufizojmë fare, shumë mirë e the, hajnia është hajni dhe ajo duhet të konfiskohet pavarësisht kur ka ndodhur, plotësisht pajtohem me ty. Mirëpo, e rëndësishme është instrumentet që po i merr prokuroria në dorë me këtë projektligj në hetime dhe në konfiskimin e asaj pasurie të përfituar në vepër penale. Barra e provës, që i kalon të pandehurit për t'i gjetur ato faturat, ta dëshmojë pasurinë e vet që e ka fituar në mënyrë të drejtë, përndryshe t'ia konfiskojë shteti edhe normalisht, me e çua në burg. Ky është qëllimi i këtij projektligji. Dhjetëvjeçari mund të jetë nga e '99-ta, mund ta lidhim me çfarëdo periudhe kohore, nuk është fare problem, e rëndësishme është përmbajtja e këtij projektligji në pushtetin që i jep gjyqësorit në konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale brenda vendit dhe jashtë Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shkumbin Demalijaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk besoj se duhet të na shtyjë shikueshmëria e filmave, teorive të konspiracionit dhe të flasim për projektligj, se ku u fitua milioni i parë apo i dytë apo diçka tjetër. Po, jemi duke punuar një projektligj, që vetë kjo opozitë prejse jam deputet i kësaj legjislature, "Pse s'po e bini këtë ligj... Pse Qeveria s'po e punon ligjin... Pse s'po e ofron ligjin para Kuvendit... por njëkohësisht edhe ka punuar një draft, një projektligj për ta afruar deri te ky momentum. E kemi shqyrtuar edhe atë dhe këtë, të dyja kanë ardhur në Kuvend, mirëpo sot për të folur për projektligjin, datat, afatet, mund të rregullohen. Unë mendoj që duhet të punohet gjatë leximit të dytë dhe të gjitha këto që po i flasin deputetët të inkorporohen aty. Unë pata rastin këtu në korridor të bisedoj me një koleg, Fatmir Xhelilin, tha ka ndodhur një diçka e ngjashme në vendet përreth, por kur janë

sulmuar në këtë drejtim, për këtë justifikim dhe ju ka ngrirë pasuria, bile korporatave dhe kompanive të ndryshme, atëherë ka pasur edhe rrjedha të tjera negative financiare, për shkak se nuk është e arsyeshme vetëm t'i drejtohesh dikujt, për të bërë një kallëzim penal ose t'i drejtohesh Prokurorisë pa arsye, për shkak se atëherë ka edhe pasoja financiare që nëse e fiton pala që është akuzuar në atë aktgjykim, kur është korporatë e madhe, ka me miliona pasuri, e ti ia ke ngrirë, atëherë për humbjet kush duhet të përgjigjet.

Në këto elemente mendoj se ne duhet të shikojmë shumë më afër dhe ky projektligj të jetë i rregulluar dhe i përpiluar në atë formë dhe gjatë dy leximeve secili ta japë kontributin e vet, por jo vetëm duke bërë titur, se nuk mund ta na imponojë kurrëgjë vetëm se është duke bërë titur dikush në seancë, e të mundohet ta bindë dikë me bërë titur, me gjestikulacione të tjera, etj., ku keni qenë ju që 10 vjet, 3 vjet, ne nuk i kemi faj asnjë subjekti politik për shkak se ka filluar funksionimin e vet i regjistruar pas vitit 2010. Këtu kanë qenë të gjithë këta qytetarë, por sot është këtu, nuk mund të imponosh pse kanë ndodhur, këto ligje kanë qenë ekzistuese, vetë emrin e ka për zgjerimin e kompetencave në këtë fushë, por kryesisht nuk do të thotë se nuk duhet t'i lejohet edhe një hapësirë projektligjit që me akte nënligjore të rregullohen ato fusha ku nuk mund të dëmtohet edhe buxheti i shtetit, nëse dikujt i ngrihet pasuria, të jenë disa hapësira të tjera që mund të mbeten gjatë dy leximeve t'i shqyrtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që debatin e përcolla me shumë kujdes, por ajo çfarë këtë radhë do të them që në vitin 2012 Hajredin Kuçi, ministër i Hashim Thaçit, e kishte thënë po të njëjtën gjë që po e thotë sot ministri Abelard Tahiri, dhe po mundohem ta citoj: “Ne u kemi dhënë mundësinë në mënyrë retroaktive për njerëzit që kryejnë vepra penale që të shikohet pasuria e tyre deri më 31 dhjetor 1999. Nëse dikush mendon ndryshe, unë prapë jam i hapur, por unë mendoj se kjo është gjëja më e mirë, mbase paralufte i dimë rrethanat që kanë qenë në Kosovë, e dimë evidencimin që ka mundur të jetë në librat e tokave, regjistrave, por kjo është periudha më e afërt e mundur, më e mirë dhe më funksionalja”.

Të njëjtën gjë sot, pra, ministri po mundohet ta thotë, ndonëse kanë kaluar po aq vjet dhe se nuk kemi trasim të segmenteve të drejtësisë drejt pasurisë së paligjshme. PDK-ja madje ka pasur Ministrinë e Drejtësisë, pra ky ligj ekziston prej 5-6 vjetësh. Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, tha që është në pushtet shumë gjatë dhe se nuk ka pasur deri më sot asnjë rezultat. Po ashtu, kryetari i Kuvendit tha “barabarësia”, e kishte fjalën për këtë projektligj, në fakt, barabarësia, po i drejtohem tash ministrit, është që një ditë të jetë para barrës së provës për ta vërtetuar pasurinë.

Pra, barazia nuk mund të ekzistojë si koncept ndryshe, nuk ka ligj pa vepër penale, ministër, ky është problemi, nuk kemi ligj kundër pasurisë zyrtare, ky ligj është kundër personit. Gjithmonë,

duhet të nisët hetimi nga pasuria të personi dhe jo e kundërta. Po ashtu, Kadri Veseli tha se qytetarët e Republikës së Kosovës do të pasurohen me këtë ligj, në të vërtetë asnjë qytetar nuk do të pasurohet, ndërsa zyrtarët e lartë, përfshirë edhe këtu, edhe ata të cilët kanë qenë më parë, edhe ata të cilët nuk janë në këtë sallë, me këtë ligj pra askush nuk do të mund t'i zërë, sepse domethënë kanë kaluar shumë vjet. Fundja, mbrojtja e të drejtave të njeriut është edhe konfiskimi i pasurisë së paligjshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Ligji penal parasheh edhe parashkrimin e veprave penale, kështu që mos u bëni merak për atë punë. Fjalën e ka Gani Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Përshëndetje, kryetar Veseli!

Përshëndetje, zoti Haliti!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Unë kuptoj që këto janë dëshira që të bëhet për Kosovën gjithnjë e më mirë, ka mendime të ndryshme, por me një parafolës më duhet të them se përveç vrasjes, në ligje vepra penale nëse s'i është përsëritur brenda 10 vjetësh nuk ka ligj kurrkund në botë që e ndjek atë punë.

Për së dyti, po të mund ta bëjmë një ligj që prej tash të funksionojë, se çka të hallakatim më shumë veç e dëmtojmë vetën dhe ata, publikun, që po na shikon, po dalim joseriozë, se nuk jemi persona juridikë që mund ta kryejmë atë punë. Unë jam një prej biznesmenëve, bilancet e mia janë mbyllur dhe po 'të trenohet' Parlamenti, pasi të mbyllet bilanci, nuk ka kush çka të bëjë, qoftë edhe nëse jam kriminel, ose i kam bërë lekët me para kriminale, qoftë edhe dikush tjetër. Ne kemi çështje aktuale, për mendimin tim i kemi dy çështje që sa mund të di unë, ka krim të organizuar. E kemi KOSTT-in edhe Postë-Telekomin, atje janë duke shkuar lekët, këto mund t'i shpëtojmë. Është mirë të kthehemi kah Kibla, s'është vonë kurrë, por sa më për mbrapa të shkojmë, ne na bëhen lëndë më shumë dhe s'i përfundojmë kurrë. Është pabarazi, ne kemi pasur pabarazinë më të madhe ekonomike, ku zoti Mustafa i ka falur borxhet. Unë kam një vëlla, ai s'ka paguar kurrë kurrëgjë, atij iu kanë falur, unë kam paguar si budalla.

Dikush punon me ujë, nuk paguan tatim, unë paguaj, deshi Ramushi të na i falte, kur e kam parë, më tha "ta bëra një nder", i thashë: "Jo, valla, kurrëgjë se unë i kam paguar me kohë". E këtu të mundohemi të gjejmë një ligj të mos i maltretojmë qytetarët, unë e di që kemi nevojë për vota, njëherë për njëherë nuk po shoh arsye për zgjedhje, nëse është dikush që ka nevojë të frikohet, duhet të frikohet Ramushi se do të bëhet Kadriu kryeministër. Po mendoj, të punojmë bashkarish, edhe dje çka kemi bërë, se dikush ka punë edhe në shtëpi të vetën. Çka kemi bërë dje, në shumë parlamente, besoni që ndoshta nuk di të shprehem gramatikisht si ju që keni kryer fakultet, se unë s'e kam pasur babanë në punë as 'stipendi' s'më ka dhënë Tito, po më është dashur t'i bie vetes mbas, të punoj, ta rrezikoj jetën time dhe me djersën time të punoj. Për këtë arsye po ju them, të bëjmë një ligj që na vepron, na ndihmon prej sodit. Sa të shprushim prapa,

nëse ka diçka, e vërtetë që po thonë kolegët, edhe unë kam mëdyshje. Besa, edhe unë kam thënë derisa kam ardhur në Parlament e kam hyrë në grup funksional se krejt lekët po i vjedh Kadri Veseli, Ramush Haradinaj, e Hashim Thaçi, po s'ishte ashtu, se po vjedhshim edhe ne poshtë nga pak, edhe të Vetëvendosjes po i miratonin ta shpëtojnë, për shembull, Postë-Telekomin, që s'e kam pritur prej tyre hiç.

Neve na vjen një ligj ta përfundojmë, firma ka marrë 12 milionë, 12 milionë shkon rroga, i ka 1 900 punëtorë, bileta, Posta vjen prej Prishtinës, i nderuar kryetar Veseli, të lutem, mos e kalo këtë, për krejt respektin që kam. Ne s'duam ta ndërrojmë as menaxhmentin, sindikata merr rrogën 1 mijë euro, s'kanë tentuar ta shpëtojnë firmën e vet hiç, ku e marrin bukën, dhe neve na kërkojnë t'ua japim edhe 5 milionë. Vetë sindikata dhe vetë menaxhmenti ka denoncuar aksionarin e vet. Ai ishte në kundërshtim, plus e kanë përzgjedhur përmbaruesin, janë shkuar 700 mijë euro, por edhe kamata, Qeveria do të punojë. Si sindikatat, si ne deputetët, si çdo qytetar i vendit i kemi të drejtat e barabarta. Dikush s'ka rrogë hiç, dikush e ka 1 mijë euro rrogën dhe bën demonstrata, s'jam kundër sindikatave. Rasti i Trepçës është më i veçantë, se unë jam gati, kryetar Veseli, të tërhiqem prej komisionit, se po më duket s'po mund të ndryshoj të bëj barazi. Pse s'po mundohemi ne, ne e dimë të gjithë që kemi, dikush na i ka lënë 5 mijë euro babai, dikush 10 mijë. Unë kisha menduar tash që s'mund të ankohe mi në EULEX-in, as në UNMIK-un, të mos ia zëmë kokën njëri-tjetrit, unë kisha tentuar të bëjmë një amnisti fiskale, t' i qesim paratë, t'ia paguajmë një 10%, 20% kush i ka, të mos mundohemi veç në burg, e në burg, se s'shkon kurrkush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Ekziston, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarë të Republikës, një bindje e përgjithshme, jo vetëm perceptim e përshtypje, që krimi i organizuar dhe korrupsioni i nivelit të lartë janë problemi kryesor i shtetndërtimit tonë demokratik, por që besa, edhe i zhvillimit tonë ekonomik. Pavarësisht se vazhdimisht themi që duhet të luftohet krimi e korrupsioni, janë ndërruar ministrat e drejtësisë si rezultat i zgjedhjeve parlamentare, por asnjëherë si rezultat i shkarkimeve apo dorëheqjeve të tyre. Si bëhet që krimi dhe korrupsioni kanë qenë kaq të lartë, e asnjëherë asnjëri ministër i Drejtësisë nuk u shkarkua, apo nuk dha dorëheqje?

E dimë që korrupsioni e krimi i organizuar janë karakterizuar me shumë skandale të ndryshme, të cilat për javë të tëra i kanë mbushur edhe faqet e gazetave, edhe të portaleve e të mediave të tjera elektronike. Prej kërkesës “për lagje të fytit” nga Devolli për ish-shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, te dy vjedhjet e Dhomave të dëshmimeve në Policinë e Kosovës, të vendeve më të sigurta në Republikën tonë, një herë u vodh droga, e pastaj ari e kush e di se çka tjetër, e deri tek ky 53-milionëshi i fundit për “Bechtel&Enka”-n janë karakteristika të normalizuara të skandaleve që

nuk janë më skandale, po janë vetë rregulli i funksionimit apo, më mirë të themi i keqfunksionimit të institucioneve tona.

Unë nuk mendoj që korrupsioni në Kosovë është kulturë e shoqërisë dhe raportet e ndryshme ndërkombëtare e kanë dëshmuar një gjë të tillë, se vetëm 10% të familjeve në Kosovë paguajnë ryshfet për shërbimet që marrin. Në Mal të Zi është 34%, shumë më e lartë sesa në Kosovë. Pra, korrupsioni në Kosovë nuk është kulturë, por është sistem. Korrupsioni është i madh jo për shkak se është i përhapur, por për shkak se është i lartë në nivelet e larta. Dhe, kjo është në përputhje me bindjen time që në Kosovë nuk kemi shumë hajni e vjedhje, por kemi shumë plaçkitje e zhvatje. Se hajnia dhe vjedhja bëhen disi tinëz, nga njerëzit e rëndomtë, ndërkaq plaçkitjet, madje plaçkitjet e armatosura, sepse pushteti është armë, janë bërë pikërisht brenda sistemit e nga njerëzit në sistem. Në Kosovë, rrjedhimisht, shumë më tepër ka plaçkitje e zhvatje sesa vjedhje e hajni.

Projektligji që ne kemi propozuar e ka një funksion të thjeshtë: fuqizimin e prokurorëve dhe gjykatësve kundrejt të korruptuarve dhe kriminelëve, të cilët janë në sistem e të pajisur me pushtetin pors i një armë. Unë nuk kam dyshim që shumë më tepër, ta zëmë në Kosovë, i frikësohet kryeprokurori Aleksandër Lumezi ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahirit, sesa anasjelltas. E, të mos flasim për zyrtarët e lartë shtetërorë që ndodhen mbi ministrin e Drejtësisë. Ne kemi nevojë që ministrat t'i frikësohen kryeprokurorit, e jo anasjelltas. Ne kemi nevojë që presidenti, kryeparlamentari, kryeministri t'i frikësohen kryeprokurorit, e jo anasjelltas. Por, ne e dimë shumë mirë se çfarë kryeprokurori kemi! Ai është pors i një, le të themi, këngëtar që nuk këndon. Ai është këngëtar, por nuk këndon, sepse është kryeprokuror pa aktakuza, kryeprokuror pa kryeaktakuza. Përderisa kemi avokatë që janë shumë më të famshëm se prokurorët, ky vend nuk i ka punët mirë. Ne duhet ta çlirojmë sistemin e drejtësisë nga ekzekutivi, e kjo s'po duket ndryshe e mundshme përveçse duke e ndërruar ekzekutivin dhe asisoj të kemi prokurorë e gjykatës që trimërohen ta luftojnë krimin e organizuar e korrupsionin.

Problemi themelor i shtetndërtimit tonë demokratik dhe i zhvillimit tonë ekonomik është që prokurorët dhe gjykatësit u frikësohen qeveritarëve më shumë se anasjelltas. Ky raport i frikës është dështimi i drejtësisë në Kosovë. Dhe, në strategjinë shtetërore kundër korrupsionit 2018-2022 dhe Plani i Veprimit që na erdhi neve në Kuvend si deputetë, më 23 maj të këtij viti, ja se çfarë thuhet në faqe 21: "Në vitin 2015 nga 27 mijë e 077 raste penale të trajtuara nga Gjykatat e Kosovës, vetëm 200, ose më pak se 1% ishin shkeljet e korrupsionit, ndërsa më shumë ose më pak e njëjta prirje u përsërit në vitin 2016: nga 23 766 raste penale, vetëm 284 raste të korrupsionit, ose më pak se 1,2%. Ky model ka vazhduar edhe në vitin 2017; nga janari deri në qershor ka pasur 12 680 lëndë penale të vendosura në gjykatat e përgjithshme të Kosovës, ndërsa vetëm 151 raste kanë qenë raste të korrupsionit, ose sërish më pak se 1,2%. Edhe më shumë, nga këto 151 raste nuk ka pasur asnjë rast që rrjedh nga mekanizmi ndjekës. Prandaj, duhet të bëhen

përpjekje për të rritur numrin e rasteve të përgjithshme, si dhe numrin e rasteve komplekse që përfshin shuma të mëdha parash dhe asetesh që thuhet se janë vjedhur.

Nuk është duke u luftuar korrupsioni në Kosovë dhe, po e theksoj edhe një herë, bindja ime e fuqishme është se përderisa prokurorët dhe gjykatësit, e sidomos kryeprokurori, më shumë u frikësohet ministrave, kryeministrit, kryeparlamentarit dhe presidentit të shtetit, nuk do të ketë luftim të krimit dhe të korrupsionit.

Kemi nevojë për kryeprokuror, i cili tek ne bëhet i famshëm qysh ka qenë para një shekulli Elliot Ness në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë kur e vuri Al Caponen prapa grilave. Dhe, këtë nuk do ta bëjë asnjë prokuror i EULEX-it. Këtë nuk e bëjnë ndërkombëtarët. Drejtësia nuk është një gjë, të cilën ndërkombëtarët do të na e servojnë neve në pjatë të argjendtë. Drejtësia do të bëhet ose nuk do të bëhet vetëm nga ne, ata mund të na ndihmojnë, por në luftimin e krimit dhe të korrupsionit ata nuk mund të na zëvendësojnë neve. Dhe, synimi ynë kryesor është si të trimërohet, përkatësisht të fuqizohet prokuroria dhe gjyqësia në raport me pushtetin ekzekutiv së pari, e pastaj me të tjerët. Natyrisht që ligji nuk duhet të vlejë vetëm për pushtetarët, duhet të vlejë edhe për qytetarët.

Por, pikësëpari, më së shumti për pushtetarët, sepse po e potencoj që korrupsioni në Kosovë nuk është kulturë, por është sistem. Edhe studimet e raporteve ndërkombëtare e dëshmojnë këtë gjë. Popullsia jonë nuk është e korruptuar. Ne korrupsionin e kemi, e gjejmë aty ku e kërkojmë më së paku, brenda sistemit. E tash, nuk mund të kemi një sistem që e lufton korrupsionin, përderisa korrupsioni për nga përmasa e tij matet me hierarkinë në sistem: sa më lart që ngjitesh, aq më i madh është ai. E vetmja zgjidhje është të çlirohet gjyqësori dhe prokuroria nga ekzekutivi, e unë besoj që kjo është e mundur vetëm me zgjedhje të reja tashmë dhe, në anën tjetër, vetë gjyqësia e prokuroria të jenë të trimëruara, sepse do të fuqizohen.

Ju i keni parë që ministrat, kryeministri, të gjithë njerëzit mujsharë të këtij vendi kanë truproja dhe xhipa të blinduar dhe vështirë i sheh të pashoqëruar në sferën publike. Ndërkohë që të këtyllë i sheh prokurorët dhe gjykatësit. Në këto momente që ne jemi në sallën e Kuvendit, keni prokurorë e gjykatës pa truproje, të cilët janë duke pirë kafe në sheshin “Nëna Terezë”. A e dini pse? Se kujt keq nuk i kanë bërë që të ndihen të rrezikuar. Nuk kanë futur ndonjë mafioz të madh prapa grilave që tash të brengosen për sigurinë e tyre! E, kulmi me siguri ishte terrorizimi i kryeprokurorit Lumezi, të cilit njerëz të armatosur i hynë një natë në shtëpi, ia terrorizuan edhe familjen dhe ai të nesërmen të vetmen deklaratë që mundi ta japë e tha duke belbëzuar: “Nuk më kanë vjedhur gjë tjetër, përveçse telefonin”. Në shtëpinë e kryeprokurorit nuk mund të ketë gjë më të vlefshme se sa telefoni personal i kryeprokurorit.

Pra, le ta çlirojmë prokurorinë dhe gjyqësinë nga ekzekutivi dhe le ta trimërojmë duke e fuqizuar atë. Vetëm atëherë kur ju ministrat, e kryeministri, e kryeparlamentari dhe presidenti u frikësoheni prokurorëve edhe gjyqësisë më shumë se sa anasjelltas, krimi...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Po, urdhëro zoti ministër! Fjalën mundi ta vazhdojë, u mundova t'ia vazhdoj edhe 2 minuta.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Në mungesë të argumenteve dhe fakteve për projektligjin për të cilin po flasim, po edhe ato më herët që i kam proceduar në Kuvendin e Kosovës, e që lidhen direkt, pra me luftën kundër krimit të organizuar, tani dalim e flasim edhe për Aleksandër Lumezin, edhe për Hashim Thaçin, edhe për Kadri Veselin, edhe për ty, edhe për Memlin, edhe për të gjithë. Po, pse s'e keni ngritur kurrë domethënë që sa jeni deputet në Kuvendin e Kosovës, të gjithëve po ju them, çështjen që Republika e Kosovës e ka numrin më të vogël të gjyqtarëve për kokë banori në Evropë. I kemi 25 gjyqtarë në 100 mijë banorë, s'kemi pasur kapacitete të mjaftueshme, pse s'e keni ngritur kurrë çështjen që Republika e Kosovës ka më së paku prokurorë për kokë banori?

Pra, vetëm prej që është formuar kjo Qeveri, viti 2017, vitin 2018, 100 gjyqtarë të rinj po hyjnë në sistem në Republikën e Kosovës. Pra, 100 gjyqtarë të rinj do t'i kemi brenda këtyre dhjetë muajve deri në fund të këtij viti në kuadër të sistemit tonë, po ashtu janë Këshilli Prokurorial si rezultat i ngritjes së buxhetit, është duke e rritur numrin e prokurorëve që si rezultat i kësaj do të fuqizohet edhe Prokuroria Speciale që e ka për mandat luftën kundër korrupsionit edhe krimit të organizuar.

Çështje tjetër e rëndësishme, pra këtë sistem që e kemi ne, e kemi të bazuar mbi legjislacionin çfarë e kemi aprovuar, por pa dyshim që ka nevojë të ndryshohet. Pa dyshim, që Kodi Penal që e kam sjellë dhe që e keni votuar të gjithë, për çfarë ju falënderoj, pra që janë rritur dënimet për korrupsion, që është zgjatur afati i parashkrimit të veprave penale, Kodi i Procedurës Penale që do të vijë në shtator, ky projektligj, Projektligji mbi informatorët jam shumë i sigurt që e adreson pikërisht atë që po duan të gjithë, një prokuror, një gjyqtar më të fuqishëm. Një prokuror, një gjyqtar, i cili do të arrijë të konfiskojë pasurinë të fituar në vepër penale. Një gjyqtar dhe prokuror, i cili do të arrijë të ketë sukses në dënimin e këtyre qofshin ata keqpërdorues të parasë publike, apo trafikantë, çka do që janë, që t'i fusim prapa grilave. Pra, ky legjislacion, rritja e kapaciteteve në anën tjetër, rritja e numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë, pikërisht e fuqizon prokurorin, e fuqizon gjyqtarin.

Unë jam shumë i bindur që kjo do të ndodhë, jam shumë i bindur që pas rritjes së numrit të gjyqtarëve, të prokurorëve, mbas aprovimit të kësaj legjislature, mbas aprovimit sidomos të këtij ligji për konfiskim, i cili subjekt ka konfiskimin, jo personin, Kodi Penal është ai i cili merret me dënimet, Kodi Penal është ai i cili parashkruan veprat penale dhe është ai që merret me dënimin e këtyre keqbërësve. Pra, jam shumë i bindur që ne po arrijmë ta ndërtojmë një sistem, i cili do ta godasë fuqishëm edhe zhvatjen, plaçkitjen, edhe krimin e organizuar, pra me vullnetin edhe tuajin, normalisht, si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Pa votën tuaj normalisht as kjo s'kalon dhe unë pres që të gjithë ju ta përkrahni, ta përkrahni rritjen e numrit të gjyqtarëve, numrin e prokurorëve, ta përkrahni ngritjen e buxhetit për ta edhe për vitin 2019, qysh ka ndodhur në vitin 2018, vetëm në këtë formë ne mund ta kemi gjyqtarin dhe prokurorin e fuqishëm.

Pra, edhe ky debat po vjen si rezultat i propozimit prej Qeverisë, jo si rezultat i propozimit tuaj, thashë edhe më herët, që një javë i ikni debatit, të cilin vetë e keni propozuar. Pra, unë ju falënderoj paraprakisht dhe besoj shumë që do ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, sa herë ke diskutuar sot? Mirë, mirë, vetëm se Xhaviti ka qenë. Jo, jo, për hir të publikut, zoti Kurteshi, Xhaviti ka qenë shumë korrekt këtë herë, duhet pasur parasysh. A po i bën zoti Kurti sqarimet apo zoti Kurteshi? Njëri, njëri veç të mos t'jua jap të dyve fjalën. Zoti Kurti, veç tri herë më ke përmendur, unë s'bëra replikë.

Urdhëro, zoti Kurti le ta marrë fjalën, është mirë edhe për publikun, debat shumë i shëndoshë, kurr gjë s'ka të keqe.

ALBIN KURTI: Unë nuk i përsërita thëniet e kolegëve të mi deputetë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me hollësitë e projektligjeve, pra nuk desha të përsëritem, e para.

E dyta, ne e kemi ngritur qysh moti edhe çështjen e buxhetit të ulët për sistemin e drejtësisë, edhe të numrit të vogël të prokurorëve dhe gjykatësve, edhe të asistencës së munguar profesionale për ta, e që besa, edhe të mungesës së trajnimeve dhe kurseve shtesë për prokurorët dhe gjykatësit, që nuk duket se janë të përgatitur për të luftuar sidomos krimin e organizuar sa më të sofistikuar financiar, sidomos kur ai është edhe ndërkombëtar. Pra, i kemi thënë këto edhe më herët, mirëpo në Kosovë në përgjithësi ligjet nuk janë të këqija, institucionet janë të dobëta. Shtetndërtimi i Kosovës është i gjymtë për shkak se institucionet janë të dobëta, jo për shkak se ligjet janë të këqija dhe institucionet janë të dobëta, për shkak se pushteti në Kosovë nuk është shërbim, por është armë. Ky është përfytyrimi i gabueshëm që është krijuar për shkak të praktikave të korruptuara, të mbrapshta. Pra, pushteti në Kosovë është armë, nuk është shërbim.

Dhe krejt në fund, dua të them se ju mund ta rrisni numrin e prokurorëve dhe të gjykatësve, por ministër, katër frikacakë nuk e bëjnë një trim. Unë ju thash edhe më herët, problemi është që prokurorët dhe gjykatësit frikësohen ndaj Qeverisë më shumë se anasjelltas. Kot e rrisni numrin

e frikacakëve. Katër frikacakë, pesë frikacakë, dhjetë frikacakë, nuk e bëjnë një trim. Ju po e rrisni numrin e prokurorëve dhe gjykatësve pa i ndërruar koordinatat që i fuqizojnë dhe i trimërojnë prokurorët dhe gjykatësit. Më mirë dy prokurorë e trima, se njëzetë prokurorë e frikacakë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, lloj kundër replike, po Sami, tërhiqe të lutem, se mos ta bëjmë shumë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Nuk është mirë besoj me i quajt frikacakë, as prokurorët, as gjyqtarët, në radhë të parë.

Ne do t'i rrisim kapacitetet, ne do t'i rrisim kapacitetet dhe do t'u japim instrumente atyre në bazë të ligjit, që nuk i kanë. Legjislacionin e kemi të gjymtë në luftë kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Është pikërisht e kundërta e asaj që e the ti, e kemi të gjymtë. E kemi një Kod Penal me shumë zbrazëtira, që është aktualisht në fuqi, e kemi një Kod të procedurës penale me shumë zbrazëtira, e kemi një Kod të procedurës penale i cili ua mundëson njerëzve t'i ikin vuajtjes së dënimit dhe të na kthehet, të na sillet në Republikën e Kosovës, gjë që tani me projekt-propozimin e ri nuk do të ndodhë. Pra, nuk do të parashkruhet mosekzekutimi i dënimit.

Kemi shumë probleme në legjislacionin aktual. Pikërisht me këtë legjislacion, me këtë Kod Penal, me Kodin e ri të procedurës penale, me këtë Projektligj për konfiskim, me Projektligjin për informatorë që besoj se do të jetë sot në rend të ditës, me projektligjet tjera për Agjencinë Kundër Korrupsion...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Si vdesin, më fal vetëm pak, në qoftë se ka mundësi, si vdesin demokracitë e ardhmja jonë e rrëfyer nga historia e Seven Levinski dhe Daniel Ciflad.

Zotëri Glauk, në panairin e librit më ra të blej këtë libër edhe po e lexoj, për politikanë anti-traditë, të cilët zakonisht shumica e rasteve janë autokratë dhe përfundojnë në diktatorë. Popullistët janë politikanë anti-traditë, figura të cilat pretendojnë se përfaqësojnë “zërin e popullit”, vazhdues të luftës kundër elitës, ndërkohë që këtë të fundit e përshkruajnë si të korruptuar dhe konspirative. Popullistët kanë prirje ta mohojnë legjitimitetin e partive të radhitura dhe i sulmojnë si antidemokratike dhe si antipatriote. Ata u drejtohen votuesve me shprehjet se sistemi ekzistues nuk është demokracia e vërtetë, sepse është kapur nga të korruptuarit dhe është shkatërruar nga elitat. Premtojnë se do të varrosin elitat dhe do t'ia kthejnë pushtetin “popullit”. Ky lloj diskursi duhet marrë seriozisht, si diktaturë po mendoj. Jo, veç e lexova.

Sali Zyba tash, e vazhdojmë me Vetëvendosjen prapë.

SALI ZYBA: Kryetar, faleminderit për fjalën.

Edhe tash po arsyetohet mungesa e juaj në Kuvend, në asamble, domethënë ju po lexuarit tinëz! Ju përgëzoj! Por, s'e kuptuam autorin, ose në cilin libër saktë ishte kjo thënie, që të mund të paktën ta vërtetojmë...

KRYETARI: Veç edhe pak. E lexoj tash. Në panair të librit të fundit në gjuhën shqipe, e përkthyer tani së fundmi. "Si vdesin demokracitë?", titulli kryesor. "E ardhmja jonë e rrëfyer nga historia", Stiven Levicki, veç ta qartësoj. Hëë, unë libër lexova, kurrëgjë... Stiven Levinski dhe Daniel Ziblad, faqe... Aleancat fatale, faqe 33, mos me të munduar shumë, ha ha ha ha, faqe 33. Për besë, nuk janë fjalë të miat asnjë, bile-bile Glauku është filozof. Jo, e kam vërejtur, i kanë librat hallall u qoftë, lexues më të mëdhenj... Po, edhe unë e gjeta një, vetëm e përdora, kurrëgjë... Urdhëro, zoti Zyba. Kjo është... vetëm me korrektësi edhe kam qejf me ma konfirmua a kam qenë korrekt në citim. Faleminderit!

SALI ZYBA: Nuk e di a je korrekt në citim, se duhet vërtetuar, por në lexim ishe i dobët.

KRYETARI: Mësuesja Kimete, kërkoj falje që kam lexuar keq, por edhe emocionet. Kimeten e kam mësuese nga Gjakova në Mitrovicë, është ende shumë e fortë.

SALI ZYBA: E di që ke emocione, se ky libër flet për sistemin amerikan.

KRYETARI: I kërkoj falje asaj...

SALI ZYBA: E di që ke pasur emocione, por të lutem më lejo të flas.

Do të jem shumë i shkurtër, sepse sa i përket përmbajtjes së ligjit mjaftueshëm folën kolegët deputetë prej grupit tonë dhe të tjerët, sigurisht disa prej tyre. Por, për ministrin e kam një pyetje të veçantë, sepse e shmangu mundësinë t'i përgjigjet koleges sonë deputete, që tha "me këtë projektligj a munden me e vërtetua pasurinë tuaj?", po pse jo të tjerëve, të presidentit, të kryeparlamentarit e të tjerëve, iu shmange kësaj, nuk e di pse s'u përgjigjet!

Ndërsa, meqenëse po e vlerësoni guximin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, unë nuk e kuptova kryetarin e Kuvendit pse dy herë në fjalimin e tij si deputet kur në foltore juve ju tha se ju çmoj, ju përgëzoj për guximin. Domethënë, dy herë ju përgëzoi vetëm për guximin, jo për përmbajtjen, juve ministër ju ka thënë. Tash po dua ta kuptoj guximin nga gush?

Ndërsa, po ashtu në fjalim, në vazhdim të tij, vetë kryetari tha se ne qeverisim që 11 vjet, ndërsa ligjit ku ju i referoheni në afatin për të cilin keni marrë referencë për ta ndjekur një procedurë

është dhjetë vjet, që i bie ajo që e tha Liburni, vetëm mos pyesni për milionin e parë, për vitin e parë. Kërkojmë përgjigje për pyetjen që e patëm, që iu shmange një herë.

KRYETARI: Sa pyetje e përgjigje, por tash, më falni, tjetër herë. Hajde, ministër, edhe mos u tut hiç, ministër, ha ha ha...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Unë jam zyrtar i shtetit të Kosovës prej fundit të vitit 2007 punoj në institucione. Në vitin 2006 i kam përfunduar studimet, prej vitit 2007 punoj në institucione. Prej asaj periudhe e deklaroj pasurinë. Domethënë, ajo është, nuk është, asnjëherë as nuk është çështje, as nuk është problem deklarimi i pasurisë sime e besoj shumicës së zyrtarëve, të cilët nuk e kanë fituar me vepër penale.

Ajo që është e rëndësishme do të them ky projektligj që sot po e diskutojmë, e ka subjekt konfiskimin jo personin, sa e ka kodi penal personin, sepse ai dënohet në bazë të Kodit Penal, me dënime që i parasheh Kodi Penal, që janë rritur me parashkrimin e veprave penale, që po ashtu janë rritur vitet e parashkrimit të veprave penale. Kjo është çështja. Ky, ne sot e kemi debat konfiskimin dhe jo vetëm në Republikën e Kosovës, mirëpo në gjithë Ballkanin, ose në Evropën... ky projektligj mundëson adresimin e çështjes edhe të pasurisë së fituar në vepër penale, që mund të ekzistojë në Shqipëri, që mund të ekzistojë kudo në Evropë. Pra, ka instrumente, i jepen në dorë instrumente prokurorëve, që të adresojnë çështje të tilla. Besoj që isha i qartë! A të mbeta borxh ndonjë gjë, sa jam këtu në foltore?

KRYETARI: Urdhëro, zoti Zyba!

SALI ZYBA: Mund ta kuptoj që për presidentin dhe për kryeparlamentarin mund të mos përgjigjesh, por ti as për vete nuk u përgjigje. E the “deklarimin prej 2007-tës”. Je si zyrtar, ke deklaruar pasuri edhe verifikimin, edhe për pasurinë tuaj të pajustificueshme duhet të merret me ligj, bazën ligjore po na duhet, barra e përgjegjësisë, barra e proceseve e kujt është? Mirë, mirë, procese, se me e quajt prova, është proces, aty termi është provë, e kam parasysh “unë kam provë”, por për procesin është prova. Nëse ishe i saktë të jesh i saktë në të gjitha termet e ligjit.

KRYETARI: Ministër, mundesh...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Pikërisht pra, këtë legjislacion, që besoj se do ta votoni edhe ju, do t’i qartësojë të gjitha dilemat për cilindo zyrtar, qoftë për ty, qoftë për mua, qoftë për këta, qoftë për ju e për të gjithë, ky projektligj e mundëson këtë trajtim, e para.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, që e theksoi edhe kryetari i partisë suaj, ky projektligj e mundëson, e pamundëson, legalizimin e pasurisë e cila mund të jetë fituar tani dhe mundohet të

legalizohet pas pesë vjetësh, ose gjashtë vjetësh, ose tetë vitesh. E pamundëson një gjë të tillë, që është tepër e rëndësishme, sepse mund të ketë pasuri të përfituar me vepër penale dhe të jetë në emër të dikujt tjetër, qoftë biznes, qoftë familjar. Dhe tani ky projektligj e pamundëson transferimin e pronës në një formë të tillë, që ai person që e ka fituar ta gëzojë.

Ky projektligj e sqaron çdo dilemë, pasurinë time, tënden, të këtyre, të gjithëve, vetëm votoje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi vetëm edhe një deputet. Bilall, nëse do, librin ta lexoj edhe një herë, “Si vdesin demokracitë?” Teuta Haxhiu. Sami, t’u kisha lutur, në qoftë se ka mundësi, unë ta jap prapë fjalën, por po më thonë 6-7 herë, ta jap një minutë edhe u krye, edhe Bilalli ka kërkuar fjalën, se ia përmenda emrin. Urdhëro, zonja Teuta.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Për më shumë se katër orë rresht është mirë që është debat, por sinqerisht me vëmendje i dëgjova secilin koleg dhe kolege deputete, po edhe ministrin, i cili ishte i gatshëm pak si shumë me dhënë shumë herë të njëjtën përgjigje, por megjithatë gatishmëria e tij dhe vullneti i tij ndoshta në këto suaza, po e vlerësoj.

E kemi kërkuar, është kërkuar prej secilit deputet që veç pak ka ndërgjegje, ama veç pak ka ndërgjegje, që të vijë ky ligj. Dhe, nga gjithë kjo që u diskutua sot, unë e quaj trimëreshë dhe trim atë që e voton një projektligj që është draft i ardhur prej Qeverisë, por Qeveria nuk bën ligje, Qeveria ia sjell Kuvendit. Për hir të qytetarëve, për t’ua sqaruar edhe një herë, deputetët e kanë mundësinë deri në 50% me e ndryshua një projektligj që silltet nga Qeveria. A jemi të gatshëm për ta bërë një ligj që ua konfiskon pasurinë e paligjshme, apo jo?

Nga kjo që po shoh unë e që ka shumë deputetë brenda Kuvendit që e kanë ndërgjegjen e pastër, në të gjitha grupet parlamentare, po ka shumë prej atyre me biçikleta e pa biçikleta, që tha zoti Kurteshi, pikërisht në grupin e vet, që as biçikleta nuk kanë pasur e që sot për një kohë shumë të shkurtër kanë, jo ato që i kanë të deklaruara, shqetësimi im dhe i qytetarëve është për ato që nuk janë të deklaruara apo që janë në emra të tjerë të familjes apo kujt do qofshin. Ai është shqetësimi i qytetarëve.

Nuk jemi ne që sot kemi zbritur prej hëne, jemi deputetë dhe qytetarë të këtij vendi, ama për secilin bre, për një periudhë shumë të shkurtër kohore, prej pasluftës nuk kanë pasur biçikleta, jemi shumë dëshmitarë, janë krejt qytetarët, sot nuk ia dinë skajin pasurisë. Dhe, nuk munden kurrë, ama kurrë, me e tregua të vërtetën, me e pasqyruar me dokumente që e kanë prej një page të deputetit, kurrë. Me banesa që për një periudhë kohore trevjeçare ndoshta i bëjnë banesat midis Prishtinës, me xhipa të zinj 00 besa edhe të zi e të bardhë e çfarëdo, me kilometrazhë 00.

Janë pikërisht në grupin e Vetëvendosjes, pikërisht, por ka edhe në grupet tjera, ama mos u shitni patriotë, se s'ka bre patriotë.

Ligji, në fund të fundit, nuk e merr në fund kur të finalizohet, nuk i shkruan që është i propozuar, as prej grupit parlamentar, as në emër të kujtdo, as Teutës, as cilitdo deputete apo deputet, që mund të ndikohet prej shkrimeve, që kushdo, ama shkrimet kur i marr unë më së pari e mas veten a e kam bindur Teutën për të thënë diçka apo nuk e marr blanko çka mund të më thotë një zyrtar edhe i subjektit tim politik.

Edhe një herë po them, ajo që është guxim sot, është votimi dhe kuptohet plotësimi i ndryshimit deri në 50%, pikërisht prej Kuvendit, prej deputetëve, edhe ligji i propozuar prej Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes ka gjëra shumë të mira. Po! Por, unë sa e pash edhe ministrin, është i gatshëm dhe në fund të fundit, nuk është more veç vullnet i ministrit, po s'e pyesim hiç ministrin, veç ta bëjmë një ligj të mirë, ama ligj që me të vërtet jemi të gatshëm, po qe se jemi të sinqertë, po qe se jemi të pastër, po qe se kemi guxim, po qe se nuk jemi të korruptuar. E ata që janë të korruptuar, kurrë s'kanë me ia dhënë votën këtij ligji.

KRYETARI: Të përgëzoj, ministër. Faleminderit! Bilall Sherifi, pastaj edhe Sami një minutë, po, po, po ta jap fjalën veç mundësisht.

BILALL SHERIFI: A po ma lexon atë apo jo? A po ma lexon qysh vdesin demokracitë që të mund të përgjigjem, apo jo. Se aty më lidh mua.

KRYETARI: Jo, mos më fut edhe një herë, se është më mirë me e lexua ju vet. Është libri më i mirë i vitit, kine parasysh. E kisha lexuar po merr gjatë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Rreth këtij projektligji unë fola në cilësinë e kryetarit të grupit. I thash ato që kisha për t'i thënë edhe në emër tim personal. Ajo që do të kisha thënë tash, meqë më përfshire në debat pa e pasur ndërmend, është se demokracia i ka dy dimensione, atë procedural dhe aspektin apo dimensionin e kulturës, mënyrës së jetesës, sistemit të vlerave për të cilat një shoqëri është e gatshme të bëjë çdo gjë dhe ajo që këtu shpeshherë keqkuptohet është, se demokracia si procedurë mund të perfeksionohet brenda një periudhe shumë të shkurtër. Brenda një viti mund t'i kalojmë me procedura të përshpejtuara të gjitha ligjet dhe procedurat, përmes të cilave ne mund të dalim dhe të proklamojmë se e kemi kryer, e kemi përfunduar demokracinë në Kosovë. Por, deri te kuptimi apo le të them, është deri te ai momenti kur ne si shoqëri, si komb, si popull, në përgjithësi e kuptojmë dhe i përqafojmë ato vlera demokratike si mënyrë jetese, do të na duhet më shumë kohë se sa qoftë edhe një legjislaturë apo dy, ku nevojitet në formë të përshpejtuar t'i kalojmë ligjet, por ato pastaj të ngecin në zbatim.

Demokracia nuk matet me atë sesa dhe çfarë ligjesh të mira kemi, por sa dhe si është zbatueshmëria e tyre. Ajo që unë në fillim kërkova është që të bëjmë ligje të cilat mund t'i zbatojmë dhe jo të bëjmë ligje që në dukje të parë janë perfekte, por në fakt, kur fillojmë t'i zbatojmë në funksionim të ngecim, siç kemi ngecë në shumë ligje. Unë nuk jam ithtar i asaj që të bëjmë ligje, ku mund të fillojë “ndjekja e shtrigave”, ajo thënia e famshme apo qasja që ka mbretëruar në mesjetë për 300-400 vjet. Jam për atë që të bëjmë ligje ku në një proces të mirëfilltë demokratik, pa i rrezikuar seriozisht të drejtat dhe liritë elementare të njeriut, të arrijmë të kapim dhe të dënojmë të gjithë ata që në mënyrë të jashtëligjshme kanë arritur të pasurohen.

Shpeshherë e kam thënë në komision, ku si duket jam keqkuptuar, janë dy strategji apo dy qasje, dy mënyra, për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Njëra është që, nëse më lejoni të marr një analogji, të thajmë lumin për të kapur peshqit apo të hedhim rrjetën për të kapur peshqit. Këtu unë kam parë që ka ithtarë të asaj që themi ta thajmë lumin, ta shterim krejt lumin, veç t'i zëmë ata. Aty pastaj ka pasoja shumë më të mëdha se sa kapja e tyre. Nuk është rrugë e duhur, së paku kjo është bindja ime, që të krijojmë një ligj ku shtrohet pyetja kush është pastaj autoriteti, që konstaton se kush duhet të verifikohet.

Nëse bëjmë një ligj ku do të mund të bëjmë me gisht nga kushdo, “tash hajt ti tregona pasurinë”, siç u tentua këtu në seancë e është tentuar në komision, atëherë duhet të ndërtojmë edhe një polici, të krijojmë edhe një polici si një rang të moralit. Të shohim kush është tash i moralit, kush mund të jetë hajn... hajde tash ndiqeni atë, silleni para gjykatës dhe e vetmja pyetje që do të mund t'i bëhet atij është “na trego kah e ke marrë pasurinë”. Ndërsa, shteti ka në dispozicion mijëra njerëz, dëgjoni, duke filluar nga Policia, nga Hetuesia, nga Gjyqësia e Prokuroria për të provuar fajësinë e dikujt, individit nuk ka në dispozicion asgjë për të provuar pafajësinë. Prandaj, shoqëria demokratike ka përparuar, ku barrën e provës e ka zhvendosur tek shteti dhe jo tek individit, sepse individit nuk mund të posedojë resurse të mjaftueshme për të krijuar mbrojtjen, për të krijuar një proces përmes të cilit ai do të mund të dilte i pacenuar, sepse në anën tjetër ka një arsenal të tërë shteti.

Pra, shteti i cili ka një arsenal të tërë të mjeteve financiare, të njerëzve, të ekspertëve, të policëve, të hetuesve, të prokurorëve, qenka i pafuqishëm të provojë fajësinë, ndërsa individit do të duhej të jetë i fuqishëm për të provuar pafajësinë, i vetëm, kështu pa asnjë mbështetje! Kjo është pak a shumë, për mendimin tim, i ngjet asaj kur në rrugë ua kanë ngjitur njerëzve atë “yllin e Davidit” edhe tash dëshmoje që s'je jahudi. Pak a shumë, kështu më ngjet. Dëshmoje që ti je pastrua nëpërmes tre-katër brezave që ti më nuk je, ke qenë po më nuk je. Nuk shkon kjo!

Le të ndërtojmë një sistem, le të ndërtojmë një proces të besueshëm, ku shumicën apo numrin më të madh të atyre do t'i zëmë, do t'i dënojë ligji, jo unë, ligji. Por, jo të krijojmë një infrastrukturë ligjore, një ligj të tillë, përmes të cilit më shumë do të pësojnë të pafajshmit, se fajtorët. Kjo është ajo që kam thënë edhe në komision. Të jeni të bindur se edhe po qe se kalon një ligj i tillë, më

shumë do të pësojnë njerëzit të cilët mund të përfshihen në mënyrë të pafajshme në proces se sa ata, që shpeshherë aludohet, se kanë pallate, sepse ata që kanë pallate do të gjejnë rrugë që edhe këtij sistemi t'i bishtërojnë. Ata që kanë milionë, siç thoni ju, do të gjejnë rrugë dhe metoda që, edhe këtij sistemi, edhe një procesi të tillë, t'i bishtërojnë. Le të ndërtojmë diçka të besueshme, diçka që nuk do të rrezikojmë vlerat fundamentale të demokracisë si kulturë, si mënyrë jetese, si sistem vlerash dhe jo vetëm demokracisë si procedurë. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, a po e merr një minutë fjalën, mos të lë pa... një minutë atëherë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit! Po, unë edhe s'e kam ndërmend të flas më shumë. Çështja është për këtë ligj, nuk ka kurrgjë tjetër. Ne po i ikim debatit për çështjet thelbësore duke sulmuar njëri-tjetrin për çështje morale edhe mua hiç s'po më bie ndërmend ajo.

Dy çështje desha t'i sqaroj. Megjithatë, sipas këtij kuptimi ne i kemi dy çështje. Sot s'jemi duke diskutuar ligjin e Vetëvendosjes, por ligji i Vetëvendosjes synon objektin, pasurinë. Ligji që ka sjellë Qeveria synon personin. Ky është dallimi thelbor, një. E dyta, për zotin ministër. Zoti ministër, ti ke qenë këshilltar i ish-kryeministrit. Unë nuk e di a ke luftuar për rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, por unë e di që Lëvizja Vetëvendosje prej vitit 2011 ka kërkuar vazhdimisht rritjen e numrit dhe forcimin e gjyqësorit edhe këtu kur kemi luftuar për rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë. Unë edhe sot mendoj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Po vazhdojmë. Dy deputetë i kemi për diskutim. Emilija Rexhepi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe i fundit është Rexhep Selimi nga Lëvizja Vetëvendosje.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedniče!

Poštovane kolege poslanici,

Poštovani građani Republike Kosova,

Pre svega kao poslanik koji sam u ovom Parlamentu više od 10 godina, prosto je neverovatno da slušam pojedine poslanike u ovoj sali više od 5 sata o njihovoj individualnoj imovini, jer me apsolutno ne interesuje. Svi mi smo u obavezi da podržimo ovaj Zakon i svi mi ovde govorimo u ovom Parlamentu svakodnevno, na svakoj seansi, o anti korupciji, o korupciji, o suzbijanju kriminala a prosto rečeno ništa ne radimo.

Ja želim da kažem čisto individualno sa moje strane da sam poslanik koji živi od jedne mesečne plate. Ima takvih u ovom Parlamentu i bitno je da naši građani čuju da na kosovskoj političkoj sceni imate i čistih političara i želim da dam jedan pozitivan primer našim građanima, da je i

politika posao častan i pošten ako želiš da ga radiš na pravi način, ali takođe i kada vidim šta naša Agencija za anti korupciju, odnosno izveštaj koji od pojedinih poslanika dolazi a mi svi zajedno imamo istu baznu mesečnu platu nezavisno od nekih koji primaju možda 200 ili 300 evra više, u zavisnosti od komisija, prosto ja sama ne mogu da verujem kako neko od vas može biti milioner, na koji način gospodi ste došli do tog novca?

To isto važi za predstavnike Vlade, ne samo u ovoj Vladi nego i u prethodnoj i u onoj prethodnoj. Znači poreklo imovine je jako bitno da se publicira, da se zna, da se zna da svi građani Kosova znaju na koji način je taj novac, te osobe javno prezentiran u Agenciji za anti korupciju. Neka ta individua snosi odgovornost zbog toga a mi ne možemo snositi svi kolektivno odgovornost zašto je takvo stanje u našoj državi zbog pojedinih osoba. Jako je važno da podržimo predlog gospodina ministra pravde, Abeljarda Tahirija, zato što želi da institucionalno, zakonski reguliše sve ovo, a mi smo u obavezi da svi zajedno nezavisno političkih partija, nezavisno nacionalnih zajednica damo svoj doprinos, i da do drugog čitanja zakona izvršimo sve sugestije koje imamo, ili ukoliko neki član nije adekvatan da se to ispravi. Tako da ovaj zakon podržavam u potpunosti, i svi moramo snositi odgovornost ako nemamo regulisan zakon o stečenu imovine. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti i fundit, Rexhep Selimi, nga Lëvizja Vetëvendosje e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Nuk mbeta qëllimshëm i fundit, por kështu më rastisi, sido që të jetë, dua të jap mendimin dhe fjalën time, tashmë në këto orë të debatit u vërejt një lloj rezistence nga ana e Qeverisë, përfaqësuesve të Qeverisë që janë këtu dhe të mazhorancës që të ketë verifikim, respektivisht edhe konfiskim të pasurisë edhe kur nuk ka vepër paraprake penale, me sa e kuptoj me ato njohuritë e pakta të mia juridike, zoti ministër.

Pra, ajo çfarë u duk këtu është që ka një rezistencë që të mos pranohet edhe versioni që të ketë verifikim të pasurisë edhe pa vepër penale paraprake, sepse nëse do të rezultonte e kundërta, atëherë shkaktimi i veprës penale mund të ishte vetë e kundërta e asaj çka do të duhej të justifikohet. Pra, çka po kërkojmë ne? Ne po kërkojmë të shkojmë edhe një hap përtej kësaj, pra të ketë edhe konfiskim të pasurisë, kur ajo është përfituar me vepër penale, edhe të ketë verifikim pa vepër penale paraprake, nëse jam i saktë. Këtë unë e vërejta sot këtu. Por, ajo çka unë duhet të theksoj tash, ndoshta si i fundit në deklaram, është një qëndrim drejtuar kryetarit të Kuvendit. Disa herë, kryetar, keni deklaruar, ashtu siç edhe sot, që keni qëllim vetingun. Është hera, ndoshta jo e vetme, por nga herët e pakta që unë pajtohem plotësisht me ju. Pra, keni përmendur që duhet të shkojmë deri te vetingu, të jesh i sigurt që përkrahësin më të madh për të shkuar te vetingu do më kesh mua, edhe grupin tonë parlamentar, por nise. Nise, sepse jo veç ta deklarosh, por nise dhe do ta kesh mbështetjen time. Madje jo vetëm mbështetjen time, do ta kesh edhe

kontributin tim që këtij procesi të vetingut t'i shtojmë akoma më shumë kritere. Pra, nëse vërtet e ke ndërmend vetingun, atëherë nga pozicioni i kryetarit nise, do të na kesh mbrapa, do më kesh mua mbrapa, sepse mendoj se përmendja e vetingut nuk duhet të jetë vetëm retorikë, duhet të jetë edhe në veprime konkrete.

Na trego kur do të fillosh veprimet konkrete dhe ne do të japim përgjigjen tonë.

KRYETARI: Faleminderit! E falënderoj së pari për qëndrimin. Është e vërtetë, në fillim më duket, pastaj kam qenë në këtë sallë, Rexhep, kam treguar se po na këshillojnë të ndalemi edhe pak që të mos krijohen disbalanca, të cilat janë probleme, të cilat s'kishin lidhje fort as me pozitë, as me opozitë, por nga vjeshta, po më pëlqen kjo çfarë e the, do ta fillojmë të gjithë bashkërisht, pavarësisht reageimeve, për arsye se duhet të ndodhë. Duhet të ndodhë, kemi obligim ndaj qytetarëve, vetë fakti, Milaimi e teproi sot me fjalë, por një pjesë, se ka deputetë që janë këtu aktualisht dhe në të njëjtën kohë, i njëjti gjyqtar i ka dënuar, është e vërtetë.

Pastaj, edhe gjëra të tjera, fillojmë nga vjeshta, bëhemi bashkë, ulemi bashkë, s'e lëmë vetëm deklarative, në fund të fundit e kemi obligim si shtet i pavarur sovran. Urdhëro, prapë Rexhep Selimi!

REXHEP SELIMI: Kjo dëshmon edhe një herë që edhe nga pozicioni i opozitës, ku ne kemi vërejtjet tona dhe i kemi bërë të ditura deri te kapja e sistemit të drejtësisë, prapë ne si Lëvizje Vetëvendosje s'kemi çka të fshehim, ne duam që menjëherë të fillojë kjo, edhe kur ju në këtë rast jeni në pushtet, sepse nëse nuk do të ndodhë tash, do të ndodhë në ndonjë legjislaturë tjetër. Prandaj, ne s'kemi çka fshehim, niseni vetingun dhe mos e përmendi shumë si lloj kërcënimi, por le të jetë hap juaji konkret, sepse nganjëherë edhe tingëllon sikur po kërcënoni dikë me vetingun, niseni, na ke mbrapa.

KRYETARI: Faleminderit! Ajo nuk është, dhe as nuk duhet të ndodhë, urdhëro ministër. Jo nuk ka, ministër, është mirë ta përmbyllësh.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë

Ju falënderoj për zemërsisht për debatin, mendoj që edhe gjatë këtij debati kanë gjeneruar ide dhe besoj që do të plotësohet edhe në leximin e dytë. Ajo që e ngriti deputeti në fund, çështjen e vetingut, unë po të siguroj që tashmë ka filluar një proces i tillë, domethënë është në kuadër të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, do të kemi edhe ekspertë britanikë të angazhuar në këtë proces dhe para se të procedoj ligjet, të cilat duhet të miratohen në Kuvend për të ndodhë një proces i tillë, unë paraprakisht do ta koordinoj këtë proces me ju dhe besoj që do të dakordohemi bashkarish për mënyrën se si do të ndodhë ky proces.

Pra, unë këto projektligje do t'i diskutoj me ju para se të vijë për shqyrtim, pastaj do t'i sjell për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës. Tashmë ka filluar si proces në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, pra verifikimi i gjyqtarëve, prokurorëve, pastaj do të bisedojmë besoj edhe për policinë, ky është një proces që ka filluar.

Unë ju falënderoj përzemërsisht, ju ftoj që ta votoni projektligjin. Është një projektligj që vërtet synon konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale ose në mënyrë të paligjshme, unë besoj që do të pamundësojë çfarëdo pasurie që është fituar në këto vite që në të ardhmen të përvetësohet nga ata individë të papërgjegjshëm, pra ky është edhe synimi i këtij projektligji që t'i dënojë këta që kanë përfituar këtë pasuri dhe të pamundësojë përfitimin e pasurisë vitet e ardhshme, legalizimin e tyre që kudo mund të jetë ajo pasuri, qoftë në Kosovë, qoftë jashtë vendit. Ju falënderoj përzemërsisht, jam i gatshëm të diskutoj edhe gjatë kohës në leximin e dytë me komisione, t'i marr komentet tuaja, mirëpo ajo që është e rëndësishme, të ruhet struktura e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë,
Për këtë pikë të rendit të ditës debati ka përfunduar, është dashur të kemi deklaram në votim për miratimin në parim të projektligjit. Ka mungesë të deputetëve, nuk mund ta votojmë. Do të shkojmë tani një pauzë një orë, vetëm a ka mundësi ta them këtë njoftimin apo dëshiron para se ta jap njoftimin? Urdhëro, zonja Pacolli!

FITORE PACOLLI-DALIPI: Kryetar, pasi që ne po e shohim që nuk ka deputetë, edhe nëse shkojmë në pauzë, nuk do të vijë shumica, do të ishte mirë që projektligjet, të cilat janë në radhë të diskutohen kur të kemi deputetë më shumë. Prandaj, ne propozojmë që kjo mbledhje të ndërpritet këtu dhe të vazhdojmë të hënën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është një propozim, po e marr si të mirëqenë prej grupit parlamentar, por sido që të jetë, këta deputetë, unë do të qëndroj korrekt, nëse duan të vazhdojnë debatet, edhe një herë po e përsëris, ndoshta nuk do të jetë e tepërt. Në Parlamentin gjerman me mbi 700 deputetë, janë 15-20 vetë, ata të cilët janë të interesuar rrinë për debat, ata që s'kanë interes, nuk ke çfarë t'i bësh. Procedura e votimit është e rregulluar me Rregullore dhe do ta respektoj, por sido që të jetë, vendimmarrja është juaja.

Zonja Pacolli e pati një propozim, të jemi konkretë. Memli Krasniqi nga PDK-ja, cili është qëndrimi?

MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryetar!

Ne jemi të mendimit që do të ishte shumë mirë t'i kryejmë pikat e seancës plenare të parapara për sot. Janë disa ligje shumë të rëndësishme, veçanërisht pika e katërt që është Projektligji për

mbrojtjen e sinjalizuesve, është një nga projektligjet që besoj jemi të vonuar edhe në shqyrtimin edhe në miratimin e tij, veçanërisht së paku në miratimin në parim.

Pavarësisht kësaj situatë, të cilën e kemi përballë, është situatë reale e Kuvendit të Kosovës. Sot tri grupe parlamentare mungojnë totalisht, për momentin. Edhe këto grupe që jemi, nuk jemi as gjysma. Asnjë ditë që kemi caktuar seancë të premtën nuk kemi qenë as afërsisht efikas, është papërgjegjësi e deputetëve pa dallim që nuk i kryejnë detyrat e veta, por po më duket vikendet e gjata i kanë prioritet më të madh se sa miratimin e projektligjeve për çka jemi zgjedhur. Është fatkeqësi që është duke na përcjellë gjatë gjithë këtij viti dhe e shfrytëzoj prapë situatën të kërkoj që në Rregulloren e re të gjejmë forma të sanksionimit të këtyre sjelljeve të papërgjegjshme, sepse realisht këtu po cungohet e drejta e secilit prej neve që vijmë dhe rrimë prej fillimit deri në fund, edhe e qytetarëve që na kanë zgjedhur për t'i kryer këto punë për çka jemi të thirrur.

Unë mendoj që s'mund ta caktojmë datën ose vazhdimin sot, të themi të hënën ose të martën, ne s'kemi shumicë, as të votojmë kurrëgjë për momentin. Mendoj që do të ishte mirë nëse ju e thirrni të hënën qysh në mëngjes një mbledhje të Kryesisë dhe ta vendosim në mbledhje të Kryesisë vazhdimin edhe të kësaj seance, edhe të pikave të papërfunduara prej seancave të kaluara. Realisht ne kemi pika të papërfunduara prej seancave të 8, 14, 19, 28 qershorit, 5, 6, 9 korrikut, të djeshmen dhe të sotmen. Unë mendoj që ne e kemi tepër të rëndësishme gjatë javës së ardhshme, deri në fund të javës së ardhshme, deri të enjten se prapë të premtën ikin në vikende të gjata deputetë, se është nxehur koha, Shqipëria afër, i kemi shtruar autostradat, për dy orë e gjysmë po shkojnë në plazh. Neve na duhet deri të enjten t'i përfundojmë, ky është mendimi ynë si grup parlamentar, por besoj që do të ishte mirë të hënën si Kryesi, bashkë edhe me përfaqësuesit e grupeve, të merremi vesh për një agjendë ndoshta të martën, të mërkurën, të enjten edhe t'i përfundojmë këto çështje. Përndryshe, e dëgjova kolegen që e përmendi të hënën, por unë nuk jam që ta vendosim sot këtu nja 25-30 sa kemi mbetur, por të vendosim në Kryesi. Faleminderit!

KRYETARI: Cili ke qëndrimi? Sa i përket zonjës deputete, tash mora njoftim ajo është e njoftuar se të hënën Grupi i Grave Deputete s'qenka në seancë, të hënën nuk mundemi, po urdhëro, zonja Pacolli.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Unë nuk po caktoj datë ose ditë kur, veç po kërkoj që projektligjet, të cilat janë në radhë, të diskutohen në një mbledhje kur kemi më shumë deputetë të pranishëm, sepse duhet t'i diskutojmë në hollësi dhe të kalojmë projektligje të mira, të cilat në të ardhmen i shërbejnë këtij vendi dhe të mos ngutemi në këtë mënyrë, sepse nuk kemi deputetë të mjaftueshëm për të diskutuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauku, s'qenka në sallë, pasi s'është, po në mënyrë filozofike na kishte treguar, po flas me seriozitet, është kualiteti, kot ke masivitet, ata të cilët duan, flasin.

Memli e tha, vetëm pak. Herën e kaluar ju e dini kemi pritur gjysmë ore, pastaj kemi dalë në Kryesi vetëm t' i thërrasim, t' i sensibilizojmë të jenë prezentë deputetët në sallë, kot i thërrasim edhe të hënën. Por, ne mund të vazhdojmë seancën sot, ose ta ndërprisni këta që jeni, kjo është qëndrimi, kryetari i Grupit Parlamentar s' më dha qëndrim: a ta vazhdojmë a ta ndërpremë?

Të shkojmë pastaj te AAK-ja, edhe te Nisma, 6+. Ta marr një qëndrim përafërsisht tuajin, cili është motivimi juaj aktual, të vazhdojmë apo doni ta ndërpremë, e pastaj e përcaktojmë një ditë tjetër? Zoti Krasniqi, veç qëndrimin ta kemi, e kam një qëndrim, Vetëvendosja thotë ta ndërpremë tani dhe vazhdojmë një ditë tjetër, pastaj flasim për atë pjesën një ditë tjetër kur. Zoti Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar! Unë me mendjen time goxha i qartë kesh, por pasi po doni qartësim, po, po duam të vazhdojmë.

KRYETARI: Jo ajo mbledhja e të hënës ma pështolli, zoti Isufi nga AAK-ja, një qëndrim po, një jo, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Ne i kemi edhe tri projektligje në lexim të parë, mund të shpenzohen me debat këtu, por të mos dalim prej temës, siç ndodhi me ligjin paraprak. Le të fokusohen në projektligj, le t' i cekin nenet, le të jenë konkretë. Shumë shpejt mund ta kryejmë këtë punë, të tjerat janë në lexim të dytë, s' kemi kuorum, mund të vazhdojmë pastaj në javën tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sherifi, qëndrimi i Nismës.

BILALL SHERIFI: Kryetar!

Mendoj që deri në orën 17:30 së paku mund të punojmë, sot nuk do të mund t' i përfundojmë të gjitha pikat, dhe t' i lëmë pastaj për javën e ardhshme. Unë nuk mendoj që tash duhet të ndërpritet, por duhet të vazhdojmë së paku një orë pushim dreke dhe të vazhdojmë deri në orën 17:00-17:30.

KRYETARI: Ka disa prej deputetëve kanë qenë korrektë, prej orës 10:00 janë këtu, as s' kanë ngrënë bukë, unë s' mbaj përgjegjësi për këtë pjesë. Zoti Kinolli, 6+, megjithëse janë bërë 3 me 1, por edhe 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe ne jemi të pajtimit, jemi këtu prezentë prej orës 10:00, të shkojmë me një pauzë sado të shkurtër, se ka deputetë që kanë lëvizur dhe ka deputetë që prej orës 10:00 janë këtu, mirë kishte qenë të shkojmë me një pauzë dhe pas pauzës të vazhdojmë me këto tri projektligjet, të cilat janë në lexim të parë dhe pastaj, nëse s' ka kuorum në këto pikat e tjera që janë në shqyrtim të dytë, vazhdojmë ndonjë ditë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qëndrimi është juaji, në orën 15:00 vazhdojmë seancën. Urdhëro, Rexhep Selimi e keni fjalën!

REXHEP SELIMI: Unë veç po dua të bëj një konstatim që kur kërkoi kolegja jonë deputete për të qenë më efektive, ne po duhet të bëjmë konstatim se vetëm gjashtë deputetë na mungojnë. Pra, le të dihet se ku është përgjegjësia e deputetëve, vetëm si konstatim desha të them që ne grupi ynë parlamentar jemi këtu, vazhdojmë qysh doni.

KRYETARI: Atëherë, vetëm pak, a është shkurt deri në orën 15:00, unë për shkak jush e thashë, a po doni deri në 15:30? Atëherë, në orën 15:15 e vazhdojmë seancën. Do të vazhdojmë deri te leximi i dytë, kini parasysh, i kemi edhe tri projektligje në lexim të parë. Faleminderit për mirëkuptim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin.

Zoti Tahiri, e keni fjalën!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Nuk dëshiroj të flas shumë për historikun e zbatimit të ligjit aktual, por dëshiroj t' ju njoftoj me përmbajtjen e Projektligjit të ri për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Ka pasur gjithsej katër debate të mëdha që i kemi adresuar brenda këtij projektligji që sot është për shqyrtim para jush. E para, definimi se kush është sinjalizues. E dyta, a është çështje etike sinjalizimi. E treta, si duhet të bëhet sinjalizimi. Dhe, e katërta çfarë përgjegjësie kanë institucionet tona për të ofruar mbrojtjen e nevojshme nga cenimet që mund t'u bëhen sinjalizuesve për shkak të sinjalizimit të tyre. Mbi këtë bazë projektligji ka adresuar si në vijim: është njohur sinjalizimi si mjet në përpjekjet tona në luftë kundër keqpërdorimit, korrupsionit dhe abuzimit me autorizimet publike. Është vendosur mbrojtja e interesit publik si objektiv që legjitimon sinjalizimin, është definuar sinjalizimi për kategori, për të cilat vlen si veprim që kanë të bëjnë me elementet si në vijim: mospërbushjen e detyrimeve ligjore, keqadministrimin e drejtësisë, rrezikimin e shëndetit dhe sigurisë së vendit, dëmtimin e mjedisit, keqpërdorimin e parasë publike, si dhe veprime diskriminuese në emër të institucionit, pra edhe disa të tjera që besoj do të keni mundësi t'i shihni në projektligj.

Risi të tjera të rëndësishme janë edhe këto si në vijim: është përfshirë sektori publik dhe ai privat, është mundësuar sinjalizimi i brendshëm, i jashtëm dhe ai publik. Sinjalizimi i brendshëm për sektorin publik nënkupton raportimin të hierarkia institucionale në shkallë të parë, ndërsa të Agjencia Kundër Korrupsionit në shkallën e dytë, në rast se nuk ka trajtim rasti në fjalë, pra në shkallën e parë. Ndërsa, për sektorin privat shkalla e parë është menaxhmenti i kompanive dhe i bizneseve, ndërsa si shkallë e dytë është përcaktuar të jetë secili prej organeve rregullative të fushës përkatëse, në këtë rast që mund të jenë odat ekonomike, Inspektorati i punës, e tjera.

Natyrisht se i kemi kushtuar rëndësi që sinjalizimi të mos keqpërdoret ndaj askujt dhe t'i shërbejë ekskluzivisht parandalimit dhe raportimit të abuzimeve që ndërliken me vendin e punës, pra në kontest të marrëdhënies së punës. Sa i përket mbrojtjes, projektligji parasheh mbrojtjen e sinjalizuesve nga veprimet e dëmshme, siç janë: shkarkimi nga puna, pezullimi nga puna, transformimi në detyra të tjera pa pëlqimin e personit në fjalë, uljen në pozitë, zvogëlimin e pagës, degradimin profesional dhe çdo veprim tjetër të dëmshëm që lidhet me marrëdhënien e punës së sinjalizuesit. Çdo sinjalizues që i bëhet e padrejtë në njërin nga këto pika, ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore dhe kompensim të dëmit që i është shkaktuar si shkak i sinjalizimit që ka bërë. Pra, projektligji parasheh që secili institucion publik me 30 të punësuar është i detyruar ta caktojë një person përgjegjës për sinjalizim, ndërsa në sektorin privat çdo kompani që ka mbi 50 punëtorë.

Në rast se institucioni nuk ua bën të njohur me shkrim dispozitat e këtij ligji punëtorëve, si dhe rastet që dështojnë të përmbushin obligimet e tyre ndaj sinjalizuesve, projektligji ka paraparë dënime prej 500 deri në 20 mijë euro. Meqenëse, e kemi përfshirë edhe sektorin privat dhe me qëllim që të përgatisim një fushatë vetëdijesuese që t'u ndihmojmë paraprakisht bizneset për zbatimin e këtij ligji, që i njëjti në sektorin publik të hyjë në fuqi tani pas miratimit të tij, ndërsa për sektorin privat do të jetë një vit pas miratimit të këtij projektligji.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj në kuptimin përmbajtjesor plotëson formalisht të gjitha standardet e Bashkimit Evropian. Është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, si dhe paraqet draftin e konsoliduar që është jashtëzakonisht i avancuar jo vetëm në nivel rajoni, por në nivel të Bashkimit Evropian. Ndërsa, në kuptim të vendosmërisë sonë politike dhe institucione ky projektligj sjell në një dimension të ri përkushtimin e institucioneve për të siguruar integritetin dhe përgjegjësinë e tyre. Po ashtu, sjell një dimension të ri për të siguruar shërbime të mirëfillta të institucioneve ndaj qytetarëve, si dhe dërgon një mesazh unik se ata që janë punëtorë dhe që duan Republikën e mirëfilltë duhet të jenë lojalë ndaj ideve mbi të cilat është themeluar kjo Republikë, e jo ndaj atyre që ushtrojnë autorizime publike.

Prandaj, të nderuar deputetë, miratimi i këtij projektligji është shprehje e vullnetit tonë të përbashkët dhe pa përjashtim që t'i japim një shans akoma më të madh mbrojtjes së interesit publik dhe sigurisë së integritetit të institucioneve tona. Ju ftoj që ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Albulena s'është. Hajdar Beqa e ka fjalën në emër të komisionit.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion para shqyrtimit të parë të Projektligjit për mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi më 10.07.2018 Projektligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë për miratim në lexim të parë.

Vlen të theksohet se të gjithë anëtarët që janë në komision, nga të gjitha subjektet politike, e kanë përkrahur në komision, do të thotë është një ndër ligjet e vetme, e dimë që është ligj i rëndësishëm si të gjitha ligjet që kanë ardhur në formë të drejtësisë, por te ky ligj kemi pasur një unitet nga të gjitha forcat politike dhe të gjithë e kemi përkrahur në komision dhe jemi zotuar që do ta përkrahin forcat tona politike në seancë plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqa! Radha është e kryetarëve, respektivisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është kurrkush këtu. Grupi Parlamentar i PDK-së, kush do të flasë në emër të grupit? Zoti Hajdar Beqa apo dikush tjetër? Zoti Beqa!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, i nderuar zoti Haliti!

Në dispozitat e këtij projektligji është bërë harmonizimi i plotë me standardet evropiane që rregullojnë këtë fushë dhe legjislacionin përkatës në fuqi që ndërlidhet në këtë fushë. Me theks të veçantë me dispozitat e këtij projektligji përcaktohet një varg risish, të cilat i përmendi edhe ministri, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar ligjin në parim, kontributin e vet do ta japë mes dy leximeve përmes amendamenteve. Unë do t'i përmend disa nga risitë e këtij ligji që i rregullon:

1. Mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat,
2. Nocioni i gjerë i të punësuarit që përfshin lloje të ndryshme marrëdhëniesh në punë,
3. Përcaktimi i raportimit dhe shpalosja në interes publik të mbrojtur,
4. Përcaktimi i procedurave të posaçme për të punësuarit, të cilët bëjnë sinjalizimin për shkeljen në institucionet në të cilën punojnë,
5. Përcaktimi i rregullave për mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesve dhe personave të lidhur me sinjalizuesit,
6. Qasja trishkallëshe për sinjalizimin: sinjalizimi i brendshëm, sinjalizimi i jashtëm dhe sinjalizimi publik.
7. E drejta e sinjalizuesit, i cili ka pësuar nga veprimet e dëmshme në lidhje me sinjalizimin në mbrojtjen gjyqësore,
8. Përcaktimi i masave ndëshkimore për punëdhënësit që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj.

Andaj, ju ftoj që të përkrahni dhe në mes të dy leximeve të bëjmë disa intervenime. Për shembull, atë që ka vërejtur Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike te neni 5, ndoshta afati që parashihet në këtë nen duhet të hiqet. Afati sipas nenit që është rregulluar tash për paraqitje të shkeljeve është një vit nga data kur ndodh shkelja, andaj duhet të shikojmë që ndoshta te neni 5 duhet të hiqet krejt pjesa e afateve. Unë edhe një herë e përgëzoj ministrinë për një punë që e ka bërë në reformë të drejtësisë, në veçanti me ligjin përkatës që jemi duke diskutuar dhe i ftoj deputetët që në këtë fazë ta përkrahin, kurse mes dy leximeve ta japim kontributin.

Komisioni për Legjislacion me kohë do ta bëjë grupin punues dhe do të kyçen të gjithë aktorët që duan të japin kontribut në këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, zoti Sami Kurteshi është paraqitur.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka analizuar këtë projektligj, që në fillim dua ta theksoj se ky ligj është i pranueshëm për Lëvizjen Vetëvendosje në parim.

Ne besojmë se në leximin e dytë me ndryshimet dhe amendamentet që mund t'i dorëzojmë, që mund t'i kemi në këtë ligj, bëhet një ligj i mirë, është në përputhje me direktivën e Këshillit të Evropës, në të vërtetë është diçka që nuk duhet të kemi frikë edhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sepse janë përfshirë këtu. Fillimisht, unë dua ta theksoj edhe faktin domethënë që ky ligj dallon shumë nga ligji që është në fuqi, është më i avancuar, domethënë Ligji për informatorët, i cili në njëfarë mënyre ka pasur edhe një konotacion negativ te ne për 'mizevirët' e spiunët, ashtu në mentalitetin e përgjithshëm që ka qenë i përhapur. Kjo ngarkesë morale me këtë ligj hiqet dhe bartet në aspektin ligjor dhe nuk personalizohet.

Në të vërtetë për, shkak të emërimit të gabueshëm edhe ka qenë pak problematik ai ligj, megjithatë ne kemi vërejtjet tona që sigurisht do t'i sjellim në leximin e dytë. Unë po shpresoj, ministri e tha këtu, kemi dënimet prej 30 deri në 20 mijë euro, ishte një gabim me gjasë gjuhësor, janë 2 mijë euro me gjasë, së paku në tekst janë 2 mijë euro, por nuk është me rëndësi, me rëndësi është domethënë se ajo pjesa 30 euro edhe 2 mijë euro, mandej ndoshta nuk ka një përputhje, por minimumi duhet të rritet, e nëse është 20 mijë euro ndoshta e shohim pastaj diskutojmë se ka të bëjë me krejt njerëzit.

Një çështje tjetër që duhet të theksohet është në të vërtetë edhe specifikimi i disa shkeljeve. Ne kemi këtu në nenin 2, unë e kam edhe Konventën e Këshillit të Evropës dhe duhet të nxirret jo vetëm në sektorin publik dhe privat, por duhet të futen edhe njerëzit që punojnë në ato, qofshin edhe praktikantë me të holla ose pa të holla. Është në ligj, por nuk është cekur domethënë, se mandej vihet në pikëpyetje gjendja e tyre ligjore.

Së dyti, autoriteti kryesor kompetent për zbatimin e këtij ligji është Agjencia Kundër Korrupsionit. Sipas informacioneve, AKK-së planifikohet t'i shtohen kompetenca shtesë, përfshirë edhe parandalimin e korrupsionit përmes projektligjeve, siç njihet ajo "corruption proofing". Por, në anën tjetër nuk kemi parë asnjë shtim të kapaciteteve profesionale dhe njerëzore të AKK-së edhe me buxhet, domethënë buxheti u ka mbetur i njëjtë. Së treti, në të kaluarën jo të largët ne kemi pasur disa raste kur pikërisht ata që kanë raportuar veprimet e kundërligjshme, sidomos në institucionet publike, janë larguar nga puna. Shumë të freskët e kemi rastin domethënë e largimit të Murat Mehmetit nga AKI-ja për shkak të raportimit të shkeljeve të shumta ose, për shembull, Arben Zejnullahu për denoncimin e diplomimit rekord të kushëririt të një ish-ministri, fatkeqësisht ka qenë i PDK-së.

Andaj, për të parandaluar këto ne mendojmë se në draftin e Kodit Penal do të duhej të bëhej një amendamentim i nenit 388 të Kodit Penal në paragrafin 1, t'i shtohet edhe një paragraf i ri që ne do ta propozojmë, edhe ai thotë: "Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person me qëllim të hakmarrjes për shkak të raportimit ose shpalosjes së informacionit për veprime dhe mosveprime që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet për pozita të larta".

Së katërti, tek neni 29 flitet për raportet vjetore që duhet t'u dorëzohen Agjencisë Antikorrupsion, institucioneve të ndryshme, apo ndërmarrjeve të ndryshme. Ajo është shumë në rregull, meqenëse nuk ka një rregullim çka bën me atë raport Agjencia Kundër Korrupsionit. Një propozim që do të duhej të vinte gjithsesi është domethënë që Agjencia Antikorrupsion, meqenëse është në kuadër të mandatit të Komisionit për Legjislacion, që këto raporte t'ia ofrojë Komisionit për Legjislacion, natyrisht ato të trajtohen në mënyrën më të mirë. Këtu kemi edhe inkurajimin e të gjithë punëtorëve, si në sektorin publik, edhe atë privat, që të lajmërojnë domethënë veprat e kundërligjshme për veprimet e ndryshme që sigurisht më vonë do të specifikohen pa frikë se do të ketë hakmarrje ndaj tyre. Ne edhe një herë u bëjmë ftesë të gjithë të punësuarve, qofshin ata në ndërmarrjet publike apo private, numri i të cilëve ndoshta duhet të diskutohet edhe gjatë amendamentimit të ndryshohet me minimumin e punëtorëve, meqenëse e dimë se në Kosovë shumë numër i madh i ndërmarrjeve nuk e arrijnë fare numrin 30 ose institucionet publike ndoshta nuk e arrijnë numrin 50, që për këta numra të diskutohet, të shihet gjendja reale dhe kjo të paraqitet.

Një çështje tjetër që do të duhej të spikatej gjithsesi është në të vërtetë forcimi i Agjencisë Kundër Korrupsion, në mënyrë që rekomandimet e Agjencisë të mos jenë vetëm të karakterit normativ, moral, por të kenë edhe karakter zbatues. Unë pres që të gjithë deputetët dhe deputetët kolege ta japin kontributin e tyre, sepse është i domosdoshëm. Parimisht, po e them Ligji për sinjalizuesit në të vërtetë prek në thelb edhe ligjin për të cilin diskutuam pak më parë, veprimi i personave që lajmërojnë veprimet e kundërligjshme në kuadër të këtyre është edhe krijimi i pasurisë së pajustificueshme. Ky megjithatë ka deklaruar edhe ministri, edhe ne e dimë se është një pako ligjore për rregullimin e sferës së sistemit të drejtësisë. këto ligje duhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën, të mos kenë shprehje absolute mes tyre, prandaj në këtë drejtim duhet të shihet parimi i këtij ligji dhe parimi i ligjit për të cilin diskutuam më parë. Kishte diskutime të flakta, ndoshta edhe teprime, por ato diskutime neve na mungojnë, sepse në fund të fundit ligjet janë për ne edhe veç ne duhet t'i zbatojmë, kurrkush tjetër.

Prandaj, edhe një herë Lëvizja Vetëvendosje do ta japë kontributin e vetë midis dy leximeve, por në parim pajtohet me Ligjin për sinjalizuesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën në emër të AAK-së.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Po, është e vërtetë se jemi pajtuar të gjithë anëtarët e komisionit për përkrahjen në parim të projektligjit të ardhjes në Kuvend. Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah Projektligjin për sinjalizuesit, nuk dua të diskutoj më gjatë, për shkak se kolegët s'dua t'i përsëris, sepse nuk mund të dalim nga ky brumë, por personalisht nëse kolegët nga Komisioni për Legjislacion më japin atë të drejtë, është dëshirë imja që nga Grupi Parlamentar të jem kryetar i këtij grupi punues

lidhur me projektligj gjatë amendamentimit ndërmjet dy leximeve dhe ta sjellim të amandamentuar në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Nisma, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë mund të konfirmoj atë që e thanë kolegët se në Komision për Legjislacion të gjithë kemi rënë dakord që parimi mbi të cilin është ndërtuar ky ligj është i duhuri dhe kemi rënë dakord të gjithë së bashku që të punojmë në këtë ligj derisa ta përfundojmë dhe të vijë në lexim të parë, të dytë dhe të hyjë në fuqi.

Ne në kuadër të punës që do të bëjmë nga sot, por edhe nga koha kur e kemi bërë në komision, do të japim rekomandimet, sugjerimet tona, në mënyrë që ky ligj të plotësohet, të bëhet ashtu siç të gjithë e dëshirojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Faleminderit!

Para se të hyjmë në pika të caktuara se ku do të duhej të ndryshohej ky projektligj, unë pajtohem edhe me deputetët e tjerë se është një ligj i rëndësishëm dhe me ndryshimet që duhet të pësojë, pra duhet të votohet dhe të kalojë. Është interesant se ministri i Drejtësisë e ka sjellë këtë ligj në Kuvend dhe kërkon nga ne që ta kalojmë. Ne do të votojmë, por është një kërkesë ose, si të thuhet, disa kritika, disa vërejtje që ministri ua ka dërguar ekspertëve evropianë për raportin, të cilin folëm pak më herët dhe këto kritika dhe kërkesa që ua ka bërë ministri ekspertëve evropianë janë në kundërshtim të asaj se çfarë po promovojmë sot.

Raportin të cilin e kanë punuar ekspertët evropianë janë bazuar në intervista, pra kanë intervistuar zyrtarë, të cilët punojnë në institucionet e Republikës së Kosovës, pra në institucionet e drejtësisë dhe kur ministri dhe punëtorët e tij të ministrisë nuk janë pajtuar me të gjeturat e raportit, siç na ka shpjeguar ministri, ky është dokument që ministri na i ka dërguar në e-mail, ka thënë se i ka dërguar disa vërejtje dhe disa sqarime rreth raportit, a po? Dhe, këtu pyetjet janë të çuditshme, pra bie në kundërshtim me atë se çfarë po kërkojmë ne t'i mbrojmë sinjalizuesit, njerëzit dhe punëtorët të cilët deklarojnë dëmin publik që shkaktohet në çfarëdo forme. Pra, ministri kërkon nga ekspertët evropianë që të sqarohen se kush ishin përfaqësuesit vendorë që u intervistuan. Pra, thotë ky nuk është një studim integriteti dhe duhet të mos jetë anonim. Më tutje janë katër komente në atë dokument, thotë: "Raporti është rezultat i takimeve dhe intervistave me përfaqësuesit lokalë". Duhet të përmendim se kush janë ata vendorë, të cilët kanë ardhur me këto konkluzione. Pastaj, komenti tjetër vazhdon, thotë: "Për të pasur një pasqyrë gjithëpërfshirëse, duhet të dimë se kush janë të anketuarit, do të ishte e dobishme të përfshihej në listë një listë e të intervistuarve në fund të raportit".

Dhe, komenti i katër është nga metodologjia mund të shihet se ky raport ka ardhur përmes takimeve dhe intervistave me përfaqësues lokalë, ku nga metodologjia e përdorur është konstatuar se sistemi gjyqësor nuk është profesional, i politizuar dhe i korruptuar, por në raport nuk është theksuar se cilët ishin përfaqësuesit vendorë që kanë dhënë këtu deklaratat, pasi që mund të ketë perceptim të gabuar apo të ekzagjeruar. Pra, në fakt, t'u drejtohesh ekspertëve evropianë me këso kërkesa që ata të japin emrat e personave se kë kanë intervistuar, ministri me njëfarë mënyre u ka thënë: “Më jep emrat të di kush ka thënë se sistemi është i korruptuar dhe pastaj ne merremi me ta”. Pra, kjo bie në kundërshtim me këtë çka po diskutojmë sot me Ligjin e sinjalizuesve dhe është tepër shqetësuese. Punëtorët duhet të mbrohen varësisht prej nëse japin intervista edhe për institucione të Bashkimit Evropian, edhe për ekspertë të pavarur evropianë, të cilët vijnë këtu me një arsye që të analizojnë dhe studiojnë gjendjen.

Tash, të dal tek projektligji. Ministër, ose duhet të jeni të qartë në dokumentet, të cilat i sillni, të jeni të saktë. Këtu në nenin 27, te dispozitat për kundërvajtje thuhet se gjykata mund të shqiptojë gjobë, e cila nuk mund të jetë më pak se 30 euro dhe jo më shumë se 2 mijë euro. Ju kur e prezantuat thatë 30 deri në 20 mijë euro, ne nuk e dimë se cila është e saktë. Prandaj, kjo duhet të përmirësohet, nëse është 20 mijë. Dhe, këtu është vërejtja tjetër se nuk duhet të jetë as 20 mijë, duhet të mos përcaktohet fare vlera, sepse ne nuk e dimë se çfarë dëmi mund t'i shkaktohet një sinjalizuesi. Ligjin më të mirë që e kanë shtetet, pra shtetet të cilat kanë ligjet më të mira rreth sinjalizuesve është Britania e Madhe dhe nuk e ka të kufizuar shumën. Nëse doni si informatë shuma më e lartë që ka shkuar, që është dashur t'i kompensohet një sinjalizuesi ka qenë 5 milionë funte. Prandaj, nuk duhet të kufizohet, sepse ne, as gjykata nuk mund ta mendojë dëmin që mund t'i shkaktohet një sinjalizuesi kur ta japë informatën për ta denoncuar një krim që bëhet apo një dëmtim, qoftë i parasë publike, qoftë i institucionit publik.

Pra, kjo duhet të mos jetë e kufizuar dhe këto do t'i dërgoj me amendamente. Një gjë tjetër që duhet ndoshta ta marrin si diçka e mirë që nuk e përfshin Projektligji për sinjalizuesit, është se ligji që e ka Britania e Madhe që quhet “Akti i zbulimit i informimit të mbrojtjes së interesit publik”, i njohur si PIDA, pra përveçse definon institucionet private dhe ato publike, i definon edhe institucionet jofitimprurëse. Pra, nëse një organizatë joqeveritare përfiton para për projekte të caktuara nga Qeveria, mirëpo nëse keqpërdoren këto para, si mundet një punëtor i këtyre organizatave të denoncojë një krim. Pra, duhet të përfshihen edhe organizatat joqeveritare.

Pastaj, rregullat e reja, të cilat i ka propozuar Komisioni Evropian që të përfshihen në Ligjin për sinjalizuesin e bën edhe dallimin, pra përfshin edhe fushat se ku duhet të përqendrohemi. Ne mund të mos e kufizojmë, ta lëmë në të gjitha fushat, por edhe mund ta kufizojmë. Për shembull, nëse e marrim si shembull rregullat që i ka propozuar Komisioni Evropian, janë fushat si: prokurimi publik, shërbimet financiare, shpëlarjen e parave dhe financimin që shkon nëpërmjet veprave terroriste, siguria e produkteve, siguria e transportit, mbrojtja e ambientit, siguria nukleare, shëndeti publik, ushqimi, siguria e ushqimit, shëndeti i kafshëve, mirëqenia, mbrojtja e

konsumatorëve dhe të tjera. Pra, ne mund të vendosim se cilat janë të rëndësishme. Këtu e kemi një numër të fushave që edhe Bashkimi Evropian e implementon në direktivat dhe rregullat e saj.

Po ashtu, tek faqja 5 e këtij projektligji, pra ku sqarohen, pika 1.9 thuhet: “Subjekt privat – nënkupton personin juridik, privat, sipas Ligjit për shoqëri tregtare, Ligjit për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare”. Nuk e di prej kur quhet subjekt privat dhe hyn Ligji për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare. Prandaj, mendoj se kjo duhet të ridefinohet edhe një herë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Ah, po! Radha është te përfaqësuesit e Qeverisë. Zoti Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Ju falënderoj në parim për mbështetjen, të gjitha grupet parlamentare.

Padyshim që është një projektligj tepër i rëndësishëm dhe jo rastësisht kemi punuar në të dy projektligjet, edhe në Projektligjin për konfiskimin e pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme, edhe në këtë projektligj, në të njëjtën kohë. Ajo që është e rëndësishme është po ashtu, duhet të jemi në linjë të plotë me atë që jemi duke punuar tani për Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, meqenëse tashmë me këtë involvohet edhe Agjencia Kundër Korrupsionit.

Çështja më e ndjeshme këtu realisht kanë qenë kompanitë private, bizneset private, në mënyrë që të jemi shumë të kujdesshëm që edhe të mos i dëmtojmë kompanitë, bizneset private me këtë projektligj. Mendoj që e kemi trajtuar me kujdes jashtëzakonisht të madh, por megjithatë ne kemi parë dukuri negative kohëve të fundit që kanë ndodhur edhe nga kompani private, siç e kemi pasur rastin e mishit të prishur apo barnave të dala afati, të cilat janë nëpër depot e kompanive private dhe nuk janë sinjalizuar apo s’janë informuar nga askush. Mendoj që pikërisht pra duhet të kemi njerëz të tillë të ndërgjegjshëm edhe në kuadër të kompanive, bizneseve, që t’i sinjalizojnë edhe dukuritë e tilla negative, që ndodhin brenda bizneseve ku ata punojnë.

Sa i përket raporti të cilit po i referoheni vazhdimisht të atyre tre ekspertëve që për tri ditë e kanë bërë “namin” në Republikën e Kosovës, ne pikërisht ua kemi kërkuar na Komisioni Evropian që të jetë një delegacion, që të vizitojë Republikën e Kosovës nga BE-ja dhe të ballafaqojnë argumentet me Këshillin Gjyqësor, me Këshillin Prokurorial, me Ministrinë e Drejtësisë, me Zyrën e kryeprokurorit të shtetit, me Gjykatën Supreme dhe kjo, për t’ua bërë juve me dije, ka ndodhur para një muaji. Të gjitha këto çështje që janë trajtuar ne i kemi ofruar argumentet tona, që qëndrojnë ndryshe dhe ato i kemi me argumente, me fakte. Pra, para një muaji ne kemi pasur një vizitë nga një delegacion i Bashkimit Evropian, ku ka pasur takim edhe me mua si ministër i Drejtësisë, edhe me të gjitha institucionet që i përmenda, për ato që ne nuk jemi pajtuar me raportin e këtyre tre ekspertëve që tri ditë kanë qëndruar në Republikën e Kosovës.

Padyshim, pajtohemi plotësisht çka thotë Raporti i Progresit, si ai i para dy vitesh, sikur ky tani, dhe pikërisht pra po i adresojmë çështjet që dalin nga Raporti i Progresit dhe agjenda Evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, edhe kjo pikë e rendit të ditës është shteruar. Kuorumin e mjaftueshëm nuk e kemi... Jo, s'ka replikë. Fjala e fundit është e Qeverisë.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen e Kosovës

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj kryetaren e komisionit, respektivisht përfaqësuesin e komisionit, zotin Hajdar Beqaj, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Beqaj, e keni fjalën.

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryetar,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi, se projektligji i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye ia rekomandojmë Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

Nëse bën edhe në emër të partisë?

KRYESUESI: Po, bën edhe në emër të partisë.

HAJDAR BEQAJ: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike vlen të theksohet se kjo nismë për plotësim-ndryshim të Ligjit për plotësimin e Ligjit 2004/32 për familjen në Kosovë është nismë e Komisionit për Legjislacion. Të gjitha grupet parlamentare kanë mbështetur këtë nismë për plotësim-ndryshimin e ligjit. Ka një konsensus politik. Grupi Parlamentar i Partisë

Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe kontributin e vet do ta japë nëpërmjet amendamenteve në mes dy leximeve.

Andaj, kërkoj nga deputetët që ta përkrahin në këtë fazë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është këtu. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, cili e keni, Samiu a zonja Kollçaku. Zonja Kollçaku, urdhëro!

FATMIRE KOLLÇAKU: Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje e japim përkrahjen për këto ndryshime dhe veç e veç secili deputet do ta shprehë mendimin e vet. Unë kam marrë fjalën fillimisht vetëm që të prononcohem në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, që e mbështetim dhe kontributin tonë normalisht që do ta japim ndërmjet dy leximeve.

Këtu vetëm desha ta falënderoj edhe zonjën Luljeta Aliu si një ndër iniciueset e para, që ka dhënë një kontribut në avancimin e rolit të gruas dhe kontributin e gruas, veçanërisht në familje dhe në shoqëri në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Ne në parim e përkrahim. Do të japim kontribut në komision.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Nisma e mbështet nismën për të bërë plotësim-ndryshimin e këtij ligji, i cili formalisht është filluar nga komisioni, por në fakt është kryesisht meritë e zonjës Luljeta Aliu, e cila edhe qëndron këtu prapa në hapësirat e Kuvendit, që ka shtyrë përpara, ka gjetur mirëkuptim brenda përfaqësuesve të të gjitha partive të cilat janë të pranishme në komision, për të përmirësuar infrastrukturën ligjore kur vjen në shprehje çështja në fjalë. Unë e përgëzoj edhe zonjën Aliu për kontributin dhe shtytjen që i ka dhënë kësaj çështjeje. Ndërmjet dy leximeve edhe Nisma do ta japë kontributin e vet, që ligji të dalë sa më i mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju e dëgjua mendimin e komisionit. Unë si anëtar i komisionit po flas, por në emër timin personal.

Kjo është një formë dhe unë mendoj se si duhet të plotësohen dhe ndryshohen ligjet në Republikën e Kosovës. Edhe e falënderoj zonjën Luljeta Aliu për një analizë jashtëzakonisht të mirë, edhe të legjislacionit evropian, edhe të legjislacionit tonë, edhe të nxjerrjes së gjërave që kanë qenë edhe kundërthënëse në ligjin e mëparshëm edhe që nuk e kanë plotësuar kërkesën ligjore morale. Kanë qenë domethënë në kundërshtim. Pa të keq, po u bëj ftesë edhe kolegëve deputetë, edhe Ministrisë së Drejtësisë, sidomos, që vërtet të ketë analiza të tilla, në mënyrë që kur ta ndryshojmë një ligj me e ditë një thelb, shkurt dy-tri amendamente që vërtet e rregullojnë ligjin.

Ne kemi nevojë edhe t'i ndryshojmë disa ligje, po kjo është një punë të cilën unë po dua qëllimisht ta lavdëroj, jo të komisionit, po të personit që e ka sjellë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Ja, sa ta kryejë kjo, zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Atëherë, unë e konsideroj të rëndësishme të them disa fjalë lidhur me këtë projektligj.

Mendoj që është një gjë shumë e mirë, që në parim është një disponim i të gjithëve që të përkrahet dhe uroj që në mes dy leximeve të plotësohet me të gjitha amendamentet që mund ta bëjnë sa më të mirë Ligjin për familjen. Sigurisht, që ndryshimi dhe plotësimi i neneve të caktuara, për shembull i nenit 47, është i nevojshëm për faktin se në dispozitat e këtij neni janë evidente paqartësitë që lidhen me kontributin e përbashkët të bashkëshortëve për krijimin e pasurisë së përbashkët dhe për barasvlerën e tij.

Prandaj, edhe ndryshimi dhe plotësimi i këtij neni eliminon edhe konfuzionin dhe dilemat lidhur me kontributin e përbashkët të bashkëshortëve, pra cila është barasvlera me rastin e fitimit dhe ndarjes së pasurisë së përbashkët, pa asnjë diskriminim ndërmjet bashkëshortëve. Po ashtu, ky ndryshim dhe plotësim i këtij neni konsiston edhe në lehtësimin e interpretimit dhe të zbatimit të tij në praktikë nga organi kompetent në rastet e kontesteve që kanë të bëjnë me ndarjen e pasurisë së bashkëshortëve.

Duhet theksuar dhe përsëritur vazhdimisht të vërtetën e pamohueshme që situata e grave në familje është akoma tejet e rëndë, përveç një gjendjeje faktike, vështirësive që çdo ditë në vendin tonë hasin gratë dhe vajzat, kjo situatë është edhe një tregues i qartë që Kosova nuk po bën progres drejt integriteteve evropiane, pasi që nuk po plotëson asnjë nga kushtet themelore për ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, pa marrë parasysh gjininë dhe dallimet tjera.

Një ndër shkaqet kryesore përse gratë vazhdojnë të diskriminohen brenda familjes mbeten mangësitë ligjore që ekzistojnë në Republikën e Kosovës. Më lejoni t'ua kujtoj disa statistika në

aspektin ekonomik, të cilat më së miri dëshmojnë gjendjen reale të grave në Kosovë. Sipas raportit të Agjencisë për Barazi Gjinore në vitin 2016 pjesëmarrja e grave në regjistrimin apo posedimin e të gjitha llojeve të pronave është vetëm 12,12%, përderisa ajo e burrave është 87,88%. Burrat në shumicën e rasteve, sipas të njëjtit raport, nuk dëshirojnë të bëjnë regjistrimin e pronës në emër të përbashkët, edhe pse ata janë të informuar për të drejtat e grave të tyre si bashkëpronare të pasurisë së përbashkët.

Në këtë drejtim regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve mund të bëhet lehtësisht i detyrueshëm, sepse Ligji për familjen është e vërtetë se njeh të drejtën e barabartë në posedim të pronës së krijuar gjatë martesës. Kjo do të ndihmonte në krijimin e kushteve më të favorshme për gratë pas divorcit, në mënyrë që ato të mos jenë të detyruara të jetojnë nën dhunë në familje dhe në fund të bëhen viktimat, ashtu siç kemi jo pak raste në Republikën e Kosovës. Janë akoma të freskëta për secilin prej nesh rastet e Zejnepe Bytyqi-Berishës dhe Diana Kastratit, por edhe shumë rasteve tjera të tilla në Kosovë.

Tutje, në Kosovë vetëm 21,1% e grave janë të punësuar në raport me 61,8% të burrave të punësuar dhe duhet përmendur këtu, se një raport i tillë dhe një numër kaq i vogël i grave të punësuar nuk është kaq i ulët në asnjë vend tjetër të Evropës. Nga të gjitha bizneset e regjistruara as 10% e tyre nuk udhëhiqen nga gratë dhe vetëm 3% e gjithë kredive u jepen grave. Mbi 90% e pasurisë së përbashkët bashkëshortore regjistrohet vetëm në emër të burrave, duke i privuar gratë nga e drejta e tyre pasurore. Po ashtu, vlerësohet se në 99% të rasteve janë burrat ata që e trashëgojnë pronën dhe gratë kanë në posedim më pak se 10% të pasurisë dhe patundshmërive në Kosovë. Kjo gjendje e papunësisë dhe varfërisë financiare të grave i sjell ato në një situatë të nënshtruar, duke vështirësuar kështu edhe protestën ndaj dhunës nga ana e tyre dhe aq më pak, raportimin e saj.

Tutje, sipas raporteve të Rrjetit të Gruas së Kosovës, 40,9% e grave vuajnë nga dhuna në familje. Për më tepër e më keq, kjo shifër u referohet vetëm rasteve të raportuara dhe atë kryesisht rasteve të dhunës fizike, që është një tregues se shifra reale e grave që vuajnë nga dhuna në familje në shoqërinë tonë është shumë më e lartë. Për më shumë, sipas raporteve ne kemi akoma, madje edhe zyrtarë që punojnë në institucione, të cilët e shohin normale që burri të përdorë dhunë ndaj gruas nëse ajo, për shembull, nuk përgatit drekën apo nuk bën punët tjera. Po ashtu, ato fajësohen edhe nëse janë viktimat të dhunës, duke ju treguar madje se si do të duhej të sillëshin në mënyrë që të mos përjetonin dhunë. Ka edhe raste, kur viktimat e dhunës trajtohen keq edhe nga vetë zyrtarët policorë, përderisa ka edhe prokurorë e gjyqtarë, që ende mendojnë se burrat janë ata që duhet ta kenë fjalën e fundit dhe se pushteti i tyre nuk duhet të minohet.

Përpos dhunës që gratë duhet të durojnë, hulumtimet kanë gjetur se kujdestaria e fëmijëve u është dhënë shumë shpesh autorëve të dhunës dhe jo viktimave, vetëm për faktin se gratë kanë pasur gjendje financiare më të dobët, se sa bashkëshortët e tyre, duke vlerësuar kështu epërsinë

financiare shumë më të lartë, se mirëqenien fizike dhe atë mendore të fëmijëve. Në shumicën e rasteve të divorceve gratë duhet të largohen nga shtëpia, ndonëse ajo është pasuri e përbashkët. Shpesh kjo ndodh edhe në mënyrë të dhunshme apo edhe përmes pamundësisë së grave që të dëshmojnë të drejtën e tyre në pasurinë e përbashkët, shkaku i praktikës ligjore, e cila e ka interpretuar Ligjin për familjen në mënyrë mjaft diskriminuese ndaj grave, duke kërkuar nga to që të dëshmojnë nëpërmjet faturave kontributin e tyre material dhe madje, shpeshherë duke u kërkuar edhe që të japin garanci, në rast se ato kanë kërkuar që të pengohet shitblerja e pronës së përbashkët.

Largimi i grave nga shtëpia sjell edhe pamundësinë e realizimit të të drejtave pronësore dhe marrjes së fëmijëve nga to, kjo për arsye se Gjykata ia jep kujdestarinë babait me të vetmin arsyetim, se gratë nuk mund të sigurojnë një jetë më të mirë për fëmijët, shkaku i situatës së tyre ekonomike. Gjithë këto fakte tregojnë se zinxhiri i dhunës dhe degradimit social të personave të divorcuar ndodh, sepse në fakt mungon rregullimi adekuat ligjor dhe institucional, ashtu sikurse mungon edhe vullneti institucional për të ndryshuar këtë gjendje, duke krijuar kështu edhe mundësinë për diskriminim sistematik të grave përmes kushtëzimit ekonomik.

Duhet theksuar se, ndonëse kanë ekzistuar përpjekje të grupeve të ndryshme, kryesisht vetë grupeve të grave për të parandaluar dhunën në familje, deri më sot nuk mund të themi se kemi progresin e qëndrueshëm në këtë drejtim. Kryesisht angazhimi ka qenë në drejtim të eliminimit dhe parandalimit të dhunës fizike, por pothuajse nuk është trajtuar kjo dukuri në burimin e saj, pra në dhunën ekonomike ku situata e vështirë ekonomike i pamundëson gruas të realizojë të drejtat e saj. Në këtë drejtim nuk duhet harruar dhe anashkaluar faktin se edhe dhuna fizike dhe ajo psikike në shumicën e konsiderueshme të rasteve, durohen nga gratë pikërisht për shkak të kushteve të tyre të rënda ekonomike, që janë shkaktuar nëpërmjet kësaj dhune ekonomike.

Ndonëse dhuna ekonomike ndaj grave është një dukuri e përhapur në shoqërinë tonë, ende nuk është tematizuar si arsye për ekzistimin e dhunës, asaj fizike pra dhe psikike, dhe në këtë drejtim, përpos bashkëshortëve fajtorë mbeten edhe institucionet tona, pasi që korniza ligjore e Kosovës ende ka hapësira dhe paqartësi, të cilat kanë mundësuar diskriminimin e grave në këtë drejtim.

Një çështje tjetër që duhet theksuar është se zbrazësitë ligjore, pos që janë diskriminuese ndaj grave, krijojnë edhe kushte për korrupsion dhe vendime arbitrare të Gjykatës. Ndonëse korniza jonë ligjore mbi të drejtën e barabartë të grave ekziston, duke filluar që nga akti më i lartë juridik, Kushtetua dhe tutje, padrejtësitë ndaj grave ndodhin edhe gjatë kërkesës për vlerësimin e kontributit nga ana e Gjykatave dhe interpretimin e këtij kontributi si kontribut kryesisht monetar. Kjo është kundër çdo të drejte njerëzore dhe të drejte të grave dhe nënave, meqenëse zhvlerëson vlerën e familjes, duke e konsideruar si një punë e cila, meqë nuk mund të dëshmohet me fatura të pagesës, nuk është për t'u marrë parasysh. Madje, edhe kur avokatët që i përfaqësojnë gratë arrijnë të argumentojnë se kontributi i grave sipas përkufizimit të ligjit shkon

përtej të hyrave materiale, prapëseprapë vlera që i caktohet kontributit të gruas në shumicën e rasteve është shumë e vogël. Kjo për shkak të mundësisë për arbitraritet nga gjykimi i gjyqtarëve, se sa duhet të jetë vlera e kontributit në familje për gratë, nga mundësia për korrupsion me gjyqtarët dhe nga vlerësimi i një eksperti financiar. Kësisoj pra lihet mundësia që gjykatat tona të vendosin në favor të palës së fortë dhe në disfavor të grave.

Në vendet tjera ligji saktëson saktë këtë dhe në vende si Amerika, për shembull, është e përcaktuar edhe ndarja fikse 50:50%. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh gjithë këtë dhe shumë të tjera që nuk arrita t'i paraqes për shkak të kohës së kufizuar në këtë fjalë, unë besoj që do të kontribuojmë të gjithë bashkërisht në plotësimin me amendamente dhe të kontribuojmë në mes dy leximeve, në mënyrë që grave t'u realizohet e drejta e tyre ligjore dhe të ndihmohet fuqizimi i tyre ekonomik, që rrit gjasat për përmirësim jo vetëm të jetës së grave, por të shoqërisë sonë. Dhe, sigurisht edhe personalisht, përveç që falënderoj zonjën Aliu, unë shfrytëzoj këtë rast që të inkurajoj të gjithë ata që kanë çfarë t'i ofrojnë kësaj shoqërie të përdorin një model të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Nagavci! Fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ministra,

Kolegë deputetë,

E nderuar zonja Aliu,

Pa u thelluar në projektligjin dhe po ashtu, në çështjet që ka ngritur iniciuesja e këtij projektligji, dëshiroj vetëm të theksoj rëndësinë që ka ky projektligj më shumë se sa ajo që është temë e plotësim-ndryshimit të Ligjit për familjen, është një çështje themelore për barazinë gjinore në vendin tonë. Kjo tregon se ka ende çështje të caktuara që mund të trajtohen dhe është mirë që ky është një rast unik ndoshta, i një iniciimi nga krejt jashtë Kuvendit.

Unë më shumë se sa si një deputet i Parlamentit të Kosovës, dëshiroj në emër të Forumit për Transparencë Parlamentare të Kuvendit të falënderoj Shoqërinë Civile, t'i inkurajoj të gjitha organizatat e Shoqërisë Civile që të punojnë me Kuvendin dhe të bëjnë propozime të tilla dhe jo vetëm organizatat, por edhe individë të caktuar që dëshirojnë të ngrenë çështje që mund të trajtohen edhe si ndryshim-plotësim ligjesh, po ashtu edhe të marrin iniciativa për nisma të reja ligjore. Jam i sigurt që do të gjejnë mbështetjen e deputetëve, sikur sot në Kuvendin e Kosovës edhe më tutje. Po ashtu, është për t'u admiruar jo vetëm kjo nismë ligjore, por edhe një debat publik, një mbështetje publike që është bërë deri më tash dhe shpresoj që edhe gjatë trajtimit në Kuvend, deri te finalizimi i këtij projektligji, të ketë një debat dhe të finalizohet me sukses. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kollçaku edhe një herë e ka kërkuar fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Mbetet vetëm edhe një të qartësohet, pse në fakt është e nevojshme shumë të bëhet plotësim-ndryshimi i këtij ligji dhe çfarë në fakt ka dashur zonja Luljeta Aliu të theksojë, po çka duam edhe ne të gjithë këtu, në veçanti gratë deputete të cilat besoj se njëzëri i mbështetin këto ndryshime.

Nëse pyesni një fëmijë të cilit nuk i punon nëna sot, “Çka punon nëna jote?”, ai ndoshta do të përgjigjet “Asgjë! Nuk punon askund.”, sepse në fakt fëmija nuk është mësuar dhe nuk është edukuar që ta vlerësojë punën e nënës, do të thotë punën e amvisës, e cila 24 orë është në shërbim të familjes, 24 orë është në shërbim të fëmijëve, të bashkëshortit, të rrethit familjar, por puna e së cilës asnjëherë nuk është vlerësuar.

Ne e dimë që si model është marrë një ligj gjerman, ku vlerësohet puna familjare, unë them jo vetëm ai gjerman, por unë kam përvoja me familjarë që jetojnë në Norvegji, ku çdo punë që nëna kryen për një fëmijë të moshës 18 vjeç e sipër duhet të vlerësohet dhe të paguhet, qoftë edhe nga vet fëmija, sepse nuk është e obliguar që t’ia kryejë obligimet e tija dhe të mos vlerësohet puna. Prandaj, besoj që padrejtësia më e madhe që i është bërë deri tani një gruaje amvise, e cila vlerësohet se “nuk punon asgjë”, edhe pse tërë ditën qëndron në këmbë, përderisa vlerësohet në të njëjtën kohë puna e bashkëshortit, i cili përderisa punon i qetë sepse gruaje e tij e mbulon edukimin e fëmijëve, punët në amvisëri dhe të gjitha, ai paguhet, ndërsa ajo për të njëjtën punë nuk merr kurrfarë kompensimi.

Besoj që gratë amvise, të cilat asnjëherë nuk janë përfshirë askund, asnjëherë nuk kanë marrë merita dhe vlerësime si gratë që kanë rastisur dhe kanë pasur fat të punësohen në institucione, veçanërisht në ato publike, tanimë do ta marrin atë që meritojnë, fillimisht vlerësimin për punën e tyre dhe pse jo, që të vlerësohet edhe në aspektin material kontributi dhe puna e tyre e palodhshme.

Prandaj, besoj se të gjitha gratë deputete, në këtë rast ne që duhet t’ia japim vulën përfundimtare, do të kemi rastin që ta korrigjojmë këtë padrejtësi, të mos them shekullore, po që me vite e vite u është bërë grave që në këtë rast duhet të nderohen dhe tek e fundit, të gjitha ne për një moment të caktuar kemi qenë dhe mund të jemi amvise.

Ju falënderoj për rastin që të shprehem!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk ka ndonjë vërejtje në emër të Qeverisë. Konsideroj se është përfunduar diskutimi. Mbetet votimi në momentin që të krijohet kuorumi i duhur.

Po vazhdojmë me pikën jashtë rendit të ditës, që është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës para jush paraqes Projektligjin për qasje në dokumente publike i miratuar nga Qeveria me vendim nr. 05/50 të datës 5. 6. 2018.

Projektligji për qasje në dokumente publike garanton të drejtën e qytetarëve për të ditur dhe rregulluar transparencën për llogaridhënie në institucione publike. E drejta në qasje në dokumente është e drejtë themelore, që siguron funksionimin e demokracisë dhe zhvillimin e vendit. Projektligji garanton të drejtat pa diskriminim të çfarëdo baze për të pasur qasje në dokumentet dhe informatat publike të prodhuara, të pranuar, të mbajtura apo të kontrolluara nga institucionet publike, si dhe për të drejtën për ripërdorim të dokumenteve dhe informatave të sektorit publik.

Me projektligjin e ri synohet të rregullohet kompetenca e shkallës së dytë të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, pasi një kërkesë të refuzohet nga institucioni publik, shkalla e dytë do të jetë Agjencia për Informim dhe Privatësi që do të udhëhiqet nga komisioni i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, që do të themelohet nga ristrukturimi i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Projektligji përmban obligime për institucionet publike që të mbajnë hapur të dhënat të cilat mund të përdoren nga individët dhe nga bizneset. Hapja e të dhënave do të mundësojë bizneseve të reja, sidomos atyre të teknologjisë informative, të krijojnë aplikacione me të dhënat e nevojshme për një treg të ri, që të ndihmonte ekonominë dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Për fund, e drejta në qasje në dokumente publike është e garantuar me nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe është në përputhje me direktivën 2013/37/EU të Parlamentit të Evropës dhe të Këshillit të datës 26 qershor 2017 mbi përdorimin/ripërdorimin e informatave të sektorit publik.

Kam nderin që pata rastin të ju informoj në pika të shkurta për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizave ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bytyqi! E ftoj përfaqësuesin e komisionit, zonjën Izmaqu, ta marrë fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më datën 06.07.2018 shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim para leximit të parë në mbledhje plenare dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për qasje në dokumente publike, vendosi dhe vlerësoi që projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Po ashtu, po vazhdoj të flas edhe në emër të grupit, i nderuar nënkryetar. Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për qasje në dokumente publike. Vendi ynë për herë të parë një ligj për qasje në dokumente i titulluar “zyrtare” ka pasur në vitin 2007, pastaj në vitin 2010 kemi pasur me titullar të ri, domethënë Ligjin për qasje në dokumente publike dhe tani, po ashtu një ligj të ri, sepse ka pasur një ndryshim goxha të madh në sasi, kështu që kemi një ligj të ri sot para nesh.

Ky ligj përcakton kufizimet dhe përjashtimet në të drejtën për qasje në dokumente dhe informata publike, pra është një ligj që i nevojitet çdo shoqërie demokratike për të përcaktuar se sa e ka të përmbushur nivelin e llogaridhënies dhe transparencës. Në këtë drejtim, nëse ne do të arrijmë të punojmë, sepse ka nevojë të punohet në ligj, ka disa..., një terminologji, e cila më shumë është shpeshherë e përkthyer që nuk i përshtatet aspektit gjuhësor, aspektit tonë. Pra, ka nevojë të punohet pas miratimit në parim, megjithatë përmbajtjen e ka jashtëzakonisht të mirë. Pra, përcakton detyrimet e institucioneve tona publike për të publikuar dhe ofruar dokumentet nga të gjitha institucionet publike në mënyrë proaktive dhe për të siguruar hapjen e të dhënave publike,

si dhe përcakton qartë procedurën se kur kjo lejohet. Pra, është një afat deri në 15 ditë dhe personat apo zyrtarët publikë dhe institucionet, të cilat nuk e respektojnë këtë, ka edhe penalizime me gjoba.

Ky ligj i ri do të rritë transparencën në të gjitha institucionet tona, do të ketë përgjegjësi shumë më të shtuara, me faktin që të gjitha dokumentet, të cilat deri tani kanë mundur të jenë vetëm një herë si qasje në përdorim, pra me ligjin e ri ka mundësi që ato të ripërdoren dhe të vendosen edhe për raste të tjera, pa marrë parasysh ndalesat që i ka në ligjet e tjera. Mirëpo, në çdo rast kur një qytetar apo shoqëri civile, apo organizatë kërkon që të ketë qasje në dokumente publike duhet të ketë parasysh se janë edhe ndalesat në bazë të Ligjit të procedurave të përgjithshme administrative, të Ligjit për klasifikimin e dokumenteve. Ne kemi detyrime që t'i respektojmë ato, pra nuk mund të kërkojmë edhe dokumente, të cilat mund të rrezikojnë persona, organizata ose sigurinë e institucioneve shtetërore. Meqenëse kemi mundësi të punojmë edhe pas miratimit, grupi ynë parlamentar do ta mbështesë dhe do të vazhdojë që të kontribuojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues për fjalën e dhënë!

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar këtë ligj, e ka analizuar relativisht mirë. Unë po flas në emër të Grupit Parlamentar, por ndoshta më jepni fjalën ta përfundoj mandej krejt, kështu që të mos e marr dy herë fjalën.

Çështja e parë që duhet të theksohet është se Kosova e ka Ligjin për qasje në dokumente publike, përpara e ka pasur në qasje në dokumentet zyrtare, kjo është e treta herë që po ndryshohet ky ligj, është e çuditshme pa marrë parasysh kush e ka bërë pse kanë ndryshuar këto ligje, pse ndryshojnë rrënjësisht? Kjo është një çështje, domethënë. Ne kemi ligjin e mëparshëm që nuk ka qenë më i miri, por nuk është zbatuar, domethënë me gjithë vërejtjet dhe rekomandimet e mëdha. Çështja tjetër është se pas analizës së këtij ligji që e kemi bërë ne, kemi parë disa elemente që në të vërtetë të bëjnë të dyshosh në parimet e ndërtruara me këtë ligj. Në një anë, ky është një përkthim i direktivave evropiane, edhe ka pjesë shumë të mira, në anën tjetër, janë futur elemente që nuk janë në direktiva dhe në të vërtetë kanë konotacion thjesht politik. Unë po ju lexoj pjesët që ju ta dini për çka e kam fjalën. Këtu e kemi, për shembull, nenin 3, paragrafi 4. “Ky ligj nuk e cenon të drejtën për qasjen në dokumente publike që mbahen nga institucionet publike e të cilat mund të rrjedhin nga instrumentet ligjore ndërkombëtare apo aktet e institucioneve, të cilat i zbatojnë ato”.

Çka është kjo? Kjo është, nuk lejohet të kesh qasje në kontratën e “Bechtel&Enka”-s. Kjo është ajo që duhet të nxirret dhe ta shohim ne me kujdes. Kemi edhe të tjera, informatat e klasifikuara nga institucionet publike që kanë prejardhje apo janë shkëmbyer në bazë të një kornize të bashkëpunimit në organizata ndërkombëtare apo shtu edhe të tjera. Çka janë këto? Pse nuk

shpjegohen? Apo, mandej ia sjellin Kuvendit një marrëveshje ndërkombëtare dhe thonë: “Votoje!”, s’ka më tutje.

Këtu janë ato problemet politike që i shohim ne, përveç përmirësimeve që janë bërë në këtë ligj, natyrisht sepse janë përkthime të një pune filozofike, edhe politike shumë të përparuar në Evropën tonë. Ne kemi edhe çështje të tjera që i kemi nxjerrë këtu, edhe një çështje krejt parimore është në të vërtetë ky ligj është punuar në të njëjtën kohë me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këtë po e përmend për një arsye, sepse janë dy ligje që prekin të drejtat e njeriut. Edhe kur i sheh shumë pjesë të këtyre ligjeve, vërtet 70-80% kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, edhe nja 10-20% me sigurinë. Nuk i është dërguar fare Komisionit për të Drejtat e Njeriut për shqyrtim. Pse të ndodhë kjo, kur ka të bëjë drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut? Edhe unë nuk po them në Komisionin për Legjislacion, edhe ne do ta trajtonim natyrisht, mirëpo në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, se prek të drejtat e njeriut, edhe pse po e them hapur se këto ligje si të përkthyer nga direktivat evropiane, janë të kujdesshme në atë drejtim, sepse respektojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kemi edhe pika të tjera, këtu nuk është sqaruar relacioni agjenci - komisar, edhe pse ky relacion dhe këto institucione sqarohen drejt në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë më të gjatë, por këtu nuk kemi ndonjë rekomandim të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, se në të vërtetë janë dy ligje që futen brenda një institucioni që do t’i zbatojë komisari edhe Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mirëpo, edhe në këtë drejtim një gjë e mirë që është bërë ndoshta që pjesa për Avokatin e Popullit që është në këtë ligj, neni 21, në të vërtetë është bërë tepër, sepse pa u sqaruar kompetencat e dy institucioneve futet Avokati i Popullit nga frika se do të thotë ‘po’ ose ‘jo’ diçka. Unë mendoj se edhe në interesin e institucionit, por edhe në interesin e të drejtave është që të hiqet Institucioni i Avokatit të Popullit nga zbatimi i këtij ligji dhe Avokatit të Popullit t’i lihet e drejta për të rekomanduar në rast të shkeljeve procedurale, por këtu jepen disa të drejta më shumë që nuk kanë të bëjnë me të.

Unë mendoj se këtu e kemi bërë ne një analizë të hollësishme, dhe kemi parë edhe çështje të tjera që duhet të rregullohen, por unë po them në parim janë çështje me të cilat unë personalisht nuk pajtohem, mendoj se as Lëvizja Vetëvendosje nuk do të duhej të pajtohet, po të mos ndryshohen këto çështje që prekin thelbin e qasjes në dokumentet publike. Unë kam edhe nenin 16 që në të vërtetë nuk është asgjë tjetër, por është një përkthim i drejtpërdrejtë i një direktive evropiane që në të vërtetë për interesa politike është lënë i gjymtë. Ai nen në direktivën evropiane i ka tri paragrafë, këtu janë vetëm dy paragrafë, por kjo nuk është e keqja, një paragraf me rëndësi është lënë krejt, por e keqja është se edhe një paragraf që është përkthyer, është lënë vetëm pjesa e parë, pjesa e dytë është hequr, e pjesa e dytë në të vërtetë është thelbi, ka të bëjë pikërisht me qasjen në dokumente publike për nenet që i lexova pak më parë dhe sidomos për monopolin që mund ta kenë organizatat ndërkombëtare, si “Bechtel&Enka” apo si ndonjë organizatë tjetër në Kosovë që nuk i jep kontratat të bëhen publike.

Edhe, këto janë ato çështjet që janë fshehur në ligj, që kanë karakter politik dhe nuk kanë karakter juridik, por janë norma juridike që rregullojnë veprimin politik të institucioneve të ndryshme. Natyrisht, ne kemi edhe çështje të tjera, unë po e them krejt hapur për ta treguar qëndrimin politik të Lëvizjes Vetëvendosje. Në formën që është ofruar ligji, me këto fshehje që janë shumë subtile, parimisht kërkoj nga kolegët që të mos e miratojnë këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Projektligji për qasje në dokumentet zyrtare kërkon një vëmendje të veçantë, siç thanë edhe kolegët e mi, në trajtimin dhe shqyrtimin e tij nga ne si përfaqësues dhe si deputetë që jemi në interes të qytetarëve.

Pasi dihet shumë mirë se asnjëherë deri më tani që një kohë të gjatë qytetarët tanë nuk kanë pasur apo, thënë më mirë, që nuk kanë qenë të mirinformuar mbi mënyrën e qasjes aktuale dhe të lehtë në dokumentet apo informacionet publike, për të cilat ata kanë pasur interes.

Korniza ligjore paraprake, përkundër që ka qenë mjaft e mangët dhe e keqinformuar, në shumicën e rasteve nuk ka gjetur zbatim dhe nuk është respektuar nga institucionet publike, pasi që me mekanizmin adekuat për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji nuk ka performuar gatishmëri dhe vullnet për të qenë frytdhënës. Prandaj, edhe qasja në dokumente të tilla ka qenë mjaftë komplekse si dhe llogaridhënia dhe transparenca ndaj qytetarëve përherë ka munguar.

Projektligji në fjalë, sado që do të evitojë mangësitë e ligjit paraprak, nuk do të mund të arrijë qëllimin e tij sado të mirë që mund ta ketë, përkundër përcaktimit të mekanizmave përkatës të përcaktuar për mbikëqyrjen e institucioneve publike në trajtimin e kërkesave të palëve për qasje në dokumente zyrtare, pasi që mënyra e funksionimit të sistemit në adresimin e kërkesave në qasje të dokumenteve zyrtare mbetet e paqartë për qytetarët e rëndomtë.

Inkorporomi dhe zbatimi i gjobave të këtij projektligji sado modeste që mund të jenë për institucionin, të cilat e pengojnë qasjen në dokumentet zyrtare, nuk na garanton se do të ketë efekt pozitiv, mirëpo inkurajon qytetarët që të ndëshkojnë neglizhencën e institucioneve publike. Prandaj, duhet ta kemi të qartë një gjë se, është tepër e nevojshme dhe e domosdoshme që në projektligj të procedohet me institucionet publike, sidomos ato të një rëndësie të veçantë të publikojnë në ueb-sajtet e tyre zyrtare të gjitha aktet ligjore dhe ato nënligjore, si dhe t'i bëjnë transparente për publikun edhe llojet tjera të dokumenteve, për të cilat do të mund të ketë interes ndonjë palë për qasje në ato dokumente.

Ruajtja e regjistrave mbetet një shqetësim i kahershëm për qytetarët dhe shoqëritë e ndryshme civile, sepse nuk planifikohet nga institucionet publike e as të nivelit qendror dhe as të tij lokal.

Dukuri mjaft negative vërehet nëpër komunat e Kosovës, ku në ueb-faqet zyrtare të komunave mungon publikimi edhe i rregulloreve që janë mjaft të rëndësishme. Domethënë, i rëndësishëm është edhe rregullimi i fushave të ndryshme, siç janë për shembull, rregulloret për tatimin në pronë.

Qasja elektronike në dokumentet zyrtare, sado që përfshihet edhe në projektligjin aktual, mund të mos tregojë rezultat, pasi që kërkesat përmes këtij mjete nuk merren parasysh në shumicën e rasteve, kurse në anën tjetër përgjegjësia mbi kërkesën u jepet nga këto organe publike mu përmes mjeteve elektronike. Problem tjetër shqetësues mbetet edhe klasifikimi i dokumenteve dhe informacioneve, të cilat nuk lejohen me projektligjin në fjalë të bëhen publike, siç e cekën edhe kolegët e mi. Mu për këtë pikë ndërlikohen gjërat për qytetarët e rëndomtë, pasi në shumicën e rasteve mashtrohen dhe neglizhohen nga institucionet publike, pasi që u pamundësohet qasja dhe informacionet në dokumentin, me arsyetimin se dokumentet e tilla janë të klasifikuar dhe si të palejuara për t'u publikuar dhe kështu ata bien në lajthitje dhe u pamundësohet qasja e tyre.

Shpresojmë shumë që ky projektligj t'i arrijë qëllimet të cilat edhe i kërkuan kolegët dhe ata ta detyrojnë këtë Qeveri dhe të tjerat, të cilat kanë qenë paraprakisht, të japin llogari mbi punën e tyre dhe mbi informimin e qytetarëve mbi kontraktimin e marrëdhënieve të shumta dhe të njerëzve të cilët kanë pasuri multimilionëshe, që po bien në konsorciume të ndryshme dhe po i mbajnë konfidente ndaj qytetarëve, domethënë të dhënat konfidenciale ndaj qytetarëve, duke u arsyetuar se fshehtësia e tyre i kontribuon interesit qytetar.

Ky projektligj në mënyrë të veçantë duhet të rregullojë dhe duhet listuar të gjitha llojet e dokumenteve dhe informacioneve në ueb-sajtet e institucioneve, duke mos lejuar që ato të përcaktojnë vet në mënyrë diskencionale informatat të cilat do t'i bëjnë të qasshme për publikun. Shpresojmë shumë, që ky ekzekutiv i tanishëm të mos bjerë ndesh me këtë ligj, pasi që është edhe vetë propozues i tij dhe të fillojë një praktikë të re, duke punuar dhe duke i bërë vetë të qasshme procesverbalet e seancave punuese dhe të mbajë një regjistër të mirëfilltë të strategjive të saj politike e zhvillimore në faqet e saj zyrtare, në mënyrë që llogaridhënia, transparenca dhe monitorimi i punës së saj të bëhet më i lehtë për qytetarët dhe mekanizmat përkatës.

Po ashtu, shpresojmë në gatishmërinë e komisionarit të agjencisë përkatëse dhe gjyqtarëve, që në rast konflikti administrativ ndërmjet palëve dhe institucioneve të jenë efikas dhe t'i trajtojnë drejtë dhe në kohë të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me refuzimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, pasi që tek e fundit është edhe e drejtë që u garantohet edhe me kushtetutë dhe me akte ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Zoti Bytyqi, zoti ministër, a dëshironi për fund t'i thoni dy fjalë? Jo. Atëherë, konsideroj se edhe kjo pikë e rendit të ditës është

shteruar, sa i përket leximit të parë. Votimi do të bëhet edhe për këtë në momentin, ose në seancën e radhës që do ta caktojë Kryesia, për t'u votuar bashkë me pikat tjera.

Pikat tjera janë në lexim të dytë, janë tri ligje, domethënë pika 7, 8 dhe pika e 9-të dhe e 10-të. Edhe këto i lëmë për seancën e radhës kur ta caktojë Kryesia.

Konsideroj që seanca e sotme ka marrë fund. Seancën e re do ta caktojë Kryesia dhe do të njoftohen të gjithë deputetët. Faleminderit!

Mirupafshim në seancën e re!

* * *

E hënë, 23 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 12 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për pikat e rendit të ditës prej 1 - 4 kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 13 korrik 2018, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Shkojmë në votimin e tyre.

3. Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë

Vazhdojmë me votimin në parim të projektligjit. Votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar, 71 për, asnjë kundër, një abstenim. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskim të pasurisë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

Vazhdojmë me votimin në parim të projektligjit. Votojmë tash!

79 deputetë kanë votuar. 77 për, 2 abstenime. Kuvendi e miraton në parim Projektligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës

Vazhdojmë votimin në parim të projektligjit. Votojmë tash!

83 deputetë kanë votuar. 81 për, 1 kundër, 1 abstenim. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike

Vazhdojmë me votimin në parim të projektligjit. Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar. 69 për, 1 abstenim. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Ismajl Kurteshi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Parlamentar i Arsimit e ka shqyrtuar dhe amendamentuar këtë projektligj dhe i rekomandon Kuvendit që të njëjtin ta votojë edhe në leximin e dytë.

Nëse më lejohet, kryetar, meqë e kam fjalën, të shpreh edhe një shqetësim të Komisionit Parlamentar të Arsimit. Nuk do të marr më shumë se një minutë.

Komisioni Parlamentar i Arsimit është i shqetësuar nga informata, se Ministria e Drejtësisë, Ministria e Administratës dhe Ministria e Çështjeve Sociale në dakordim me kryetarin e Komunës së Pejës janë pajtuar që ta rrënojnë Shkollën për Persona të Verbër në Pejë dhe në vend të saj ta ndërtojnë Gjykatën Themelore të Pejës.

Komisioni i Arsimit kërkon nga ministrinë përkatëse që të heqin dorë nga plani për rrënimin e kësaj shkolle, të vetme në Kosovë, dhe për Gjykatë të sigurojnë një lokacion tjetër. Për pengimin e këtij plani të dëmshëm, nëse është e nevojshme, duhet të ndërhyjë edhe Ministria e Arsimit, madje edhe vetë kryeministri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Si deputetë të Kuvendit të marrim shqetësimin e komisionit. Është mirë të na e sjellin një informacion ministrinë përkatëse dhe të shpërndalet te deputetët e Kuvendit.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 48 amendamente. Do të votojmë amendamentet e propozuara me pajtueshmërinë e plotë, nga 1 deri 48 bashkërisht.

Kemi dy procesverbale. Në timin është me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, neni 39. E vërtetojmë. Në qoftë se është e ndryshueshme, e largojmë vetëm nenin...amendamentin... Atëherë, të gjitha janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Edhe nga komisioni, në qoftë se ka gabime, reagoni. Të gjitha, nga 1 - 48 janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Atëherë, nuk ka reagim. Urdhëroni, zonja Bunjaku-Rexhepi, fjala për ju.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë në parim pajtohem me kryetarin e Komisionit për Arsim, mirëpo nga ky projektligj është larguar neni 25, amendamenti 48, ku thuhet se ky nen është hequr njëanshëm, pa pëlqimin e komisionit, nuk është diskutuar fare heqja e kësaj pike, edhe pse kjo pikë është e rëndësishme së veçantë.

Dëshiroj që t'i lus kolegët e mi deputetë që të mos votohet largimi i nenit 25, po të mbetet në fuqi neni 25. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Ia jap kryetarit të Komisionit FunkSIONAL, le të na japë qëndrimin para se të hyjmë në votim. Urdhëro, zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Me sa mbaj mend unë, këtu janë edhe anëtarët e tjerë të komisionit, ligji ka ardhur këtu para Kuvendit, ashtu siç e ka propozuar komisioni dhe neni, për të cilin po bën fjalë zonja deputete, është në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji, ku thuhet që “të punësuarit në Inspektoratin e Arsimit janë shërbyes civilë...”, kurse në nenin që po kërkohet të mbetet në fuqi, e që ka ardhur si propozim i ministrisë, thuhet: “Do të jetë përgjegjësi e drejtorit të përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit që t'i emërojë inspektorët që janë në detyrë, në pozita të inspektorëve administrativë ose pedagogjikë”. Shërbyesit civilë nuk emërohen, ata zgjidhen me konkurs. Inspektorët aktualë ata janë nëpër vende të caktuara, prandaj nuk mund të njëjtit, edhe të jenë të zgjedhur përmes konkursit, edhe të emëruar përmes drejtorit të Inspektoratit. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, 1-48 amendamentet shkojnë në votim në tërësi për deputetët.

Zonja Bunjaku-Rexhepi, urdhëroni!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Unë edhe një herë, thashë se nuk është fjala që ata nuk janë shërbyes civilë. Është shumë e vërtetë që në Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit ata janë shërbyes civilë, mirëpo largimi i këtij neni domethënë marrja e kompetencave të

inspektorëve dhe të kryeinspektorit. Në këtë rast, unë jam për këtë projektligji, por që të kthehet amendamenti 25, sepse po u merren kompetencat inspektorëve të arsimit dhe me këtë nen bëhet fjalë për ruajtjen e vendit të punës së tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Fjala tash është e seancës.

1 - 48 votojmë tash! 1 - 48 bashkërisht, votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 63 për, 2 abstenime, asnjë kundër. Kalojnë të gjitha amendamentet.

Tani, votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. 96 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 63 për, asnjë kundër, 2 abstenime. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

8. Shqyrtimi i dytë i projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj zonjën Besa Baftiu në emër të Komisionit Funkcional që të arsyetojë raportin me rekomandime.

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, bazuar në nenin 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ka shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për gjak dhe përbërësit e gjakut.

Janë gjithsej 55 amendamente, ku 54 amendamente janë me përkrahje të komisionit dhe një është pa përkrahje të komisionit. Ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të votojnë pro këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në votimin e 55 amendamenteve. Do të vazhdojmë votimin e tyre 54 të gjitha bashkërisht, i vetmi amendamenti i 39 nuk futet në votim. Amendamenti 39 nuk futet në votim. Shkojmë nga 1 – 55, me përjashtim të amendamentit 39.

Zoti Fadil Beka, a dëshironi fjalën? Urdhëroni!

FADIL BEKA: Faleminderit, kryetar!

E kam një vërejtje të vogël në amendamentin 1. Desha ta kem sot përkrahjen edhe të komisionit, edhe të kolegëve.

Amendamenti 1, titulli dhe paragrafi 1 i nenit 1 riformulohet si në vijim: “Me këtë ligj rregullohet procedura për dhurimin, marrjen, testimin, përpunimin dhe ruajtjen e gjakut, si dhe furnizimin e qytetarëve apo pacientëve me gjak dhe përbërës të gjakut”.

Unë do të kërkoja që “qytetarëve” të hiqet dhe të mbetet vetëm “... për furnizimin e pacientëve me gjak dhe përbërës të gjakut.”

KRYETARI: Zoti deputet,

Atëherë edhe një... Zonja kryetare, unë po e largoj edhe 1-shin njëherë, t’i kryejmë këto 53 amendamente, pastaj ta kemi edhe një debat, e merrni fjalën ju si kryetare dhe deputetët e vendosin.

Amendamentet 1 dhe 39 largohen. Vendosen 53 amendamente, të gjitha bashkërisht, përnjëherë në votim për deputetë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Atëherë, shkojmë në votim në tërësi. Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar. 67 për, 1 kundër, 2 abstenime. Miratohen 53 amendamentet.

Tani tek amendamenti 1 kemi të bëjmë me interpretim, më tepër, po zonja kryetare, urdhëro. Zonja Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç thatë, ky është vetëm një riformulim i amendamentit 1. Deputeti Fadil Beka tha për pacientë, mirëpo, doktor, e dimë që kemi dhurues vullnetarë të gjakut dhe nuk është fjala vetëm për pacientë, ku ceket edhe “pacientët”, mirëpo janë qytetarët ata të cilët janë dhurues vullnetarë të gjakut, edhe pa qenë pacientë. Kjo është arsyeja pse e kemi lënë fjalën “edhe qytetarëve, edhe pacientëve”.

KRYETARI: Atëherë, a e formulojmë të hiqet fjala “qytetarëve”, për arsye se pacient, jo... kryetarja po thotë jo. Zoti Beka, unë mund t’i vendos të dy opsionet në votim. Atëherë Zoti Beka, edhe një herë fjala për ju, derisa edhe unë konsultohem për procedura.

FADIL BEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë e kuptoj që dhuruesit janë qytetarët, mirëpo këtu bëhet fjalë për furnizimin e qytetarëve apo pacientëve, domethënë është fjala për furnizim, prandaj me gjak furnizohen vetëm pacientët, jo qytetarët, se edhe pacientët janë qytetarë.

KRYETARI: Zoti deputet, kështu, ne derisa kryetarja e komisionit, ju e keni sjellë tash, mbetet e kryetares së komisionit. Unë e vë në votim atë amendamentin 1, i cili është, pastaj ju si deputetë

e vendosni qëndrimin juaj. Nuk mund ta ndërrojmë më, s'mund ta ndërrojmë, ta keni parasysh. Jemi në seancë. A shkojmë drejt në votim. Zonja Kadrijaj, shkojmë drejt në votim.

Amendamenti 1, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash, amendamentin 1, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

64 deputetë kanë votuar. 46 për, 9 kundër, 9 abstenime. Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 39, edhe një herë propozimi i deputetëve Duda Balje dhe Bahrim Shabani, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë me...

A e dëshironi fjalën zonja... apo shkojmë në votim. Zoti Haxhiu, shkojmë në votim.

Atëherë, amendamenti 39 pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, propozim i deputetëve Duda Balje dhe Bahrim Shabani. Votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar, 10 për, 54 kundër, 5 abstenime. Nuk miratohet ky amendament.

Shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

73 deputetë kanë votuar, 71 për, 2 kundër. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-009 për ndërmjetësim

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, zonja Albulena Haxhiu, e ka fjalën në emër të komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10.07.2018 shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-009 për ndërmjetësimin me amendamentet e propozuara nga komisioni dhe vendosi t'ia paraqesë këtë raport për Projektligjin për ndërmjetësim seancës së Kuvendit.

Më lejoni që vetëm ta theksoj faktin që janë 30 amendamente, të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Pra, nuk ka amendamente të deputetëve apo të grupeve parlamentare, të cilat nuk e kanë marrë mbështetjen e komisionit. Por, para se të procedojmë me votimin, vetëm më lejoni që në grupet punuese të Komisionit për Legjislacion ka pasur tendenca

të ndërmjetësimit edhe të dhunës në familje. Ne si Komision për Legjislacion nuk e kemi lejuar këtë, pra e kemi kundërshtuar lejimin e ndërmjetësimit të dhunës në familje. Pra, ka pasur nga grupe të interesit përpjekje në këtë drejtim, mirëpo ne s'e kemi përkrahur si komision.

Andaj, në emër të Komisionit për Legjislacion unë i ftoj deputetët e Kuvendit që ta përkrahin raportin me amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 30 amendamente. Të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar. 57 për, asnjë kundër, 9 abstenime. Kuvendi i miratoi 30 amendamentet.

Shkojmë në votimin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar. 56 për, 7 abstenime, asnjë kundër. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-009 për ndërmjetësim.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-010 për noterinë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj zonjën Albulena Haxhiu në emër të Komisionit Funkcional ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur më 26.6.2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-010 për noteri.

Gjithsej komisioni ka përgatitur 57 amendamente. Më lejoni t'ju informoj se ka disa prej amendamenteve të cilat nuk e kanë përkrahjen e komisionit, vetëm t'i theksoj se cilat janë ato. Duke qenë se nuk e kanë përkrahjen e komisionit, unë i ftoj deputetët që të mos i përkrahin amendamentet të cilat nuk e kanë përkrahjen e komisionit. Për shembull, amendamenti 7, janë dy propozime. Aty ju ftoj që ta votoni propozimin e parë, që është i komisionit, pastaj amendamenti 10 është propozim i Grupit Parlamentar 6+, po ashtu nuk e ka përkrahjen e komisionit. Amendamenti 12 i Listës serbe po ashtu, pa përkrahjen e komisionit. Amendamenti 13, tri propozime, ju ftoj që ta votoni të parin, pra të komisionit. Amendamenti 34 i Listës serbe pa përkrahjen e komisionit. Amendamenti 46 i Listës serbe po ashtu, pa përkrahjen e komisionit. Amendamenti 48 i Grupit 6+, po ashtu amendamenti 49 6+, që nuk e kanë përkrahjen e komisionit. Amendamenti 55 janë dy propozime, unë ju ftoj që ta votoni propozimin e parë, pra atë të Komisionit për Legjislacion.

Pra, ky është raporti, besoj se edhe deputetët kanë arritur ta lexojnë. Në emër të komisionit unë i ftoj deputetët e Kuvendit që ta përkrahin këtë raport me amendamente, pra vetëm ato të Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E dëgjuat zonjën kryetare, janë 57 amendamente.

Unë do t'i vë në votim vetëm 57 amendamente, duke i larguar këto që i përmendi zonja kryetare, që nuk e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Po i përmend, amendamenti 7 largohet, amendamenti 10 largohet nga votimi i menjëhershëm, amendamenti 12, amendamenti 13, amendamenti 34, amendamenti 46, amendamenti 48, amendamenti 49, amendamenti 55. Të gjitha të tjerat vihen në votim të përnjëhershëm. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Nuk kemi kuorum të mjaftueshëm. Edhe një herë do ta përsërisim votimin. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votohen vetëm amendamentet jo të përmendur më herët, që janë larguar nga procesi i votimit herën e parë.

Votojmë tash! Faleminderit! Nuk pati kuorum, s'kam çka konstatoj.

* * *

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë

Ishin 57 amendamente, në qoftë se dëshironi, unë i përmend ato, të cilat u larguan nga votimi i mëhershëm edhe një herë, por janë në protokoll. Unë i vë në votim në herën e parë vetëm ato që e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Do të thotë, vetëm amendamentet nga 57 çka janë, vetëm ato të cilat e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Do të thotë, amendamentet që nuk janë në votim janë: amendamenti 7, 10, 12, 13, 34, 46, 48, 49 dhe 55.

Përgatitemi për votim, votojmë tash!

Prapë është e njëjta situatë, jemi në pauzën e drekës, pas pauzës së drekës vazhdojmë seancën, deri në orën 14:00, pastaj duhet të votojmë, për arsye se po e ndërpresim seancën, ta keni parasysh. Në qoftë se nuk votohet, po e ndërpritni seancën në këtë formë. Urime për ligjet që i kemi kaluar! Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E vazhdojmë seancën.

Nuk bën, se në votim jemi, si të bëhen 61 deputetë, ne vazhdojmë. Bile ta konstatoj në orën 14:00. Pauzë deri në këtë moment. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Jemi në vazhdim të seancës.

Pikën e pestë e kam vënë disa herë në votim, unë do të tentoj edhe një herë, po të njëjtën kohë e kemi edhe pikën e tetë:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjtit numër 06/L-010 për noterinë

E drejtë legjitime e deputetëve është ta votojnë a të mos e votojnë, në këtë aspekt as nuk dua të involvohem si kryetar i Kuvendit. Vetëm se është çështje procedurale, nuk po mund të vazhdojmë tutje seancën, për të dalë në seancën e re, pastaj edhe me pikat e ardhshme.

Për këtë arsye, në qoftë se do të kem mirëkuptimin, nuk po më duken politike asnjëra, ose vetëm t'i votojmë kundër, të paktën veç të kalojmë mbi 61 deputetë i kemi në votim.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjtit numër 06/L-010 për noterinë

Jemi në votimin e amendamenteve, 57 amendamente.

Sido që të jetë, janë të protokolluara ato të cilat i kam larguar nga votimi i parë, të mos i përsëris edhe një herë, as të mos marr kohë, të mos e vonojmë seancën.

Unë do t'i vë në votim vetëm ato amendamente, të cilat kanë kaluar me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, për të shkuar pastaj një nga një, apo në bazë të propozuesit, të cilët janë si alternativë, për t'i vërë në votim amendamentet e tjera.

I votojmë amendamentet nga 1 deri në 57, ato të cilat janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash:

Faleminderit! Kjo është situata e votimit.

Aktualisht kemi mbajtur në këtë sesion parlamentar 29 seanca plenare, 52 ditë kemi qenë me punë në Kuvend, janë miratuar 38 ligje, plus 7 ligje janë në procesin e votimit. Nëse hyn në fuqi edhe 2 marrëveshjet dhe Ligji për lirinë fetare, do të aprovojmë 48 ligje. Është një kronologji, e cila ka ardhur nga administrata, është sesioni pothuajse që ka kaluar numrin më të madh të ligjeve në historinë e Parlamentit të Republikës së Kosovës, përveç në rastet kur është shpallur pavarësia, të cilat janë lidhur me pavarësinë, më 2008 kemi një rast, edhe kur është përmbyllur pavarësia po ashtu në vitin 2013. Kjo është puna e juaj.

Tash unë kisha kërkuar vetëm një minutë me kryetarët e grupeve parlamentare, për arsye se, ju e dini, e kemi edhe një seancë, e cila do të ishte shumë me rëndësi edhe për qytetarët tanë, e kemi bërë edhe temë çështjen e dialogut.

Në këtë formë sikur të dëshirojë dikush që me mosvotime të mos shkohet fare në atë seancë, të mos vazhdohet tutje. Jo vetëm procedurat, ju i dini shumë mirë, e nderuar kryetare e Komisionit për Legjislacion, pikërisht pasi je edhe për legjislacion, e di.

A ka mundësi një minutë të merremi vesh, vendimmarrja është juaja. Të nderuar kolegë deputetë, faleminderit shumë për vëmendjen!

* * *

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-010 për noterinë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Janë gjithsej 57 amendamente.

Do t'i vëmë 57 amendamente, me përjashtim amendamentet 7, 10, 12, 13, 34, 46, 48, 49 dhe 55, votojmë tash:

Vetëm 50 deputetë kanë votuar, nuk ka kuorum të mjaftueshëm. Këto dy pika të papërfunduara mbesin për seancat e radhës. Përfundoi seanca plenare, futemi menjëherë në tjetrën.

Ishte një qëndrim unanimit, të jem shumë korrekt, i pjesës së pozitës, edhe kryeministrit që të futemi gjithsesi në seancën e re plenare, në mënyrë të veçantë te dialogu.

* * *

E enjte, 26 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 12 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për noterinë

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 57 amendamente.

Në votimin e parë do të jenë vetëm ato të cilat e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, të gjitha amendamentet tjera të cilat nuk e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL nuk votohen.

Edhe një herë ,nuk votohen në radhën e parë të gjitha amendamentet, të cilat janë pa propozimin e Komisionit FunkSIONAL. Do t'i votojmë pastaj një nga një.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamenteve me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Në sallë janë 83 deputetë. Votojmë tash!

Për hir të publikut, në sallë janë 83 deputetë, e kemi një situatë të bojkotit, për të cilën realisht në rrethana të tilla më duhet edhe një herë ta thërras Kryesinë. Do ta bëjë një pauzë, e do ta thërras Kryesinë për shkak se më duhet ta kem parasysh që nuk ka votim. Është rast i paprecedent më duket, më herët nuk ka pasur bojkote të tilla, prandaj do të shkojmë në pauzë 15 minuta, pastaj e vazhdojmë seancën.

* * *

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/ L-010 për noterinë

Deri sa të bëhen 81 deputetë, 82 deputetë janë në sallë.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsejtë 57 amendamente.

I votojmë amendamentet vetëm të cilat kanë kaluar.. në Komisionin FunkSIONALIN e provojmë edhe dy herë edhe pastaj vazhdojmë, çka nuk kalojnë të keni parasysh kalojnë për seancën e radhës parlamentare më nuk i kthej në votim, ky ishte vendimi në mënyrë unanime i Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare.

57 amendamente, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/ L-010 për noterinë

Vetëm amendamentet që kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Shkojmë edhe një herë në votim, e patë rezultatin nuk ka kuorum, të mos ju vonoj as juve.

Shkojmë edhe një herë në votim të njëjtin projektligj.

84 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

Kjo pikë e rendit të ditës mbetet për seancën e radhës plenare. Vazhdojmë!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*